

A close-up, profile view of a man's face, looking to the right. The lighting is dramatic, highlighting the contours of his nose and cheek against a dark background.

Luan Rama

Fransua
Miteran

romantizmi i pushtetit

BIBLIOTEKA

929
R 24


DITURIA

929
K24

Luan RAMA

Fransua Miteran

- romantizmi i pushtetit -



57465

Shtëpia Botuese DITURIA

Luan Rama
Fransua Miteran - romantizmi i pushtetit-
© DITURIA,1996

Redaktore:Mariana Ymeri
Kopertina: Arian Dheri

“Mehr hicht!”
“Më shumë dritë!”

Fjalët e fundit të Gëtes para vdekjes

Si të vdesësh?...

“Comment mourir?...Si të vdesësh?...kishte shkruar ai disa muaj para se të vdiste, në parathënien e librit të një mjekeje psikologe, Marie de Hennezel, me të cilën disa herë kishin biseduar rreth kësaj teme gjithënjëzore. Libri titullohej “Vdekja intime”. Ai kishte përballuar disa ndërhyrje kirurgjikale në prostatin e prekur nga kanceri që në vitin 1981. Por tashmë një lodhje e tmerrshme e kishte pushtuar të tërin. Ngjitja e një shkalle kërkonte përpjekje të jashtëzakonshme për të mbijetuar, sikur kjo t’i ngjante ngjitjes së Sizifit.

“Comment mourir?...Ne jetojmë në një botë ku kjo çështje na humbet nga sytë . Qytetërimet para nesh e vështronin vdekjen në sy. Ato përcaktonin për komunitetet njerëzore e për cilindo, shtegun e kalimit nëpër këtë botë. Ata i jepnin këtij lloj destinacioni sensin dhe vlerën e vet. Kurrë ndoshta raporti i njeriut me vdekjen nuk ka qenë kaq i varfër sesa në këtë kohë të thatësirës shpirtërore, ku njerëzit, me ngulmin për të ekzistuar, duket se i shmangen këtij misteri. Ata nuk e dinë se kështu e perthajnë shijen për të jetuar , duke e larguar atë nga ai burim qenësor...”

Po ato kohë, në një intervistë të gjatë me gazetaren e njohur Christine Ockrent të revistës “Express”, duke folur për vdekjen ai kishte thënë:”Unë nuk përjetoj frikën e vdekjes , por më shumë përjetoj pikëpyetjen e madhe që mbart në vetvete vdekja. Vallë a është hiçi? Ndoshta?! Por nëse nuk është ai, atëherë ç’aventurë të jetë? Kurrë ndonjëherë s’do të ketë një përgjigje...!”

Ai e ndjente afrimin e vdekjes. Dhe sa më shumë ajo i afrohej aq më me qetësi e priste ai , edhe pse dëshira për të mbijetuar ishte më e madhe se kurrë. Tashmë ai jetonte pranë Senës , në cep të “Champs de Mars”(“Fushat e Marsit”), emër ky i vënë për nder të perëndisë së Luftës, Marsit, lëndinave ku dikur stërvitej kavaleria e Napoleon Bonapartit. Kur kishte diell, ai dilte në park të shijonte peizazhin plot njerëz e gjelbërim. Tutje në sfond ngrihej kulla e hekurt Eiffel. Disa ditë para se të vdiste ai i kishte pohuar një të afërmi:”Po iki nga kjo botë pa asnjë keqardhje dhe trishtim, po iki qetësisht, ashtu siç dhe erdha në këtë jetë...”

Dy ditë para se të vdiste ai nuk pranoi të vinin ta shihnin njerëzit e afërm në dhomën ku shtrihej: “Ata që më duan , do të më kuptojnë”. Të hënën, më 8 janar 1996, në orën 8 e gjysmë, në katin e tretë të ndërtesës në aveny “Frederic-Le Play”, Miterani shuhej qetësisht në një heshtje të plotë, në moshën 79-vjeçare. Më së fundi, ai e kishte pranuar se e pat humbur këtë betejë të gjatë dhe cfillitëse.

Presidenti francez Zhak Shirak (Jacques Chirac) ishte nga të parët që erdhi në krevatin e tij të vdekjes. Atë ditë ai do të takohej me gazetarët, si çdo fillim viti. Ai mundi t’u thotë gazetarëve veçse pak fjalë:” Presidenti Fransua Miteran na la këtë mëngjes. Sapo e përshëndeta për herë të fundit. Miterani shkroi një faqe të rëndësishme në historinë e vendit tonë...Një figurë e madhe iku dhe unë e përshendes atë me emocion dhe respekt”

Në avenynë “Frederic-Le Play” Nr.9, njerëzit filluan të mblidhen. Fëmijët, e shoqja, miqtë e afërm, kryeministri Zhype (Jupé), politikanë të partive të ndryshme, socialistët Jospin, Delors, Fabius, Rocard...Binte një shi i imët. Kamerat televizive menjëherë filluan të instalohen, gazetarët nxitonin, po kështu dhe njerëzit e thjeshtë. Një popull anonim dhe duar që zgjateshin për të vendosur nga një trendafil në portën e hyrjes së tij. Alen Delon afrohet dhe me dhimbje vendos një trendafil të kuq. Megjithëse jo socialist, ai kishte një respekt të

veçantë për figurën e Miteranit. Pas tij Jeanne Birkin apo Annie Girardot...

“Në dritën e mjergullt të dhomës,- tregon miku i tij i afërt Robert Badinter,-fytyra e presidentit të vdekur kishte ruajtur atë shprehje ku përzihej krenaria dhe ironia, ndjenjë kjo që i mbante larg bashkëbiseduesit për sa kohë ai donte, dhe që pastaj, me një buzëqeshje, në një çast të dhënë, ai të ofronte miqësinë.”. Dhe duke përfunduar tregimin e tij, Badinter, kujton se si një herë, duke nderuar bashkë një të vdekur, Miterani i kishte thënë:”Ai vetë nuk e di që ka vdekur”.

Një ditë para se të vdiste, ai i kishte dhënë mikut të tij të afërt Rousselet, tri gjysma faqesh , shkruar me një stilograf ngjyre blu. Ky ishte testamenti i tij, i shkruar me një dorë të dridhur ku kishte lënë porosinë për përcjelljen e fundit:” Një ceremoni funebre fetare e intime në Zharnak (Jarnac). Varrimi në varrezat e familjes. As fjalim, as kurora, as lule, por vetëm një tufë trëndafilash ngjyrë çaji si dhe një tufë zambakësh violet dhe të verdha. Zi nationale , por jo ceremoni varrimi kombëtar. Një meshë në Notre-Dame të Parisit nga kardinali Lustinger”.

Për dy ditë me radhë, nga mëngjesi në mbrëmje vonë, njerëzit vinin në avenynë ku kishte vdekur Miterani dhe vinin trëndafila të kuq. Në librat e vendosur në dy anët e portës anonimët shkruanin në faqet e bardha:”Bon voyage”,”udhë të mbarë”..”Mirënjohje...gjenerata miterandiste...”“Faleminderit për gjithçka ti bëre për Francën”...

Në mbremjen e 10 janarit, pikërisht si atëherë më 10 maj 1981 kur socialistët festonin në sheshin e Bastijes fitoren e zgjedhjes së Miteranit president, ashtu u mblodhën përsëri mijra njerëz të të gjitha moshave, mbi 30 mijë, për të përkujtuar udhëheqësin e tyre. Një shi i imet binte përseri. Drita, qirinj, dhe një fotografi e madhe e Miteranit që i përshendeste. Në shkallët e Operas së Bastijës, Barbara Hendriks, një nga yjet e operas, këndonte “Le Temps des cerises”(“Koha e qershive”), një këngë të poetit revolucionar të fundit të shekullit të 19 , Jean Baptiste Clement, me muzikë të Renard.

Kënga e saj shpërndahej mbi mijëra fytyra të përmalluara që dëgjonin tekstin e poetit popullor të barrikadave të Komunës së Parisit.

“Ite, missa est...”
“Shkoni, mesha ka mbaruar...”

“Messe de requiem”

E njëjta ceremoni funebre në Notre-Dame ishte zhvilluar vite më parë për gjeneralin Charl de Gol (Charles de Gaulle) dhe presidentin Zhorzh Pompidu (Georges Pompidou). Në sheshin e katedrales historike, një ekran i madh ishte ngritur në mënyrë që publiku jashtë të ndiqte meshën. 61 kryetarë shtetesh e qeverish, një mijë e dyqind personalitete, akademikë e nobelistë, përfaqësues nga 150 shtete të ndryshme të botës...Avionë nga të gjitha kontinentetet e pjesët e globit nxitonin duke zbritur në qiellin gri të Parisit. Boris Jelcin nga Moska, kancelari Kohl nga Gjermania, zëvendës-presidenti amerikan Al Gore vinte në emër të Bill Klinton, Mejxher nga Londra, Gonzales dhe mbreti Juan Carlos nga Madridi, Shimon Perez nga Tel-Avivi, Arafati nga Palestina, Fidel Kastro dhe Mubaraku, Havel dhe presidenti më i ri i Polonisë, Kashnjevski...Në këtë radhë të ishte dhe presidenti shqiptar Sali Berisha. Ndërkohë që në Paris mbledheshin qindra personalitete, avioni me trupin e Miteranit , nën një marsh të Shopenit drejtohej nga vendlindja e tij, Jarnac, i shoqëruar nga e shoqja Danielë, djemtë Gilbert dhe Jean-Christophe dhe e bija

natyrale Mazarinë së bashku me të jëmën , Annie Pingeot, gruaja e “dytë” e Miteranit. Dy gratë e presidentit ndanin në heshtje dhimbjen për të njëjtin njeri të afërt.

Në sheshin “Place du Chateau”, buzë lumit Charente, era që fryu e zbuloi për një çast arkivolin e mbuluar me një flamur të madh nacional tringjyrësh. Në kishën e vogël Saint-Pierre, atje ku ai ishte pagëzuar dikur fëmijë, zhvillohet e njëjta meshë nga peshkopi i Angoulemë. “Himni i gëzimit” të Betovenit e përcjell. Pas tij, vijnë miq të afërt, janë dhe Zherar Depardie, Fransuazë Sagan...

Në orën 11 kardinali Lustinger në “Notre-Dame de Paris” niste meshën përkujtimore “Messe de requiem”, duke lexuar pasazhe nga Saint-Jean, nga Evangjili, etj,dhe nuk harron te citojë dhe nga fjalët e fundit të Miteranit: “Comment mourir”?:

“O Zot, lehtësoje atë nga të gjitha mëkatet në mënyrë që të mbulohet nga Lavdia Jote ditën e ringjalljes!...Ai na la të nënkuptonim se besonte në bashkësinë e shenjtëve”

Mbi drurin prej dushku të arkivolit ishte shkruar thjeshtë : “François Mitterand” 1916-1996.

Në sheshin e katedrales më të vjetër të Francës, në “Notre-Dame”, zëri i kengëtares Barbara Hendriks që këndon “Le Pie Jesu”, një requiem të Faure, shpërmdahet në etër, duke krijuar një drithërimë në shpirtrat e atyre që kanë ardhur jashtë katedrales dhe që të lagur nën atë shi të imët, duan ta përcjellin me shprehjen e thjeshtë:”A-Dieu!”... “Lamtumirë!”...

Në atë përcjellje, ku merrte pjesë gjithë kombi francez , kishte diçka mitike.

“In limine...”

“Në fillim...”

Nën qiellin e lagët të Aquitainës

“Fëmijëria ime ishte e lumtur dhe ajo ka ndriçuar gjithë jetën time,- thoshte para se të vdiste Miterani..-Prindërit e mi ishin njerëz të kujdesshëm dhe të lirë. Ata nuk më imponoheshin dhe nuk ushtronin ndaj meje një autoritet të verbër...Ata më rrënjosën një disiplinë për jetën...Ishim një familje e madhe prej tetë fëmijësh...”

Fransua Miteran lindi në Jarnac më 23 tetor 1916, në 22, Rue Abel-Guy. Një qytet i vogël prej katër mijë banorësh. Përpara tij ishin lindur tri motra dhe një vëlla: Antoinette, Marie-Josophe, Colette dhe Robert. Pas Miteranit, vite më vonë do të vinin në jetë Jacques, Marie dhe Philippe. Babai i tij Joseph ishte shef i një stacioni treni, në Angoulemë. Ishte një familje katolike dhe aristokrate, me prirje republikane, ku admirohej Clemanceau dhe Poincare. Nëna e tij quhej Ivonne Lorrain dhe ai ushqente për të një dashuri të veçantë. Stërgjyshërit e tij mbanin emrin e borgjezëve të Bourges.”Gjenealogjia e familjes sonë i ka rrënjët në mjergullat e Mesjetës,”- do të mburrej më vonë Miterani.

I vogël ai i kalonte pushimet pranë gjyshërve të tij , në një fshat nja 70 kilometra larg vendlindjes së tij.”Atje,- siç kujton ai,-

fitova ndjenjën e kontaktit me erën, ajrin, ujin, rrugët, kafshët. Koka ime mbushej me një muzikë natyrale. Era që fërshëllente, lumi...çdo ore e ditës kishte aromën e vet. Këto eksperiencia më dhanë një lloj filozofie. Isha i zoti të imagjinoja që në gurët e kalldrëmit të rrugës fshihej një lloj energjie. Pra kisha një ndërgjegje dhe marrëdhënie të vërtetë me natyrën. Mundësia e imagjinatës te fëmija është e konsiderueshme. Nëse në jetë kam pasur disa ide, ato nuk kanë qenë aq të fuqishme se sa ato të moshës sime pesëmbëdhjetë vjeçare. Përmes mikrokozmosit tim unë shihja universin. Edhe pa e njohur botën unë e dominoja atë”.

Nëntëvjeçar ai ikën nga familja për të vijuar studimet në kolegjin Saint-Paul të Angouleme. Në këtë kolegji fetar, Bibla do ta shoqëroje gjatë gjithë fëmijërisë. Ishte një fëmijë mjaft i ndrojtur, i mbyllur dhe shumë i ndjeshëm. Ai nuk guxonte t’i imponohej kujt. Latinishten e kishte mësuar nga prifti i fshatit. Ishte sensibil veçanërisht ndaj natyrës. Peizazhet e frymezonin, veçanërisht toka, ngjyrat e saj herë të kuqe, të zeza apo të bardha në brigjet e lumenjve. Lumi i Charente ishte veçse 300 metra larg shtëpisë ku kishte lindur.

“ Unë jam rritur nën një qiell të qullët të Aquitaine. Kujtimet e mia quhen bli, vidh, arra, quhen misër, bletë, bajuke, një mur në diell...”

Në janar 1936 pas një sëmundje cfilitëse e plot dhimbje i vdes nëna e tij, Ivonne.

“ Asaj iu desh të vdiste ngadalë dhe për një kohë të gjatë. Ishte e ndërgjegjshme se qe e dënuar me vdekje. Por vullneti i saj ishte i jashtëzakonshëm”.

Pas mbarimit të kolegjit në Angouleme, ai u kthye për pak kohë në vendlindje. Në këtë periudhë ai lexonte shumë, në vetminë e tij. Veçanërisht letërsi, nga librat që trashëgonte në atë bibliotekë të vjetër të familjes. I pëlqenin autorë si Barres dhe Monterlant.

“Im atë fliste pak, ai i hidhte fjalet, ashtu siç hidhnin grepat peshkatarët , - shkruan më pas Miterani.-Dhe për të kaq mjaftonte. Kështu ai më mësoi ta mbushja fëmijërinë time me qiej, që aq shumë ka vendi im, qiej që i vështroja kur udhëtoja nëpër ato lëndina të sheshta, me erën e fuqishme të detit, që përplasej mbi shkurret dhe mbarhte me vete aromën e tokës”.

Në moshën 18-vjeçare, ai merr trenin në Angouleme dhe niset

në Paris për studime. Zbret në “Gare d’Austerlitz” me disa letra rekomandime në xhep, për miqtë e familjes së tyre që atë kohë jetonin në Paris. Një prej tyre i adresoj shkrimtarit të shquar François Mauriac.

Që në fillim u vendos në një konvikt studentësh që vinin nga provinca, në 104, rue Vaugirard. Një shoqëri e ngushtë e lidh me studentët e fakultetit të drejtësisë ku filloi studimet. Të gjithë ishin partizanë të ideve të Charles Mourras. Edhe pse studjon drejtësi, ëndrra e tij është që një ditë të bëhet një shkrimtar i madh. Të rinjtë mblidheshin në “Quartier Latin” dhe përjetonin ditë të stuhishme të asaj kohe. Lexonte shumë Paul Valery, Bernanos, Andre Gide, Giraudoux, por edhe Tolstoin, Dostojevskin, Baudelaire, Martin-du-Gar apo Claudel. Tetëmbëdhjetëvjeçar, në një anketë që i bënin një ditë shokët e tij, ai u përgjigjej:

“-Deviza ime?-Të mos çuditem për asgjë!

-Cilësia që më pëlqen?-Të jesh i hapët!

-Poeti i preferuar?-Baudelaire!

-Prozatori që dua?-Pascal!

-Muzikanti?-J.S.Bach!

-Lulja që më pëlqen?-Çdo lule, veç jo ne vazo!

-Ajo që do të doja të isha?-Gjithçka ose asgjë!”

Aspirata e djaloshit Miteran ishte të bëhej gjithçka ose asgjë!

Dhe ai diti ta zgjedhë një ditë alternativën e vet.

“Thonë që isha një djalosh i shkujdesur dhe i mbyllur , që e kisha të vështirë të komunikoja me të tjerët...Por megjithatë unë e dija se rinia ne vetvete përmbante force dhe e ndjeja se asgjë nuk mund t’i bënte ballë dëshirës.

“*Festina lente...*”
“*Nxito ngadalë...*”

Maksimë greke

Një rini franceze

Në fund të viteve 80 dhe fillim të viteve 90 , gazetari Pierre Pean rrëmonte nëpër arkivat e qeverisë së Vichy-së, lidhur me bashkëpunimin e saj me gjermanët hitlerianë. Disa herë nëpër duar i kishin kaluar dokumente dhe fotografi, ku i shfaqej dhe portreti i presidentit të Republikës, Fransua Miteran. Në fakt, e djathta prej kohësh e kishte akuzuar dhe e akuzonte atë gjithnjë si një kolaboracionist. Atëherë gazetari vendosi të hetojë.

Një ditë, kërkon të takohet me Miteranin dhe i thotë për qëllimin e kësaj vizite: një libër për rininë e tij dhe kohën e qeverisë së Vichy-së.

Që në fillim Miterani i kishte thënë:

-“A është e nevojshme kjo?”

-“Sigurisht, pasi është një periudhe pak e studjuar e që duhet ndriçuar!” - i ishte përgjigjur gazetari.

Pas një ngurrimi, presidenti i kishte thënë:

- “Nëse e mendoni kështu, mirë atëhere...Unë s’do t’ju fsheh

asgjë dhe do t'ju ndihmoj në punën tuaj.”

“Presidenti e mbajti fjalën,- tregon Pierre Pean,- ai më ndihmoi në kërkimet e mia, edhe për ato gjëra që ai e dinte se ishin te pafavorshme për të.”

Pra, jemi në vitin 1934, kur Miterani vjen për studime në Fakultetin e Drejtësisë dhe në “Ecole libre” të shkencave politike. Në atë kohë , Miterani anonte nga idetë e nacionalistëve francezë ndaj u shkrua në radhët e “Vullnetarëve të Kombit” ,që drejtonte koloneli La Rocque.Ky njeri nuk ishte as fashist , as antisemit.Ai kishte një devizë të vetën “Punë,familje,atdhe” dhe përfaqësonte një të djathtë tradicionale , antiparlamentare , antikomuniste.

“Figura e kolonelit La Rocque, më kishte tërhequr prej kohësh,- tregonte Miteran.-Unë kam qenë në disa mbledhje të kësaj organizate. Më tërhiqte karakteri i çiltër i kolonelit”.

Në janar 1936, çështja e profesorit çifut Jeze, në fakultetin e Drejtësisë, bëhet një çështje me reperkusion të gjerë. E djathta nacionaliste organizon mitingje.Studentët e pengojnë dhe e ndalojnë të hyjë në fakultet për të zhvilluar kurset e mësimi. Të majtët e mbrojnë. Miterani merr pjesë në mitingjet e të djathtëve . Leon Blum, deklaroi se “socialistët nuk do të pranojnë që fashistët ta pengojnë Jeze-n”. Policia ndërhyu dhe zhvillohen përleshje. Në një nga fotografitë e kësaj përleshjeje duket dhe portreti i Miteranit. Megjithatë, në atë kohë koloneli La Rocque, mbante distancë me fashistët e vërtetë.

Më 1936, me ardhjen në fuqi të Frontit Popullor , mendimet e Miteranit evoluojnë. Ai fillon të ndjekë manifestimet e të gjitha ngjyrave: edhe ato të Malreaux, të Chamson, Benda e pastaj të Maurice Thorez, Dariot, Leon Blum.

“Në këtë kohë unë nuk kisha asnjë angazhim politik,- pohon në kujtimet e veta Miterani.-Në fakt isha kurrsthar për gjithçka, si për letërsinë ashtu dhe për politikën. Asistojta gjithnjë në manifestimet politike dhe intelektuale të asaj kohe”.

Në këtë kohe, në një anketë të revistes “Revue Montalmbert”, në pranverën e vitit 1936, ai iu përgjigjet disa pyetjeve:

-Cilët janë autorët që ju pëlqejnë më shumë?- Valery, Beaudelaire, Mauriac, Claudel.

-Cila është rëndësia e letërsisë? -Ajo është e nevojshme dhe e rrezikshme. Të bën të mendosh dhe të ndjesh si një letrar.

-Nëse s'është ndonjë gjë, çfarë mund ta zëvendësonite atë? Në këtë jetë nuk ka vetëm libra për të lexuar!

-Nëse niseni në luftë, ç'libra do të merrni në çantë? "Mendimet" e Pascal, "Abbay de Theleme", e Rabelais.

-Po të ishte ky vetëm një udhëtim? -"Eupalinos" e Valery, "Dieu et Mammon" e F.Mauriac, "Aux fontaines du desir", e Montherlant, "Le soulier de satin" e P.Claudel.

Gjatë kësaj periudhe ai shkruan në gazetën e njohur parisiane "Echo de Paris". Disa herë takohet me shkrimtarin François Mauriac, të cilin e adhuron. Por dhe shkrimtari e sheh me simpati këtë student: "E dua shumë,- shkruan diku ai për Miteranin,- ai është një personazh romanesk, d.m.th. një personazh romani. Ai është një pinjoll nga anët e mia, nga vendet e Charente, si një Rastignac...", duke kujtuar kështu se dhe personazhi Rastinjak i Balzakut kishte të njëjtën origjinë...

Më vonë Miterani do t'i zemërohet idhullit të tij, duke iu përgjigjur shkrimtarit të nderuar në mënyrë arrogante: "François Mauriac është një shkrimtar provincial, një mik i xhaxhait dhe i nënës sime, për të cilin, çdo djalosh nga Angulema është domosdo një Rastinjak".

Lufta afronte. Studenti Miteran ndiqte i shqetësuar jehonat e grumbullimeve të nazistëve në Nuremberg. Gjermania po militarizohej. Është koha kur ai përgatit tezën për doktoratën e tij në të drejtën publike (Le Droit Public).

Më 12 mars 1938, trupat gjermane hyjnë në Austri, e cila bëhet pjese e Rajhut III. Në një revistë studentësh ai boton një artikull me titullin "Anschluss", kundër kërcënimit të invazioneve hitleriane drejt Perëndimit. "Mjaft më,- shkruan ai,- mos e ngisni më tutje Evropën!" Është koha kur duhet të kryejë shërbimin ushtarak në garnizonet të Fort d'Ivry, pranë Parisit.

Më 4 shtator 1939, bashkë me regjimentin e tij, "serxhenti" Miteran gjendet në stacionin e trenit të Parisit, në "Gare de Pantin" për t'u nisur drejt Alsacës.

“Dominus vobiscum!”
“Zoti qoftë me ty!”

Nga liturgjia e ritit latin

Përtej linjës “Maginot”

Më 7 prill 1939 Italia fashiste pushton Shqipërinë. Më 11 shtator 1939 ushtritë naziste pushtojnë Poloninë.

Në fundin e vitit 1939, Miterani gjendej në frontin e luftës. Në transhetë e përbaltura ai do të ketë dy libra të dashur: “*Les pensées*” (“Mendimet”) e Pascal dhe “*L’imitation de Jezu-Christ*”. Pastaj miqtë i dërgojnë dhe “*Terres des hommes*” (“Tokë e njerëzve”) e shkrimtarit Saint-Exupery. Në dhjetor 1939, me shpejtësi vjen në Paris për të takuar të dashurën, “Beatriçen” e tij, Marie-Louise Terasse apo siç do të quhej më vonë ajo, Catherine Langeais.

Dimri i vitit 1939-1940 ishte tepër i ftohtë. Francezet ishin të sigurtë se me linjën e fortifikimeve “Maginot” (“Mazhino”) përgjatë kufirit franko-gjerman, ata do ta përballonin agresionin e ushtrive të Hitlerit. Miterani, në atë kohë ushtar në regjimentin e Infanterisë Koloniale, siç quhej atëherë, vendoset përtej vijës “Maginot”. Në fillim në Ardennes, pastaj në Montmedy...

Muaj të tërë do të kalonin në qetësi, aq sa ushtarët francezë, në pritje të luftës, gati do ta harronin atë. Ata hapnin transhetë për të penguar tanket gjermane nëse do të sulmonin një ditë. Por Miterani

nuk e donte luftën. “Lufta është diçka idiote, e tmerrshme, shkatërrimtare, një mohim i jetës, progresit dhe lumturisë”, - shkruan ai në një letër që u dërgon të afërmeve.

Më 10 maj, një natë të errët, avionët gjermanë fluturuan me një zhurmë të kobshme dhe impresionuese. Tanket gjermane u shfaqën në Sedan. “Ata po sulmonin drejt nesh me tanke,- kujton Miterani. -Lufta kishte filluar. Avionet na bombardonin”.

Fushat u përmytën nga moria e ushtarëve hitleriane të armatosur gjer në dhëmbë. Kompania e Miteranit gjendej në një kodër të quajtur “Cote 304” apo “Mort d’Homme”, (“Vdekja e Burrit”). Në këtë kohë Miterani komandonte një kompani këmbësoresh. Ata hapnin me nxitim gropa dhe instalonin mitrolozat për të ndalur furinë gjermane. Por furia ishte e pandalshme. Artileria gjermane ishte e pamëshirshme. Pranë ka mikun e tij Morot-Sire, një profesor filozofie, të cilit i është copëtuar gjuri. Tjetri vështrohet në kurrizin e Miteranit një curril gjaku.

“Disa shokë të regjimentit me morën me qerre dhe më çuan në një vend me qëllim që më pas të mjekohesha,- kujton Miterani.


Francezët tërhiqen. Më 14 qershor 1940, ai plagoset në shpatull nga shpërthimi i një predhe. Dy ditë mbetet në transe me gjoksin e përgjakur. Sytë e tij shihnin vetëm avionët e “Luftwaffe” që kalonin me shpejtësi duke mbjellë vdekjen. Menjëherë e transportojnë në bodrumin e një shtëpie, diku larg frontit. Por askush s’do të kujdesej për të në ato çaste të tmerrshme. Pastaj e çojnë në një qendër sanitare, në një stacion-termal aty pranë, ku po mblidhnin gjithë ushtarët e plagosur. Kështu ai do të kalojë nëpër pesë spitale radhazi pa mundur të mjekohet.” Më së fundi u mësova dhe e dija që nuk do të vdisja”.

Një nga një, pozicionet franceze bien. Më 14 qershor ushtria e Rajhut III hynte në Paris. Për Hitlerin, ky invazion i shpejtë ishte një “mrekulli e vërtetë”.

Kur ushtria gjermane hyri në Paris, Miterani ende ishte në Verdun, por tashmë i kapur rob.” Kur gjermanët ia behën, unë isha në shtrat, në krah të një senegalezi.”

Pasi e internojnë në Luneville për disa kohë, grupi i të burgosurve merr rrugën drejt kampeve gjermane, në Thuringe, stalag IXA , disa kilometra larg Cassel ~~ne zonën e Hesse.~~Tashmë ai është i

54765



burgosuri me matrikullin nr.21716.

“Pas Gothe, ne kapërcyem Eisenbach, -shkruan Miterani në revistën “France” nr.5, në dhjetor të vitit 1942, nën titullin “Pelegrinazh në Thuringe,- atje ku dikur kishte jetuar Luter , i cili përktheu Biblën në gjuhën e vendasve. Pastaj Erfurt-in ku kishte kaluar Napoleoni... Më pas arritëm në Weimar ku qëndruam disa orë. Më ngjante se Historia po më jepte të njëjtin mësim: Gotha, Eisenbach, Erfurt, Weimar...Dueli franko-gjerman përgjatë shekujve përmbledhej në këta katër emra.”

Për herë të parë në këtë kamp ai dëgjon për gjeneralin De Gol. Atje, i burgosuri Miteran u bënte të burgosurve të tjerë kurse për Volterin, Rusoin, për jetën në “Quartier Latin” etj. Fillon të shkruajë dhe të merret me greqishten, pastaj me nje libër që më vonë do ta quajë “Shtatë kodrat e Parisit”. Më pas drejton gazetën “Ephemere”(“Efemeri”), një gazetë e përdymuajshme prej 4-8 faqesh, e cila më pas do të ndalohej nga gjermanët.

Natën , në heshtje, ata këndonin “La Marseillaise”.

Por ndërkohë vuan fizikisht, për shkak të plagës së marrë në front. I trishtuar për fatin e tij, ai shkruan dhe poezi:

...”Një kalë i lodhur, oh, sa gjatë ka ecur ai...

Kortezhit i prin, , si në një manezh apo në varrim.

Nuk qeshim, as gënjejmë, por mendojmë në tjetër gjë,

Ne gjithë ato gjëra që përkunden e prehen nga dëshpërimi...”

Në stalag ata merreshin me të korrat, mbledhnin kallingjtë dhe transportonin duajt.Në tetor 1940 ai ishte në komandon 1515 në Scaala, në Thuringe, ku kishte shumë çifutë, polakë, sllovakë e spanjollë. Atje ai punonte si zdruckhtar tek dikush që kishte një sharre. Fshatari që s’dinte frëngjisht, një ditë i shkruan mbi një copë dërrase: 1806-1813, Saafeld - Leipzig - Napoleon, dhe pastaj ai kishte thirrur: “Uber alles Napoleon!”

Fshatari gjerman ruante kujtime nga historitë e gjyshërve të tij, që kishin jetuar kohrat e vjetra. Bile ai i kishte treguar dhe një album me fotografi të Napoleonit dhe Jozefinës, pamje nga ishulli i Shën Helenës, vend ku ishte internuar dhe ku kishte vdekur perandori.

Ndërkohë Miterani mendonte gjithnjë për arratisjen e tij nga

kampi.

“Për gjashtë muaj rresht unë u përgatita për t’u arratisur, por më kot. Herën e dytë m’u deshën tetë muaj të tjerë. Por të dyja tentativat dështuan: njëra në Metz dhe tjetra në kufirin zvicerian.”

“Liria, -do të shkruajë më pas ai,- nuk është çështje guximi, por dashurie”.

Në fakt, herën e parë ai bashkëpunoi me abatin Leclerc, të cilin e kishte bërë mik të afërt. Bashkë studjojnë planin e arratisjes, duke vënë re se kampi i tyre nuk ishte më larg se gjashtëqind kilometra nga kufiri zviceran. Një ditë marsi të vitit 1941, në mëngjes herët ata mundin t’ja mbathin. Ditën e dytë, një ushtar i ndalon, por ata mundin ta mashtrojnë, duke u hequr si punëtorë emigrantë italianë. Njëzet e dy net radhazi ata udhëtojnë nëpër baltë dhe dëborë, duke iu shmangur gjithnjë qendrave të banuara. Për çdo ditë, dymbëdhjetë biskota dhe një copë sheqeri për të mbajtur frymën. Lodhja ishte e tmerrshme. Kur mbërrijnë pranë kufirit zviceran ishte ende ditë dhe ata kujtojnë se më së fundi arritën. Kishin zbritur në fshatin Egesheim. Aty arrestohen menjëherë dhe dërgohen në Stalag IXC, në një komando ndëshkuese.

Në nëntor të po atij viti ai bën përpjekjen e dytë. Ndërkohe e kishin sjellë në stalag IXA. Por që andej ishte e vështirë të largoheshe. Kampi rrethohej nga nje rrjete teli me gjemba te larte prej kater metrash dhe që ruhej vashdimisht nga dritat e projektorëve. Një natë, në çastin e ndërrimit të rojave, ai tenton të ikë bashkë me dy shokë të tjerë. Alarmi jepet në kamp. I vetëm, ai mund t’i hipë trenit dhe niset për në Metz, që në atë kohë gjermanët e konsideronin si qytet gjerman. Me të arritur atje, ai vendoset në një dhomë të hotelit “Cecilia”, por padronia e hotelit e spiunon. Ne mengjes e arrestojne dhe e çojne ne kampin provizor te Boulay-en-Moselle.

Por ideja per t’u arratisur rri tek ai gjithnje zgjuar.

10 dhjetor 1941 në Lorrain. Dikush në kamp i kishte thënë se në hyrje të qytetit, në një klub “Bar-Tabac”, mund të fshiheshe dhe t’ja mbathje. Pronarët ishin njerëz të mirë.

Kështu, një natë, i zbathur, Miterani i afrohet rrethimit të kampit dhe e kapërcen atë. Por shpejt, pas tij dëgjoen breshëritë. Ai vrapon për shtatë kilometra i ndjekur nga ushtarët gjermanë. Ata pothuaj janë katërqind metra afër, kur para tij shfaqen konturet e “Bar-Tabac”. Gruaja që ende shërbente e fshehu menjëherë në një

bodrum. Gjermanët ia behën dhe kontrolluan me shpejtësi, por Miteranin nuk e gjetën. Pas pak u larguan.

Pas dy ditësh, ajo grua e mirë e fshehu në një spital të qytetit, që drejtohej nga një doktor gjerman. Infermieret e dorëzojnë te zonja Marie Baron, e cila dhe herë të tjera kishte ndihmuar të arratisur nga kampet. Ajo e fshehu diku dhe pas ca kohësh ua dorëzon murgeshave Stenger. Pas tri ditësh, Marie Baron e hipi atë në një tren dhe e nisi drejt Metz. Atje ai fshihet në një kishë, ku takon dhe tri të arratisur të tjerë. Pas disa ditësh, ata mundin të hipin në një tren tjetër dhe t'i afrohen kufirit francez, nga ku hidhen nga treni. Ishte fundi i një kalvari të gjatë.

Në fillim, Miterani shkon në Nancy, ku menjëherë i dërgon një kart-postale Marie Baron: "Pako mbërriti mirë". Pastaj ai kalon në zonën e Jura-s, në jug të Francës, që atëherë ishte zonë e lirë. Pasi qëndron disa kohë atje dhe në Saint-Tropez, te ca miq të familjes së tij, ai niset drejt vendlindjes së tij, ne Jarnac, për të kaluar bashkë me prindërit festën e Vitit të Ri.

“Ave Caesar, morituri te salutant!”
“Përshëndetje Cezar, ata që po
shkojnë të vdesin, të përshëndesin!”

Londër- Paris...

Në vjeshtë të vitit 1943 Miterani hidhet në ilegalitet. Në këtë periudhë ai quhet herë Morland, herë Purgon, Laroche, kapiteni François, Arnaud, Albret...Në dokumentet që mbante , ai figuronte si banor i qytetit Dieppe, në brigjet e La Manche, gjendja civile e të cilit ishte bombarduar dhe kështu nuk kishte asnjë mundësi verifikimi.

Natën e nëntorit të vitit 1943, pranë Angers, hipur mbi një avion të tipit “Lysander”, Miterani fluturonte tashmë drejt Londrës. Ai do që patjetër të bëjë të njohur rrjetin e vet te drejtuesit e Rezistencës Franceze në Angli, pra në shtabin e gjeneralit De Gol. Ky avion ishte i “Air Movement officer”, që ndihmonte klandestinët francezë te Rezistencës, dhe që ishte në fakt në shërbim të kolonelit Buckmaster. Ai pilotohej nga piloti Dericourt, që në atë kohë bënte një lojë të dyfishtë dhe vinte në dijeni spiunazhin gjerman për të gjitha këto lëvizje.

Sapo mbërriti, ai u vendos në një lagje periferike të Londrës dhe pas ca ditësh takoi kolonel Passy, shef i shërbimeve të veçanta goliste, si dhe kolonelin anglez, Buckmaster.

Pas prezantimit atje, një oficer i "France Libre", krijuar nga De Gol, i zgjati një letër për ta nëshkruar duke i thënë njëkohësisht: "Pra, ju do të kini gradën kapiten. Zotëri, firmosni këtu!" Miterani, i habitur, e pyeti se përse duhej të firmoste për t'u bërë anëtar i "France Libre" të Gjeneralit që të mund të quhej anëtar i Rezistencës. I vendosur, ai nuk pranoi ta firmoste.

Ndërkohë, pasi e kupton se gjithçka zhvillohet në Algjer, ku Gjenerali sapo ka zbarkuar, ai mezi pret rastin të fluturojë drejt Algjerit. Pas pesëmbëdhjetë ditësh, nën emrin e kapiten Monier, ai pret në aerodromin e Cornouailles, një avion "Dauglas", që do t'i çojë pasagjerët në Algjer. Në atë avion hipën një gjeneral, një prift, disa oficerë britanikë, disa francezë nën emra të rremë, si dhe një gazetar i "Daily Mail"

Në ato ditë të dhjetorit 1943 ai mbërrin në Algjer, ku takon Henry Frenay, një nga themeluesit e parë të Rezistencës Franceze. Në fakt Miterani i kërkon atij ta prezantojë tek gjenerali Giraud, një nacionalist që mbron në fakt pikëpamjet ideologjike të mareshallit Peten (Petain), por që në të vërtetë nuk ishte dakord me qëndrimin e mareshallit ndaj gjermanëve. Por tashmë për Miteranin ishte tepër vonë. De Gol kishte ditur ta eklipsonte shpejt gjeneralin kundërshtar.

Më 2 dhjetor 1943 Frenay e prezanton atë tek gjenerali De Gol. Për Miteranin, biseda me gjeneralin është e vështirë, pasi gjenerali nuk dëshiron figura të tjera të rezistencës brenda Frances që të punojnë të pavarur, por vetëm nën drejtimin e drejtpërdrejtë të nipit të tij, ushtarakut Michel Charette.

"Gjenerali De Gol më priti bashkë me Henri Frenay në zyrën e tij në "villa des Glycines," - kujton më pas Miterani. - Dhe ja ku para meje ishte ai, gjenerali, me një kokë të çuditshme, të vogël për trupin e tij të madh, me fytyrën e tij si të një mercenari të rrahur nga prifterinjtë jezuitë dhe me këmbët e mbledhura nën tavolinë. Ato çaste inkurajoheshin duke menduar për Stendalin. Pra ishte De Goli, ai për të cilin kisha endërruar aq shume. Në fakt ai u tregua i dashur. Kjo pak a shumë ishte përshtypja ime e parë, disi e çuditshme, as mish, as peshk, ku ai shfaqej me atë pamjen e tij qesharake. Ai më pyeti për gjendjen e Rezistencës, për metodat e punës dhe klimën që zotëronte. Megjithëse zëri i tij ishte i ngadaltë, toni filloi të ngrihej kur ai filloi të fliste për thelbin e gjërave. Ai i kushtonte shumë rëndësi propagandës nëpër

kampet , si dhe aksionit të të arratisurve që vinin ne Francë.”

Për ta bërë për vete dhe për ta larguar nga gjenerali Giraud, i cili ishte kundërshtari i De Gol, atij i propozojnë të qëndrojnë të punojë aty për Asamblenë Konsultative, por ai refuzon. Kërkon të kthehet në Londër me avionet angleze, por kapitenin Morland, “France Libre” e pengon. Në Algjer ai takon gjithashtu të vëllain e tij, Zhak (Jacques), i cili ishte vendosur në Marok dhe përgatitej të shkonte në frontin italian.

Pas takimit me De Golin, ai shkoi në Marakech, në Marok, te një mikeshë e tij, Josephine Baker, e cila jetonte në një pallat të bukur si të “Një mijë e një netët”, dhe ku ndodhej një kapiten , si dhe biri i Vezirit të Madh maroken.. Me shqetësim priste çastin më të parë për t’u larguar nga Afrika e Veriut.

Një ditë, gjenerali anglez Montgomery i krijon mundësinë e një fluturimi në Londër me një avion të tipit MTB. Në avion, krahas gjeneralit legjendar Montgomery, që kishte thyer gjeneralin gjerman Rommel, kishte disa oficerë të tjerë anglezë...dhe një ushtar gjerman. Rrugës Montgomery i thotë: “Nuk di se cili jeni dhe si jeni gjendur në këtë avion. Por do te ishte mirë të mos zbrisnit në Londër , por në Preswick, dhe pastaj bëni ç’ të mundni për të mbërritur në Londër.”

Në Preswick ai mori trenin për në qytetin londinez, që bombardohej parreshtur.

Më së fundi kapiteni Morland me një motoskaf anglez niset nga Londra për të zbarkuar në bregun breton, disa kilometra nga vendi i quajtur Roscoff, ku bashkohet me rrjetin e gjerë të Rezistencës.

Bashkëpunimi me komunistët ishte i vështirë , por i hapet. Më 26 shkurt 1944 i duhet përsëri te shkojë në Londër. Dhe përsëri një natë pa hënë. Rezistenca bretone bënte në atë kohë kalimet e klandestinëve në anën tjetër të La Manche. Deti ato net ishte plot dallgë. Një motoskaf britanik arriti në breg. I dhanë një revolver, si dhe një kapsulë cianuri për ta përdorur nëse kapej i gjallë.

“ Atë natë më dukej sikur bëja zhurmë me lopatat në ujë,- kujton per atë moment kapiteni Morland, Miteran, i cili nuk do ta përdorte fatmirësisht ate kapsule cianuri, pasi udhëtimi gjër në Londër vajti mire.

“ Gjatë kohës së luftës,- kujton Miterani,- disa herë më është dashur ta ndërroj emrin. Por emri më i njohur ka qenë Morland. Në

Angli, "La France Libre" më dha emrin Monnier. Pas luftës gjeta nja dyzet pasaporta fallco që i kisha përgatitur vetë gjatë luftës. Një moment kisha emrin Basly..."

Disa kohë më vonë, ai zbret në Veri të Francës me motoskafin anglez "Royal Navy".

Më 24 shkurt 1944, Gestapo e kishte arrestuar rastësisht në plazhin e Beg-ar-Fry, por ai me shkathtësi e kishte kapërcyer atë sprovë të papritur. Në mars të vitit 1944, perfaqësuesit e tri grupeve të mëdha të ish- të burgosurve të Luftes (MNPGD, CFLN, CNR) vendosën të shkrihen në një organizatë të vetme : "Lëvizja Nacionale e të Burgosurve dhe të Internuarve të Luftës".

Muaj më vonë, fshehurazi, hyn në Paris. Më 1 qershor 1944 një mbledhje sekrete bëhet me drejtuesit e Levizjes në një lagje aristokratike në 44, Aveny Charles-Floquet. Papritmas bie zilja e apartamentit ku janë mbledhur klandestinët. Miterani hap derën dhe një i panjohur kerkon të zotin e shtëpise, zotin Berard , një pseudonim i dikujt prej tyre. Kur tjetri doli në derë, ndjeu tytën e një revolveri. Gestapo kujtonte se nën pseudonimin Berard fshihej pikërisht kapiteni Morland. Ndërkohe, Miterani dhe të tjerët digjnin letrat e koduara të dërguara nga anglezët dhe me shpejtësi mundën të largohen.

Miterani e kupton se Gestapo e kërkon këmba- kembës dhe se një informator duhej të ishte brenda rrjetit të tyre. Bashkë me të, në atë kohë militonte në rrjetin e Rezistencës edhe shkrimtarja e ardhshme Margarite Duras.

Ndërkohë trupat franceze dhe ato aleate po i afroreshin gjithnjë e me shumë Parisit të pushtuar. Ato kohë, Miterani ndodhej në Nr.100 të "Rue Richelieu" në zemër të Parisit, ku në bodrumet e ndërtesës fshehurazi ishin grumbulluar një sasi armësh për të përgatitur sulmin e fitores. Me 19 gusht, kur ai gjendej në sheshin e Madalenes, krismat që filluan dhanë lajmin e "kryengritjes". Miterani shkon në cepin e bulevardit "Saint Michel", ku kamionet plot me gjermanë kërkojnë të shkatërrojnë barrikatadat e ngritura. Lufta ka filluar edhe më poshtë, nga Barbes.

Grupi i njerëzve të udhëhequr nga Miterani sulmojnë për të çliruar Komisariatit e Përgjithshëm të të Burgosurve në "Rue Merbeeyer", fare pranë operas se madhe "Garnier" të Parisit.

Me revole në dorë dhe me shprehje patetike ai i ishte drejtuar shefit

të këtij komisariati: “Lëshojeni këtë vend! Ky është revolucion! Ne po bëjmë revolucion!”

Duke kujtuar këto ditë në gazetën pariziane “L’Homme libre”, më 24 gusht 1944, ai kishte shkruar: “Nga Concorde e boshatisur zhvillohet dialogu i armëve: mitralozë me të shtëna të shkurtëra, të shurdhëta dhe me breshëri që jehojnë. Kalimtarët që u puthiten mureve të ndërtesave, presin që beteja të pushojë. Tanket armiq rrethojnë sheshin...Papritmas shoh “Grand Palais” që digjet. Njerëzit e mbërthyer mes të shtënave dhe flakëve vashdojnë të mbrohen...”

Duke kujtuar një ditë më pas, pragu e çlirimit të Parisit, ai shkruan: “Heshtja tashmë është kthyer. Lart, drejt Champs-Elysée jeta ka marrë pamje tjetër. Ushtari i panjohur që fle aty, dhe që nuk i dëgjon më krismat e fitores së popullit të tij, pret që flaka mbi varrin e tij, të rindizet së afërmi”.

Më 24 gusht, gjenerali De Gol arrin në Paris. Nga makina e tij ai mundi të dëgjojë ende breshërimat e fundit që shkëmbenin gjermanët e mbetur. Të nesërmen, ai përshëndet popullin në sheshin e bashkisë, në Hotel-de-Ville. Presidenti i Këshillit Kombëtar të Rezistencës, G.Bidault i thote:

“Mon General”, a do të dilni në ballkon të shpallni Republikën?”

-“Jo”, -i përgjigjet ai,-“Republika s’ka pushuar kurrë së ekzistuari. Ajo ka ekzistuar gjithnjë!”

Kryetari i Qeverisë Provizore , gjenerali De Gol, del në dritare. Turma e përshëndet “Vive De Gaulle”. “Vive Leclerc”.

Miterani është prapa gjeneralit. Njerëzit nga pas shtyjne . Bashkë me ministrin e ardhshëm të Mbrojtjes, P.de Chevigné, ata e mbajnë për këmbësh gjeneralin, i cili nga të shtyrat desh ra poshtë, drejt sheshit.

Më 27 gusht, Miterani ka rastin të takohet me Gjeneralin në ministrinë e Luftës, ku ai ka thirrur gjithë sekretarët e qeverisë Provizore. Ai u shtrëngon duart me radhë, duke i pyetur :

“Ç’profesion keni?”...

Ndërkohë, përpara tij gjendet Miterani. Gjenerali qeshi duke i thënë:

-“Prapë ju?”...

Miterani ishte veçse 27 vjeç.”Në atë kohë,- kujton Miterani-

unë dëgjoja, vëzhgoja, admiroja...Ishte fillimi i një epoke. ajo e gjeneralit De Gol.”

Në fund të luftës, gjenerali De Gol e dërgon atë të shoqërojë gjeneralin Lewis për çlirimin e kampit të Landsberg dhe Dachau. Imazhi i barbarisë hitleriane do të mbetet i pashqitur ne kujtesën e Miteranit.

Në Vishi

Disa muaj para shpërthimit të luftës, socialisti francez Leon Blum kishte deklaruar publikisht se Peten (Petain) ishte “ushtari me fisnik dhe më human i Francës”. Pra mareshalli plak e fisnik kishte pasur nje karrierë heroike që nga Verduni e këtej, por rrjedhat e kohes do ta çonin ne brigje të tjera, duke pranuar kolaboracionin me Gjermaninë naziste për çka do të dënohej me burgim të përjetshëm, gjersa do të vdiste në ishullin e vetmuar të Atlantikut, “L’Ile d’Yeu”, ku ishte burgosur dhe jetonte bashkë me gruan e tij.

Miterani zbarkoi në Vishi (Vichy) ne mars të vitit 1942, ku një mik i nënës së tij, koloneli Le Corbeiller i gjeti një punë në administratë, në zyrën e dokumentacionit dhe të shtypit për të burgosurit, ku do të fillonte në qershor të po atij viti. Maurice Pinot, do te jetë më pas komisar i përgjithshem i të Burgosurve të Luftës, një njeri që fshehurazi do të punonte për llogari të Rezistencës franceze. Në administratën e tij Miterani bëhet një specialist i pasaportave fallco që ai përgatiste për të burgosurit qe arratiseshin..

Në gusht 1942, Miterani bën pjesë në rrjetin e Rezistencës Franceze. Një mbledhje e fshehtë bëhet në kështjellën e Montmaur, ku u mblodhën shumë ish- të burgosur dhe të arratisur nga kampet

gjermane. Qëllimi i tyre ishte organizmi i Lëvizjes së Rezistencës të të Burgosurve të Luftës. Në komitetin drejtues zgjidhet dhe Miterani. Shpejt rrjeti i tyre zgjerohet dhe në Clermon-Ferrand, Valence, Nice etj. Miterani ndërkohë lëviz shumë, veçanërisht në jug të Francës, për të zgjeruar lidhjet me luftëtarë të tjerë. Në një nga udhëtimet në Lyon, ai takohet dhe me një ish- mikun e tij, Michel Cailliau, të njohur në Stalag-XI-B. Në një letër të 26 nëntorit 1943, derguar komandantit Revez në Londër, Miterani i tregon atij për Lëvizjen e tyre të Rezistencës, të lindur në tetor 1942, me iniciativën e dr. Fric. Montjoie etj, dhe me mbështetjen e komisar Pinot.

Që në prill 1942, Peten është i detyruar të thërresë në pushtet Pierre Laval, të cilin një gjysmë-grusht shteti e kishte larguar nga qeveria pak kohë më parë. Lavali zë vendin e admiralit Darlan. Më vonë, ai bën reformë në administratë, shkarkon Minot dhe në vend të tij vendos A.Masson, një shërbëtor i denjë i Lavalit. Miterani dhe gjithë ekipi i sektorit të tij japin dorëheqje në mënyrë demonstrative. Megjithatë ai vendos të qëndrojë në Vishi për punë të Rezistencës.

Më 15 tetor 1942, në "Hotel Parc" të Vishisë, mareshalli Peten, zhvilloi një takim me funksionaret e rinj të qeverisë së tij. Midis tyre ishte dhe djaloshi Miteran. "Mareshalli në atë kohë bënte një fushatë propagandistike pranë shtresave të ndryshme," -kujton më pas Miterani, kur atë, kundërshtarët politikë e atakojnë për kolaboracionizëm dhe afërsi me mareshallin Peten. Në atë kohë ai edhe do të dekorohet nga qeveria e Vishisë. Dekorata "La Francisque" përmbante në fakt betimin: "Unë ia kushtoj jetën time mareshallit Peten, ashtu siç ai ia ka kushtuar jetën e tij Frances". Kur u zhvillua kjo ceremoni ai kishte shkuar në Londër. Vite më pas Miterani do deklarojë: "Ashtu si shumë pjesëtarë të tjerë të Rezistencës, edhe unë u gjeta një ditë me dekoratën e Vishisë, ashtu si dhe miku im, mareshalli De Lattre de Tassigny."

Më 10 korrik 1943, Laval organizon një miting të madh në sallën "Wagram" të Parisit, me rastin e "Ditës Kombëtare të Lëvizjes së të Burgosurve". Në të marrin pjesë mbi tri mijë njerëz. Duke shfrytëzuar ftesën e një mikut të tij, Miterani arrin të hyjë në atë sallë, edhe pse ishte me rrezik për të. Ndërkohë që presidenti i Këshillit fliste dhe shante De Golin dhe Rezistencën franceze. Miterani u ngrit mes sallës dhe iu kundërvu: "Franca nuk është me ju, zotëri! Ju nuk

përfaqësoni askënd! Dhe nuk kini të drejtë të flisnin në emër të të tjerëve”.

Kjo ngjarje bëri buje. Miterani u largua me shpejtësi, megjithëse tashmë e dinte që kishte hyrë në dosjet e Gestapos. Më 12 janar 1944, Schuman, zëdhënësi i Francës së Rezistencës, i bën jehonë kësaj ngjarjeje përmes mikrofonit të BBC.

Më 11 nëntor 1943, Gestapo, nën urdhrat e Geissler, bastis shtëpine-zyrë të Miteranit në 20, "Rue Nationale", në Vishi. Ata arrestojnë shokun e tij P.Pilven, që ndërkohë flinte, si dhe të zotin e shtëpisë. Y. Munier mundi të hidhej nga dritarja e katit të dytë dhe të largohej. Miqtë e tij, që e prisnin atë ditë në Vishi, dolën menjëherë në stacionin e trenit për ta lajmeruar për bastisjen.

Miterani kthehet menjëherë në Clermon-Ferrand, për të mos shkelur më në Vishi.

Paslufta

Në krijimin e qeverisë së parë franceze të pasluftës, Miterani ngelet jashtë. Në fakt ishte miku i tij i Algjerit, Henri Frenay, i cili u caktua Komisar i ish-të Burgosurve të Luftes. Ai i propozoi menjëherë Miteranit që të ishte zëvendësi i tij ne kabinetin e ri, mirëpo Miterani nuk pranoi. Ai pretendonte të kryesonte vetë.

Në atë kohë, në Francë, zhvillohej procesi i “epuration”-it, i luftës kundër kolaboracionistëve. Me mijëra u futën në burgje dhe u dënuan. U pushkatuan gjithashtu dhe intelektualë të njohur të asaj kohe si G.Suarez dhe Brasillach, të cilët De Gol nuk pranoi t’i falte.

Në muajin e fundit të kapitullimit të Gjermanisë, Peteni dhe Laval, bashkë me një pjesë të administratës së Vishisë, e kishin lënë Francën. Por mareshalli Peten, 89- vjeçar, dëshironte të kthehej bashkë me gruan e tij. Kështu, ai vendos të kalojë kufirin franko-zvicëran dhe të dorëzohet. Me 22 korrik 1945 ai dënohet me burgim të përjetshëm dhe dërgohet në “l’Ile d’Yeu”, ku do të vdesë në moshën 95- vjeçare.

Pra pas lufte, Miterani është i papunë. Ai vërtitet nëpër Paris duke menduar se ç’duhet të bëhet në të ardhmen: avokat, gazetar apo politikan?

Pikërisht në këtë kohë nis të shkruajë në revisten “Libres” që

dilte në Paris. Shumë shpejt arrin në funksionet drejtuese të kësaj reviste të njohur të drejtuar nga njeфарë Haedrich dhe me një tirazh mjaft të madh për kohën: 30 mijë kopje në ditë.

Megjithatë politika ishte tentacioni i tij më i madh. Ne fillim ai hyri në organizatën politike Lëvizja për Çlirimin Nacional (MLN). Intelektuali Andre Malreaux, lejtant-kolonel i brigadës së Alsace-Lorraine, që ishte një nga udhëheqësit e kësaj lëvizjeje, ishte vënë në pararojë të sulmit kundër P.K.franceze, të drejtuar në atë kohë nga Maurice Thorez. Më pas kjo organizatë do të bashkohet me rryma të tjera politike duke krijuar "Union Democratique et Socialiste de la Resistance". Fillimisht kjo është e drejtuar nga Rene Pleven. Miterani shpresonte se kjo do të ishte një trampolinë e mirë për karrierën e tij politike. Zgjedhjet legjislative të vitit 1946 afrojnë.

Një miku i tij, E.Barrachin, i propozon të vërë kandidaturën në Nievre, kur ai erdhi ta takonte për t'i thënë se do të ishte kundërshtar i tij në zgjedhjet në Paris.

- "Nuk është nevoja ta bëni këtë,- i kishte thënë ai,-Ju do të shkoni në Nievre!"

- "Por atje s'kam asnjë shans të fitoj! Askush nuk më njeh "- i ishte përgjigjur Miterani.

- "Pikërisht pse s'ju njohin , ju do të shkoni atje. Ju nuk keni armiq personalë. Atje do të keni vetëm një socio-komunist, që do ta mundni. Ju jeni i djathtë, apo jo?"

- "Po!"

- "Atëherë unë ju garantoj gjithë votat e të djathtëve në atë departament."

Kështu, pak kohe më vonë, në Nievre, Miterani u zgjodh deputet.

Miterani do të kalojë një eksperiencë të gjatë si ministër nëpër qeveritë e ndryshme të Francës në vitet e pasluftës. 11 herë ministër gjatë kohës së Republikës IV, nën drejtimin e kryeministrave të partive të ndryshme politike, si socialiste, radikale, goliiste apo të qendrës së djathtë. Jeta e tij ministrore fillon më 22 janar 1947, kur Paul Ramadier i cakton atij postin e kabinetit të ish- Luftetarëve. Ishte qeveria e parë e Republikës IV franceze. Aty ka ministra nga të gjitha partitë: M.Thorez është zëvendës kryeministër, F. Billoux, ministër i Mbrotjtjes, Ch. Tillon ministër i Rindërtimit etj, por jo De Gol, i cili

përgatitet për një shtet unik dhe jo një shtet partish.

Në ministrinë e tij ai kishte në fillim veç komunistë. Shumë shpejt ata u hodhën në grevë kundër Miteranit. Por ai nuk u tërhoq përballë tyre. Në botën politike franceze ky qëndrim i Miteranit ra në sy. Thorez kërkon ta marrë me të mirë, por shpejt ai e kupton se Miterani është konseguent në rrugën e tij antikomuniste. Atëherë komunistët e akuzojnë në qeveri e parlament si vishist, pra si kolaboracionist. Por megjithatë Miterani vazhdon me të njëjtat ide nga një qeveri në tjetrën.

Në korrik të vitit 1950 ai është ministër i Francës për Përtejdetin (Autre-Mer), më 1954, ministër i Brendshëm në qeverinë e Mendes-France. Kredoja e tij në këtë kohë është “Algjeria është Francë. Nga Flandres në Kongo, zotëron ligji francez”. Më 1953, kur ishte në qeverinë Laniel me funksionin si ministër i deleguar pranë Këshillit të Evropës, ai jep dorëheqjen. Ai e kishte kuptuar se kjo qeveri do të binte shpejt dhe shpresonte në zgjedhjen e menjëhershme të Mendes-France, i cili do t’i afronte një post më të mirë.

Antigolisti

Më 1958, gjenerali De Gol kthehet në pushtet. Pikërisht në këtë periudhë, Miterani kalon në opozitë, duke u afruar gjithnjë e më shumë me të majtën. Ai është nga të rrallët politikanë të asaj kohe që e kundërshton hapur Gjeneralin. Për të, periudha e gjatë e “sundimit” te Gjeneralit do të jetë një diktaturë. “Unë e quaj regjimin golist një diktaturë, sepse shoh forcimin e pareshtur të pushtetit personal,-” deklaronte në atë periudhë Miterani. Ai do të shkonte akoma më larg duke pohuar se “golizmi është De Gol plus policia”. Ai e kritikonte De Golin se ai i kishte “uzurpuar të gjitha çështjet e shtetit”, se “ushtronte censurë” dhe se “centralizmi është në kundërshtim me aspiratat e lirisë” etj. Kjo luftë kundër De Golit, bëri që ai të spikaste në radhët e opozitës, si një nga anëtarët më të talentuar. Në këtë periudhë ai do të shkruajë librin e tij “Le coup d’Etat permanent”, ku shquhet si akuzues i flaktë. “Midis De Golit dhe republikanëve do të ketë gjithnjë një grusht shteti”.

Në këtë kohë, çështja e Algjerise bëhet shqetësuese. Gjenerali do me çdo kusht që ajo të mbetet franceze. Por jehona e atentateve e trondit shpejt opinionin publik. Perpara Senatit, më 1959, senatori Miteran, opinionet e të cilit kanë evoluar tashme në favor të një

Algjerie të pavarur, deklaroi: “Ndodhi që unë u bashkova me një politikë, efektet e së cilës sot janë të dëmshme. Unë i kërkoj ndjesë para kombit”.

Natën e 15-16 tetorit 1959, Miterani, senator i Nievre, duke shkuar me makinë në shtëpinë e tij, në rrugën Guynemer, kupton se po ndiqet nga një makinë tjetër. Në nxitim e sipër ai lë makinën e tij në kopshtet e Observatorit dhe kërkon të largohet me shpejtësi i ndjekur nga një breshëri automatiku. Te nesërmen, gazetata pariziane flisnin për atentatin kundër Miteranit. E majta, e prekur nga kjo, shpertheu një sulm kundër të djathtës. Por ndërkohë një deputet republikan, R. Pesquet, e akuzon Miteranin se është pikërisht ai që ka sajuar gjithë këtë histori. Miterani përgjigjet se është viktimë e një makinacioni politik. Deputetit republikan i hiqet imuniteti parlamentar, por pas pak kohe çështja mbyllet për mungesë provash.

Në këtë periudhë, marrëdhëniet mes Miteranit dhe De Golit ashpersohen në kulm. Ata e urrenin njëri-tjetrin. “De Goli ishte një njeri i shekullit 19 dhe që u kaloi anash dhe tangent ideve të mëdha të epokës së vet, pra të shekullit të 20-ës.”- do të deklaronte më pas Miterani.

Zemërimin kundër Gjeneralit, Miterani e ruajti për shumë kohë. Edhe në 40- vjetorin apo 50- vjetorin e zbarkimit të aleatëve në Normandi, në fjalimet e tij, ai nuk e përmendi fare emrin e Gjeneralit.

“Ai refuzoi t’i jepte Cezarit atë që i takonte.”- u shpreh akademiku Alain Peyrefitte, një nga besnikët e De Golit.

Nga fundi i viteve 80, duke e pyetur rreth Gjeneralit, Miterani do të përgjigjet: “ Është e vërtetë që nuk kam menduar për De Golin. Megjithatë herë herë e piketakoja imazhin e tij dhe shpesh për të mirë. Por unë nuk e konsideroj atë si një referencë për veten time. Në fakt, ai ishte një strateg i madh dhe për këtë jam dakord. Por ai nuk e parashikoi ardhmërinë e Evropës dhe as atë të Botës së Tretë”.

“Ultima ratio regnum”
“Argumenti i fundit i mbretërve”

Mbishkrim i Luigjit XIV në topat e
ushtrisë mbretërore

Maj '68

Maji i vitit 1968 ishte një nga ngjarjet më të rëndësishme që do të kalonte shoqëria franceze që nga koha e pasluftës. Personazhet kryesore të këtyre ngjarjeve ishin De Gol, Cohn-Bendt, ish-kryeministri francez Mendes-France dhe Miteran.

Me 3 maj, shkëndia e parë e kësaj lëvizjeje u ndez në Sorbonë. 300 studentë shpërthejnë nëpër rrugët e Quartier-Latin dhe në bulevardin Saint-Michel. Udhëheqësi i rinisë ishte Cohn-Bendt. Ishte një lëvizje që do të zgjerohej me shpejtësi dhe që përfshiu gjithë Francën, një lëvizje me karakter të fortë social e politik, në ballë të së cilës u vune së pari komunistët e trockistët e pastaj socialistët dhe intelektualët e majtë. Atë ditë që studentët shpërthenin në Sorbonë, gjenerali De Gol kishte ftuar për drekë në Elysée komikun e njohur Fernandel. Në Sorbonë, policia kishte ndërhyrë me ashpërsi dhe kishte arrestuar një mori studentësh , të cilët mbanin te pushtuar Sorbonen, që jehonte nga thirrjet “Ndal dhunës!”, “Lironi shokët tanë! .”si dhe nga këngët e Beatles dhe Rolling Stones. Rektori i Universitetit njofton mbylljen e Sorbonës.

Miterani në atë kohë ishte në bashkinë e vet në

Chateau-Chinon.

Më 6 maj, revolta zgjerohet. Ngado flitet për Marks-in dhe diktaturën e proletariatit.. Më 7 maj manifestuesit marshojnë drejt Harkut të Triumfit. Megjithatë përleshën me policinë , ata arrijnë më së fundi në Harkun e Triumfit. Natën sheshi është pushtuar nga studentët.

Miterani e kupton se është momenti për të vepruar. Një shans për ta kthyer këtë revoltë në një sulm politik për rrëzimin e De Golit. 9 maji është prag lufte midis studentëve dhe policisë. Disa ditë më vonë në arenë hyjnë sindikatat e punëtorëve. Revolta punëtorë paralizon krejt Francën. Më 17-20 maj greva e përgjithshme. Studentët thërresin “Rrofte Mendes-France!” Miterani është me ne!”. Miterani kishte qenë kandidati unik i se majtës më 1965 dhe nisur nga kjo ai mendonte se situata mund të përmbysej dhe në krye të vinin socialistët.

Ndërkohë Sartri shkon në Sorbonë dhe bashkohet me studentët. Franca përjeton kështu krizën më të madhe sociale e politike. Gjenerali e kupton se s’mund të bëhet ndryshe. Punëtorët kanë pushtuar uzinat dhe fabrikat.Për Gjeneralin rruga e vetme është referendumi. Me 24 maj De Goli flet në televizion. Ai e kupton se politika e tij ka deshtuar. Bursa në zemër të Parisit digjet nga flakët dhe jeta politike zhvillohet me shpejtësi. Çdo orë ka zhvillime të reja.

Por Miterani nuk do të “shtrëngoje duart” me komunistët. Më 28 maj, në një konferencë shtypi ai thote :”Me ikjen e gjeneralit De Gol me 16 qershor, dihet që qeveria dhe kryeministri i saj Pompidu do të bien. Une propozoj krijimin e një qeverie provizore që të vihet në veprim. Nëse do të duhej , unë do ta merrja përsipër përgjegjesinë e krijimit të kësaj qeverie, ashtu siç mund ta bëjnë këtë dhe të tjerë. Por unë mendoj së pari për Mendes-France...”

Fjala e tij gjeti jehonë në rrethet politike. Kudo flitej për krijimin e shpejtë të një qeverie të re. Miqtë e tij te afërt të asaj kohe ishin Roland Dumas, i cili më vonë do të jetë ministri i tij i Jashtëm dhe Kiejman, një nga intimët e tij gjatë tërë mandantit të tij presidencial.

Në këtë periudhë komunistët takohen disa herë radhazi me Miteranin. Por ai ka parashikuar që në qeverinë e ardhshme, ndër dhjetë ministra, vetëm një të jetë komunist. Kjo nuk u pelqen komunistëve, të cilët mendojnë për një çast se shume pak i ndan ata

nga marrja e gjithë pushtetit në duart e tyre. Në projektet e tyre ata nuk mendojnë për Miteranin, bile dhe për Mendes-France ata kanë propozuar vetëm postin e ministrit të arsimit.

Më 29 maj De Gol është zhdukur. Askush nuk e di se ku ka shkuar. Kryeministri Pompidu e kërkon ngado. Ministria e Mbrojtjes njofton se helikopteri i Gjeneralit është ndalur në Saint-Dizier për të furnizuar me karburant dhe pastaj u ka ikur radarëve. Gjithçka i ngjan një filmi policesk. Më së fundi merret vesh se ai ka shkuar ne fshatin e tij në Colombey.

Gjenerali po kalon kohën më të zymte të jetes së tij. Të nesërmen ai kthehet në Elysée dhe deklaron ne Këshillin e Ministrave "Une kam mandatin e popullit dhe do ta përmbush gjer në fund atë. Unë nuk tërhiqem! Sot njoftoj shpërndarjen e Asamblesë Kombëtare dhe i propozoj popullit referendumin!"

Majtistët e cilësojnë këtë veprim të Gjeneralit si diktatorial. Komunistet nuk pranojnë të lenë sallen e Asamblesë Nacionale. Salla jehon nga "Marsejeza", por pastaj dhe golistët e këndojne ate.

Por ngjarjet e mëpasme do të sjellin fashitjen e lëvizjes së studentëve dhe punëtorëve. Nga frika e ardhjes së komunistëve në pushtet golistet morën zemër dhe filluan manifestimet e tyre. E djathta filloi revanshin e vet, duke mbushur rruget me thirrjet : "Rroftë De Goli! Miterani- sharlatan!"

Por edhe në manifestimet e së majtës, shumica e studentëve dhe e punëtorëve nuk shpresonte në ardhmërinë e një qeverie të kryesuar nga Miterani. "As De Gol dhe as Miteran!" thërrisnin ata nepër rrugë.

Në skenën e historisë moderne të Francës kishin zbritur tashme ultra-majtistët e gjer tek maoistët, të cilët deklamonin utopinë.

“Nascuntur poetae, fiant oratores...”
“ Lindesh poet dhe bëhesh orator...”

Socialisti

Kalimi i Miteranit në të majtën franceze ishte i ngadaltë. Ai e kuptoi se duke u mbështetur në të majtën, duke bërë kompromis me ultramajtistët, mund të vinte në pushtet.

Në fakt, Miterani nuk e kishte fituar ende kredon si një udhëheqës i së majtës.”J’ai manqué la Revolution...mais il n’y a pas eu la Revolution ,” do të shprehet më vonë ai.

Ngjarjet e vitit 1968 i dhanë atij një mësim të madh. Gjer atëherë ai nuk i kishte kuptuar në fakt principet themelore që vinin në lëvizje të majtën franceze. Kështu, ai nis ngjitjen këmbëngulëse dhe te vështire drejt udhëheqjes së Partisë Socialiste franceze, duke krijuar fillimisht një korent më vete të cilin e udheheq ai vetë.

Vitet kalojnë. 1971, kongresi i Partisë Socialiste në Epinay-sur-Seine. Tri ditë pas këtij kongresi të rinovimit të Partisë, pra më 16 qershor 1971, ai u zgjodh Sekretar i Parë i Partisë Socialiste franceze. Nga tribuna e atij kongresi, ai foli për ardhmërinë e së majtës në Francë. Ishte nga fjalimet më të bukura të jetës politike të Miteranit, çka bëri që me shumicë votash dhe në mënyre të papritur ai të zgjidhej në krye të Partisë. Bindjet e Miteranit janë konsoliduar

tashmë.

“Socializmi, - deklaroi ai në një konferencë shtypi,-bën pjesë në një nga traditat e mëdha politike e sociale të Francës që nga viti 1840, dhe unë mendoj që kjo ide do ta vazhdoje udhën e saj. Ajo është njëkohësisht një teori, një shpresë, shpesh është një ëndërr. Ja që unë i përkas kësaj shkolle idesh.”

Pra, në kohën e Republikës V franceze, Fransua Miteran u bë rinovuesi i Partisë Socialiste dhe “zëdhënësi” i së majtës popullore.

“E majta, - deklaronte ai,- është një filozofi e jetës. Ka nga ata te cilët nuk duan që bota të ndryshojë, ka të tjerë që jo vetëm pranojnë por e kërkojnë atë me ngulm; pastaj ka të tjerë që e ëndërrojnë për një parajsë të humbur. Kjo është e djathta. Ka nga ata që ëndërrojnë për një botë të përsosur në të ardhmen. Kjo është e majta!”

Në fakt, Miterani, gjatë gjithë këtyre viteve, do të evoluojë në konceptet e tij politike për socializmin në tërësi dhe socializmin francez në veçanti. Megjithatë ai ruan respekt për Marksini si filozof. “Kontributi i Marksit për mendimin modern mbetet i madh. Por unë çmoj më shumë kritikën rreth Marksit se sa vetë Marksini. Në krahasim me Marksini, vepra e Frojdit është më e rëndësishme, sepse përbën një revolucion për botën e ideve të kohës sonë”.

Më 1989, më rizgjedhjen e tij president i Francës, Miterani do të ndihej në kulmin, në apogjeun e vet. Në kuadrin evropian, e majta kishte bërë një progres të jashtëzakonshëm: Gonzalesi kishte fituar në Spanjë, Bettino Craxi ishte në Romë, Oskar Lafontaine bëhej gati gjithashtu për të marrë pushtetin, influenca e Margarit Theçer po binte gjithnjë e më shumë. Ai shpresonte në këtë kohë për ndërtimin e një Evrope social-demokrate.

“Socializmi është një filozofi, është shpjegimi i botës që vlen për gjithë punëtorët e kësaj toke, qëllimi i saj është ndërtimi i një shoqërie universale.”

“Jure et facto”

Henri IV shpallet mbret “jure et facto” veçse pas hyrjes së tij në Paris

“Monsieur le Président !”

Para zgjedhjeve presidenciale të vitit 1981, e djathta ishte perçarë. Ne arenën politike nga e djathta ka dale dhe një pretendent tjetër: Zhak Shirak. Për të Zhiskar do të nënkuptonte “ritje të papunësisë”, “ritje të çmimeve”, “dobësim i brendshem dhe i jashtëm i Francës”. Por nga ana tjetër edhe në të majtën franceze ka krisje, perçarje.

“Humanité”, organi i P.Komuniste Franceze shkruan se “Miteran është kandidat i dështimit” dhe se është mundur dy herë në zgjedhjet presidenciale: nga De Gol dhe Zhiskar. Në fakt Zhorzh Marshe(Georges Marchais) e akuzon atë për shumë mëkate. Per ta Miterani është thjesht një përfaqësues i borgjezisë që ka përqafuar të majtën.

Më 8 mars, “Express” boton njoftimin me titullin “Gënjeshtër”, duke pohuar përmes dokumenteve gjermane se Marsheja në vitin 1944 ishte ende në Gjermani, në një kohë që ai e kishte përgënjeshtuar më parë atë. Nga ana e saj “Humanité” akuzon Miteranin se është në krye të kësaj fushate kundër Marshesë.

Sondazhet në atë kohë njoftojnë se fitues në zgjedhjet

presidenciale do të jetë Zhiskar , i cili do të mundëte dhe M.Rocard, si rival kryesor. Më 19 tetor, Rocard kishte shpallur kandidaturën. Miterani nuk kishte bërë asgjë për ta penguar atë. Ai priste zhvillimin e ngjarjeve gjer në pragun e zgjedhjeve. Kur ai do të shpallë kandidaturën, sipas premtimit në Kongresin e P.S. në Metz, ai do të tërhiqet. Në fakt, kandidati unik i P.Socialiste do të shpallet më 24 janar 1981 në kongresin e jashtëzakonshëm të Creteil.

Të dielën, më 26 prill zhvillohet turi i parë i zgjedhjeve presidenciale. 30 milione francezë votojnë. Surpriza e parë : Zhiskar e kalon Miteranin me 715000 vota, pra 28,3% me 25,84%. Surpriza e dytë, kandidati i P.K.franceze merr më pak vota se Shiraku. Kurrë ndonjëherë komunistët nuk kishin rënë kaq poshtë në zgjedhje. I mbetet tani kryetarit të Bashkisë së Parisit, Shirakut, të luajë rolin e arbitrit midis dy pretendentëve kryesore. Gjithashtu dhe Marsheja duhet të vendosë se kujt do t'ja japin voten komunistët në turin e dytë. Ai u thote njerëzve të afërt:

“Ne nuk do të bëjmë lojën e të djathtëve. Duhët të votojmë për Miteranin!”. Nga ana tjetër, Shirak do të shprehet në shtyp se personalisht ai do t'ia japë votën Zhiskarit, por partia e tij mund të vendoste sipas dëshirës. Pra, nga të gjithë u kuptua qartë reticenca e Shirakut , i cili kishte pasur divergjanca më parë me presidentin Zhiskar.

Përpara votimit të dhjetë majit, u zhvillua debati televiziv midis dy kandidatëve kryesorë, debat të cilin, shtatë vjet më parë e kishte fituar Zhiskar, i cili ishte sjellë si “profesori para nxenësit”.Por këtë radhë rolet do të ndryshonin.

Miterani nga ana e tij kërkoi që intervistën ta drejtonin gazetarë të pavarur. Tashme ai kishte përvojën e hidhur të debatit të dikurshëm. Ky debat u zhvillua ne studion 101 të Shtëpisë së Radios, tri ditë para zgjedhjeve. Në këtë debat, Miterani tregoi aftësitë e tij të rralla shprehëse, çka i la të kuptojë telespektatorit epërsinë e programit te tij. Përpara televizorëve 31 milionë francezë ndiqnin këtë debat historik për të majtën franceze.

10 maj 1981. Në orën 20 të mbrëmjes, ordinatori CH-Honeywell Bull, shpaloste portretin e presidentit fitues. Francezët panë të dukej portreti i Miteranit. 51,75% kundrejt 48,25%. Turmat e socialistëve rendën drejt sheshit të Bastijes për të festuar atë natë

gëzimin e fitores.

Që prej një shekulli e majta ishte përjashtuar nga pushteti. Fitorja e Miteranit ishte një festë e jashtëzakonshme për popullin e së majtes, siç e quanin veten socialistët, komunistët dhe trockistët bashkë. Entuziazmi ishte pa dyshim i papërshekruar, patetik dhe romantik. Jack Lang, i cili më pas do të emërohej minister i Kultures, shprehej se “Më 10 maj, francezët kapërcyen kufirin që ndante natën me ditën”; shkencëtari Haroun Tarzieff, që më pas do të bëhej sekretar Shteti, shprehej se “Une kam përjetuar momente të mëdha gjatë jetës sime: Frontin Popullor, zbarkimin e Aleatëve më 6 qershor 1944, çlirimin...Por ajo që po përjetoj sot, i kapërcen ato ç’kam jetuar. Ne rigjetëm lirinë dhe demokracinë”; Pierr Mauroy, që do të bëhej kryeministër, tha se “Është një ag i ri që zgjohet. Me ne e vërteta do të dalë në dritë të vërtetë”; ndërsa shkrimtari argjentinas Julio Kortazar shprehej: “Unë banoj në Francë që prej 30 vitesh dhe është hera e parë që kam kaq shumë shpresë”.

Ndër të parët që e pergëzuan për zgjedhjen e tij, ishte dhe presidenti amerikan Roland Regan, i cili e konsideronte atë si një antikomunist dhe më antisovjetik se paraardhësi i tij D’Esten. Më 21 maj 1981, nën tingujt e himnit të “marsejezës” të kompozitorit francez Berlioz, me një trendafil në dorë dhe në prani të një turme entuziazte, ai ngjiti rrugën Soufflot, duke iu drejtuar Panteonit. Ai nderon atje së pari socialistin e madh Jean Jaures, heroin e Rezistencës Franceze Jean Molin dhe profetin socialist, ish-ministrin e Marinës në kohën e Revolucionit të 1848 dhe përkrahës për lirinë e skllëvërve, Victor Schoelcher.

Tri trëndafilë të kuq mbi varret e tyre: një gjest që bashkonte në një të vetme Socializmin, Rezistencën dhe mbrojtjen e Parisit. Kur del nga Panteoni, turma prej mijëra vetësh e përshëndet me “marsejezen” dhe thirrjet ekzaltuese.

Kjo ceremoni mediatike e shfaqti Miteranin në sytë e francezëve si president të një epoke të re. “Atë ditë,- shkruan shkrimtari çek, Milan Kundera,- presidenti francez donte t’i mblidhte bashkë të vdekurit”. Ndërsa “Le monde”, do të shkruante se “vajtja e tij në Panteon, për t’u takuar me pararendësit e vet, të cilit kishin hapur portat e Historisë popullit të Francës, ishte më shumë se një akt respekti, ai ishte një akt besimi!”

Në “Rue de Bievre” ku banonte Miterani, ne cep të “Quartier latin”, ai filloi të takonte miqtë e tij dhe të bisedonte për formimin e qeverisë së re. Më së fundi Pierr Mauroy caktohet kryeministër. Në qeverinë e parë do të jenë dhe Jacques Delors, ministër i Ekonomisë, Jack Lang, ministër i Kulturës, Gaston Deferre, ministër i Brendshëm etj. , si dhe katër ministra komuniste, sipas marrëveshjes së bërë shumë kohë më parë me P.K.franceze. Në tryezën e tij të punës gjendej ende “Programi i 110 propozimeve”, nenshkruar nga socialistët dhe komunistët. Ç’do të bënte me to?...Por Miterani nuk nxitohej.

Nga fundi i vitit 1981, inflacioni shtohet, franga bie shumë në raport me dollarin, po kështu shtohet edhe numri i të papunëve. Gjendja ekonomike bëhet kritike.

Në shkurt të vitit 1982 bëhet nacionalizimi i pesë grupeve të mëdha industriale si “CGE”, “Saint-Gobin”, “Thompson”, “Pechiney dhe Rhone Poulenc”, si dhe 39 banka e dy kompani financiare: “Paribas” dhe “Suez”.

Por PK Franceze shpresonte që zhvillimet politike e ekonomike të shkonin në favor të politikës së tyre. Nga masat e para të qeverisë, komunistët filluan nga kritikata. Por Miterani e kishte përcaktuar linjën e tij. Ai i paralajmëroi se ata nuk duhej të kritikonin një qeveri ku ata bënin pjesë. Dhe kjo gjendje, siç e kishte parashikuar, ai nuk do të zgjaste shume. Komunistët francezë me në krye Marshene i tërhoqën nga qeveria ministrat e tyre. Divorci i komunisteve me socialistet u prononcua zyrtarisht.

Një epërsi të veçantë në këtë kohë, Miterani i kushton forcimit të monedhës franceze, uljes së papunësisë, arsimit dhe kërkimeve shkencore. Ai mendon se pjesëmarrja aktive e Frances në Tregun unik do të sjellë një progres të madh në planin ekonomik teknologjik e social.

Vite më vonë, më 16 mars 1986, e djathta fiton në zgjedhjet legjislativë. Partia e Zhak Shirakut RPR në koalicion me atë të Zhiskar D’Esten, UDF, fitojnë shumicën e vendeve në Parlament. Në prill Shiraku caktohet kryeministër. Në Matignon, kryeministri, në pushtet është e djathta, ndërsa në Elysée, presidenca, në pushtet janë të majtët. “Detyra ime,- deklaroi në këtë kohë Miterani, -është të siguroj vashdimësinë e shtetit dhe funksionimin e rregullt të institucioneve.” Për të e rëndësishme është Kushtetuta, e cila në Francë ka një traditë të

lashtë. Vitet 1986-1988 janë periudha e parë e bashkëjetesës me të djathtën. Periudha e dyte do të jëtë në fundin e mandatit të dytë presidencial të Miteranit, ne vitet 1993-1995. Kryeministër kësaj radhe caktohet Eduard Balladur.

Gjatë dy mandateve të tij, rëndësi të veçantë Miterani i kushtoi politikës se jashtme, asaj evropiane në veçanti, zhvillimit të ekonomisë, të kulturës dhe arsimit, përsosjes së mëtejshme të institucioneve. Miterani lejoi krijimin e stacioneve të lira e private radiofonike e televizive.

Idetë e Miteranit në politikën e jashtme janë të qarta : pavarësi nacionale, ekuilibër i blloqeve ushtarake ne botë, ndërtimi i Evropës, e drejta e popujve për vetvendosje, zhvillimi i vendeve të varfra. Kujdes ai i kushtoi gjithashtu ruajtjes dhe zhvillimit të frankofonisë. veçanërisht në ish kolonitë franceze, vendet afrikane etj. duke organizuar takime të nivelit të Lartë për frankofoninë, siç ishte ajo e vitit 1986 e më pas.

Midis shumë gjërave të tjera, nën pushtetin e drejtpërdrejtë të Presidentit ishin dhe tri çështje : gjuha frënge, audiovizueli dhe veprat e mëdha. Ai kishte një dobesi të veçantë për gjuhën franceze. Me rastin e 350- vjetorit të Akademise Franceze, ai citon thënien e historianit të madh francez Fernand Braudel se "Franca para se gjithash është gjuha frënge". "Gjuha , - thoshte Miterani , -ka të bëjë me gjërat tona më të rëndësishme, me strukturat njerëzore".

“Ita diis planuit...”
“Kështu u pëlqeu Zotave”

Pallati i Elizesë

Fill pas zgjedhjes, kur hyri në pallatin Elize (Elysée), në një intervistë televizive, Miterani iu drejtua francezëve: “President i gjithë francezëve unë dua t’i bashkoj të gjithë ata për kauzat e mëdha që na presin”...

Elizeja është një pallat i madh , hijerëndë e madhështor, ku gjatë Republikës V kishin qëndruar më parë gjenerali De Gol dhe Valeri Zhiskar d’Esten (Valery Giscard D’Estaing).

Miterani nuk donte të qëndronte në zyrën e paraardhësit të vet, i cili e kishte mobiluar dhomën me mobilje klasike të kohës së Luigjit XVI. Ai preferoi më mirë byronë ku kishte punuar dikur gjenerali De Gol. Mobiljet lluksoze shpejt u vunë në sallonet e pritjes dhe dekori blu, i preferuar prej tij, filloi të pushtonte pallatin e Elizesë. Aq shumë e pëlqente ai ngjyrën blu sa që dhe stilografi me të cilin ai firmoste, ishte me ngjyrë shkrimi blu. Kopshti i pasmë i Elizesë ishte një nga kënaqësitë e tij. Menjëherë vuri shatërvanë dhe filloi të kujdesej me mbjelljen e disa pemëve dhe gjelbërimin e tij. Ne shtigjet e kopshtit të madh ai shetiste i ndjekur nga qeni i tij, një “labradur” balltik.

Çdo mëngjes lexonte gazetën, degjonte radion, herë herë ndiqte spektaklet televizive plot humor e karikatura politike të "BebÛtes Show". Në Elize, "monarku" i ri vuri rregull dhe kërkoi që gjithçka të kishte peshën dhe hijen e një pallati presidencial. Në dekorat, mënyrën e pritjes, ceremonitë, etj. e gjer tek veshjet e punonjesve të administratës. Ai nuk pranonte të vinte dikush i veshur me "blu-xhins". Shpesh miqtë i ftonë për dreka në Elize. Gazetarëve u ruhej, pasi nuk kishte dëshirë të hapej në jetën e vet private. Kështu Daniela dhe fëmijët mbetën gjithnjë në "hije". Daniela ishte e pranishme vetëm në raste të veçanta ceremoniale dhe tepër të rëndësishme. Kështu ajo filloi të merrej me aksione humanitare dhe të drejtat e njeriut, çka e ktheu dhe atë në një personalitet të jetës sociale franceze.

Në diplomatët e huaj kishim rastin ta shijonim bukurinë e pallatit Elize në rastet e vizitave të nivelit të lartë apo të festave kombëtare të Francës. Kam parasysh festën nacionale të vitit 1991 dhe atë të vitit 1992 kur në Elize, pas parakalimit tradicional, nëpër Champs-Élysée dhe në Concorde, Miterani mbledhte të ftuarit në një drekë zyrtare. Më 14 korrik 1992, më kujtohet kur gazetarët e TV1 u mbledhën rreth tij në cep të oborrit, dhe ku Miterani u ul në atë dekor të gjelbëruar për të dhënë një intervistë. Si gjithnjë në këto raste, ai mundahej të tregohej i shpenguar dhe shumë i qeshur, duke nisur shakatë me gazetarët. Në atë mjeshtëri të gjelbër siç duket ai e ndjente veten mjaft të çliruar.

Elizeja është një pallat që vërtet të impresionon me arkitekturën, mobilimin dhe tabllotë brenda tij. Ai ishte ndërtuar në vitin 1718 nga konti Evreux duke marrë emrin "Hotel d'Evreux". Por më pas ky zoterim kaloi ndër duar të ndryshme aristokratësh dhe fisnikësh të mëdhenj, si zonja Pompadur, etj. Pikërisht këtu kishte ndenjur Napoleon Bonaparti dhe monarkë të tjerë.

Presidenti i parë që u vendos këtu, ishte Louis-Napoleon. Kështu, që nga vitit 1871, pallati i Elizesë u bë pallati presidencial. Pastaj shumë emra presidentësh u lidhën me pallatin Elize: A. Thiers i kohës së Republikës së III franceze, presidentët e Republikës IV si P. Mac-Mahon, J. Grevy, S. Carnot, P. Deschanel, A. Millerand, G. Doumergue, P. Doumer, A. Lebrun dhe V. Auriol, si dhe më pas presidentët e Republikës V, ku P. Coty do të përshëndeste ardhjen e

gjeneralit De Gol.

Pas De Golit, me 1974 ishte Giscard d'Estaing që hyri në pallat, duke ndërruar gjithë ngjyrat e mureve, mobiljet, bile dhe ritmin e "Marseillaise", duke vendosur atë që konsiderohej e kohës së Napoleonit III, me një ritëm të ngadaltë.

Miteran do të qëndronte 14 vjet radhazi ne pushtet dhe në atë pallat do të kalonte koha më intensive e jetës së tij. Natën, kur dyert e Elizesë mbylleshin, rridhte jeta e qetë e familjes Miteran, bisedat intime, miqtë e afërt, refleksionet filozofike...

“Farewell” , “Rainbow Warrior” dhe afertet e tjera

Në vitet e para të presidencës, Miterani u informua për një veprimtari të gjerë spiunazhi që zhvillonte në Francë ambasada e Bashkimit Sovjetik. Në këtë situatë, ai mendoi t’i japë një goditje mediatike, duke kërkuar dëbimin nga Franca e gjithë atyre që ishin zbuluar të tillë. Në fakt, një agjent rus, Vladimir Volodia dekonspiroi pranë shërbimit informativ francez. Emri i tij tashmë i koduar ishte “Farewell”. Dëbimi i spiunëve të dekonspiruar rusë u bë në vitin 1983. 47 “diplomatë” sovjetikë u përzhunë nga Franca. Kjo ngjarje gjeti një jehonë të gjerë.

Por nga ana tjetër, Miterani do të kalonte sprova të vështira me afere që preknin miqtë e tij besnikë.

Në vitin 1985, Franca përgatitej të bënte provat berthamore në zonen e Muruora. “Greenpeace”, një shoqatë e fuqishme ekologjike, që luftonte kundër provave berthamore dhe për ndalimin e tyre, përgatitej për të nisur një fushatë antibërthamore, propagandistike e paqësore, kundër Francës. Për këtë, anija “Rainbow Warrior” e ankoruar në portin Auckland të Zelandës së Re, bënte përgatitjet e

fundit për të marrë drejtimin drejt oqeanit. Por misioni i saj dështoi, pasi një eksploziv i vendosur fshehurazi në skafin e anijes, e çoi atë në fundin e detit. Një fotograf portugez që gjendej në bord, gjeti vdekjen nga shpërthimi. Ishte mbrëmja e 10 korrikut 1985.

Ndërkohë ngjarja ben zhurmë në arenën ndërkombetare dhe në opinionin publik. Dy agjentë francezë arrestohen nga policia neo-zelandeze. “Raporti Tricot” konfirmon se më 26 gusht, agjentë francezë ndodheshin në Zelandën e Re me mision: “Greenpeace”! Në fakt, dy zhytes francezë kishin vendosur atë natë nën anije dy bomba dhe ishin larguar drejt bregut në fshehtësi. Kjo ishte vepër e komandant A. Mafort dhe kapiten D.Piereur. Të gjithë akuzojnë qeverinë dhe ushtrinë franceze për këtë akt agresiv dhe kriminal.

Kush vallë kishte urdhruar një mision të tillë?...

Përballë sulmeve gjithnjë e më të mëdha, qeveria franceze deklaroi fillimisht se ata vetëm kishin survejuar anijen e “Greenpeace”. I bindur për këtë gjë nga vartësit e vet, Miterani u del në mbrojtje ushtarakëve. Por dokumentet që zbulohen, flasin për të kundërtën, dhe se fajtorë për këtë është DGSE franceze, pra “Drejtoria e Përgjithshme e Sigurimit të Jashtëm”. Ministri i Mbrojtjes shkarkohet. Qeveria franceze detyrohet të zhdëmtojë qeverinë neo-zelandeze me 9 milione dollarë, ndërsa “Greenpeace” më 8,1 milionë dollarë. Miterani këtë radhë në deklaratën e tij flet për një “akt kriminal e absurd”. Por kjo e cenoi shumë figuren e Francës në arenën ndërkombëtare.

Tashmë janë të njohura 2000 përgjigjet telefonike të Elizesë. Kjo histori, për të cilin është shkruar se fundi dhe një libër, i përngjan një romani policor “polar”.

Më 12 janar të vitit 1995, një grua misterioze e veshur në të zeza, dorëzon “incognito” në Pallatin e Drejtësisë në Paris, një qese plastike ngjyrë roze, për “Gjykatësin Berger” dhe largohet me shpejtesi. U kerkua i famshmi gjykatës Berger, i cili nuk ekzistonte në Pallatin e Drejtësisë. Shpejt u zbulua se kishin të bënë me pesë disketa informatike BACKUP-1..Janë aty regjistrimet e bisedave të majft gazetareve dhe politikaneve, që në ilegalitet të plotë janë përgjuar nga një grup xhandarësh të Elize-së. Por a dinte presidenti për një gjë të tillë?...

Çdo informacion ishte i shtypur nëpër fisha, çka duket e

pabesueshme për një vend si Franca. Midis tyre, aktorja e njohur Carole Bouquet, keshilltari i presidentit Regis Debrey, Dina Vierny, ish- modele e skulptorit Maillol, si dhe Aga Khan, shkrimtari Arrabal, politikania Martine Aubry, Rafic Hariri, që më pas do të bëhet kryeministri i Libanit, Maurice Rheims, shkrimtar akademik, Jacques Seguela, këshilltar i Presidentit e gjer te gruaja e tij e fshehtë, Annie Pingeot. Ndër dy mijë personalitetet e përgjuara gjenden gjithashtu edhe emrat e gazetarëve të gazetës “Le Monde”, Edwy Plenel dhe Jean-Marie Colombani, kritikut Bernard Pivot , biseda midis shkrimtareve E.J.Hallier dhe Ph. Sollers, etj. Në krye të këtij përgjimi të fshehtë janë komandant Prouteau dhe zëvendësi i tij , kapiteni Barril.

“Europe, ma patrie”

“Evropë, atdheu im”

Jules Romain

Testamenti i tij, Evropa.

“Testamenti i tij ishte-një Evropë e bashkuar,”-shkruante gazeta amerikane “New York Times” në janar të vitit 1996, në homazh të ish- presidentit Miteran.

A nuk ishte ai një nga evropianet e orëve të para?

Ky pasues i Zhoresit dhe Leon Blum-it, i Monese dhe Rene Kasen, mbështeti idenë e Evropës së Bashkuar që në kongresin e Hagës më 1948, nga ku do të krijohet Lëvizja Evropiane e pastaj Keshilli i Evropës. Ai ishte për sistemin “Monet”, i cili në një të ardhme nënkuptonte krijimin e një shteti federal shumëkombësh, krijimin e një hapësire ekonomike evropiane, në gjirin e së cilës, mallrat, kapitalet dhe njerëzit të lëviznin lirisht, sistem të cilin gjenerali De Gol e refuzoi.

Ne vitin 1967, në prag të lëvizjeve të fuqishme të së majtës franceze, slogani i Miteranit ishte:”Ekspansion në Evropë dhe prej Evropës...Kjo është perspektiva e vetme e atdheut tim.”, çka nënkuptonte angazhimin e Francës në fatet e një Evrope të re. Miterani ishte kundër Evropës së teknokratëve dhe të karteleve , dhe pro një Evrope të popujve të bashkuar e solidare, ishte për një Evropë të lirë e

liberale, të pavarur nga Amerika. Për të , qytetërimi evropian ishte një tërësi, një entitet më vete.

“Esenciale për të ishte Evropa,”- kujton një nga këshilltarët e tij më të afërt, shkrintari dhe eseisti Jacques Attali.

Që në vitin 1981 kur u zgjodh president, ai erdhi në pushtet me bindjen për të zhvilluar një politikë evropiane e të hapur, në kundërshtim me politikën disi konservatore të diplomacisë goliste.:”Një France socialiste në një Evropë liberale!”. Që këtë vit, në Këshillin e Evropës ai kërkon krijimin e “një hapësire sociale evropiane”.

Politika evropiane bëhet kështu një prioritet i tij me nje orientim të përcaktuar. Edhe kur kushtet e brendshme ekonomike e detyrojnë më 1983 të zgjedhë midis sistemit monetar francez dhe atij evropian ai zgjedh këtë të fundit. Më 1983 ai miraton para Bundestagu-t gjerman vendosjen e “Pershing” amerikane, për të ekuilibruar forcat bërthamore në Evropë, përballë kërcënimit të misileve ruse të “Traktatit të Varshaves”. Një vit me pas ai deklarohet në favor të një traktati për Bashkimin Politik Evropian dhe bëhet promotor i një bashkëpunimi të ngushte franko-gjerman , duke përfunduar një sërë traktatesh të përbashkëta që kishin të bënin me mbrojtjen dhe sigurinë e paqes në Evropë.

Më 1992, nënshkruan Traktatin e Mastrishtit dhe në mbledhjen e lartë të Nato-s, kërkoi një “identitet evropian në kuadrin e mbrojtjes”. Në vizitën e tij të fundit në Parlamentin Evropian në Strasburg, ai deklaroi se “nacionalizmi do të thote luftë”, duke i shpallur kështu luftë nacionalizmit, që rrezikonte veçanërisht Lindjen dhe Ballkanin. Ja përse, më 28 qershor 1992, fill pas mbledhjes së Këshillit Evropian të Dymbëdhjetëshes në Lisbonë, ai fluturoi drejt Sarajevës së rrethuar. Ai hapi kështu “urën ajrore humanitare”, që për tri vjet e gjysmë ushqeu kryeqytetin bosnjak të rrethuar.

Bashkëpunimi i Evropës nënkuptonte për të disa dimensione: një Evropë të Mbrojtjes, një Evropë Sociale, një Evropë të Kulturës (veçanërisht audiovizuale) një Evropë të Solidaritetit (me fondet e ndihmes për shtetet evropiane më pak të zhvilluara, BERD, për vendet e lindjes etj), nje Evropë të Bashkëpunimit Shkencor e Teknologjik (me programin “Eureka” etj), për çka ai vuri gjithë energjitë.

“Qytetërimi i Evropës është një i tërë,- thoshte Miterani, duke

i kushtuar një rëndësi të posaçme integritit kulturor evropian.

Miterani ishte nga të parët presidentë evropianë që e kuptoi rëndësinë e madhe gjeopolitike të ndryshimeve që po ndodhnin në Lindje, apo “l'autre Europe” (Evropa tjetër) siç e quante ai. Nëntor 1989. Muri i Berlinit ra. Perestrojka gorbaçoviane ishte për të një “shpresë konfuzë e një agonie”. Me iniciativën e Miteranit në pallatin e Elizese mblidhet Dymbëdhjetëshja, ku shprehet solidariteti me lëvizjet e reformat që po ndodhnin në vendet e Lindjes Evropiane. Për bashkimin e dy Gjermanive ai në fillim le të nënkuptohet se duhet ende kohë. Por sapo Kohl bëri të njohur planin për bashkimin e Gjermanisë në një shtet të vetëm, Miterani shkoi në Kiev të takohet me Gorbaçovin, por tashmë pushteti i tij kishte marrë fund. Po këtë vit ai lançon idenë e një “konfederate evropiane” ku vendet e Evropës Lindore përqaftuan Dymbëdhjetëshen. Por me sa u duk dhe më vonë, kjo ide ishte e parakohshme. Ai shpresonte se këto ndryshime jepnin shansin e madh politik për krijimin e një Evrope të Bashkuar.

Mbështetja e “perestrojkes”, e “revolucioneve” në vendet e Lindjes ashtu si dhe ndryshimeve politike që ndodhën në Shqipëri ishin shprehje e asaj politike konsekuente për integrimin e popujve të Evropës në emër të Paqes dhe bashkëpunimit, në emër të restaurimit të një rendi demokratik. Pikerisht ky vizion evropian e bëri Miteranin një nga protagonistet kryesore të politikës së këtij kontinenti në arenën ndërkombëtare e botërore. Fjalimet e tij në Paris, New York, Bonn, Hage, Strasburg etj, hynë në histori.

Miterani nuk e arriti dot realizimin e asaj ëndrre të vjetër, bashkimin e Evropës. Kur ai po largohej, euroskeptiket ishin ende të shumtë. Pa dyshim, bashkimi do të ishte një proces i vështirë dhe i ngadalte. Megjithatë, personalitetet e mëdha botërore e përshëndetën atë pikërisht për këtë kontribut. “Evropa humbi një burrë shteti të madh,” - u shpreh Helmut Kohl. “Franca humbi një udheheqës të madh, ndërsa Bashkimi Evropian ka humbur një nga partizanët më të flaktë të saj, një nga protagonistët më me influencë dhe mbrojtësit më të mëdhënj të kauzës evropiane,” tha ato ditë Zhak Senter (Jacques Senter). Ndërsa gazeta “The Guardian” nënvizoi se “Miterani do të mbetet ndoshta evropiani i vërtetë dhe i fundit”.

Gjermania, kjo bijë e Gëtes

Më 1994 , për herë të fundit , Miterani përshëndeste nga tribuna e Pallatit të Evropës (Palais de l'Europe”) në Strasburg. Parlamentarët evropianë e duartrokitën unanimitisht urtësine dhe mesazhin e këtij politikani të madh që kish luftuar aq shumë në emër të Evropës.

Më 1991 për herë të parë shkoja në një mbledhje të Komitetit Ad Hoc për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës. E admirova menjëherë ate qytet të Alsas-Lorenes (Alsace-Lorraine) që më ngjante si një shembëlltyrë e vetë Paqes. Strasburgu, ky port i dikurshëm i Rhinit, tashmë i përkiste historisë e veçanërisht historisë franko-gjermane. Qyteti, rrugët, ndërtimet e vjetra, mbartnin në vetvete histori mjaft të trishta, të cilat kishin mbetur veçse në albumet fotografike: "La place d'Austerlitz", "La rue del'or", "L'Orangerie", "Molsheim", "Schiltigheim", "Robertsau"...sa e sa herë ky qytet ishte shkatërruar herë nga gjermanët e herë nga francezët. Ushtritë nëpër shekuj kishin mbjellë vdekjen. Ja pse dhe Hygo, që më 1842 kishte shkruar: "Nëse Franca dhe Gjermania bashkohen, në botë do të mbretërojë paqja".

“Në fëmijërinë time Gjermania ishte për mua një fqinjë tërheqes e i dyshimtë. Një armik i respektuar. Pak nga pak , tek unë, lindi ideja se një epokë e re mund të fillonte me mirëkuptimin e dy popujve tanë, pavarësisht nga gjaku i derdhur apo në saje të këtij gjaku të derdhur”.

Kur Miterani erdhi në fuqi , ai e kuptoi se pa Gjermaninë nuk mund të flitej për Evropën e bashkuar.”Gjermania është Evropa ,- do të thoshte më pas ai,- pa Gjermani nuk ka Evropë dhe pa Evropë nuk do të ketë madhështi gjermane”. Ai nuk kishte vizionin e presidentit të mëparshëm Pompidu, i cili e shihte me mosbesim politikën “Ostpolitik” të Brandit.

“ Miterani,- kujton shkrimtari i madh gjerman Ernst Junger,- në mënyrë të dukshme shprehte simpati per gjermanët.”

Në fillim të viteve 80, misilet ruse SS-20 kërcënonin seriozisht Evropën Perëndimore. Ai kërkon në Bundestagun gjerman vendosjen e misileve amerikane “Pershing”, për të ekuilibruar kështu forcat bërthamore. “Popujt tanë ,- thotë Miterani më 8 gusht në Bundestag,-e urrejnë luftën, nga e cila ata kane vuajtur aq shumë si dhe popujt e tjerë të Evropës. Tashmë një ide e thjeshtë e udhëheq Francën: Lufta duhet të mbetet diçka e pamundur, edhe për ata që e ëndërrojnë atë”

Një miqësi e ngushtë do ta lidhë atë me kancelarin gjerman Kohl, me udhëheqësin e kësaj “Gjermanie të qete e të lumtur, bijë e Gëtes, që në vetvete ka diçka nga Athina e vjetër”, siç e cilësonte ai. Që në takimin e tij të parë me kancelarin gjerman Miterani impresionohet nga ky personalitet, xhaxhai i të cilit qe vvarë në luftën e 1914-ës dhe një vëlla i madh i ishte zhdukur gjatë Luftës II Botërore.

“Kur më 1982 u zgjodha kancelar i Gjermanisë ,- kujton Helmut Kohl,- unë nuk e njihja Miteranin. Vizita jonë në Verdun më 22 shtator 1984 është pa dyshim nje nga kujtimet e përbashkëta më të mëdha. Bashkë ne përkujuam të rënët e Luftës së Parë Botërore. Ne zgjodhëm pikërisht Verdunin , pasi më 1940 atje ishte plagosur Miterani dhe se më 1916, po atje kishte luftuar im atë. Kur mendoj për atë ditë shiu kur ecnim nëpër radhën e varreve të pambarim më ngjan se imazhet janë ngulitur përgjithmonë në kujtesën time. Në Verdun, ne dëshmuam para gjithë botës ndjenjat që kishin zemrat tona. Ne kishim perfunduar së kryeri atë që Konrad Adenauer dhe Charles de Gaulle

kishin ndërmarrë më 1962, nën kubënë e katedrales së Reims: pajtimin franko-gjerman.”

Pak më vonë, në “Palais de l’Europe” më 13 tetor 1983 ai deklaroi shprehjen e tij të famshme:”Pacifistët janë në Perëndim , ndërsa euromisilet në Lindje”.

Midis dy politikanëve të mëdhenj evropianë vendoset një miqësi e ngushtë dhe personale. Takime të përbashkëta në Mulhouse, Bad-Krenznach, Constance, Beaune, Durbach, Evian, Edenkoben. Ishulli “L’ile de Re” apo në shtëpinë e shkrimtarit të shquar njëqindvjeçar Ernst Junger. Tashme ata i thërrisnin njëri- tjetrit thjesht, Fransua apo Helmut.

Respekti i Miteranit ndaj Gjermanise dhe popullit gjerman arrin kulmin në fjalimin e tij në 8 maj 1994, në Schauspielhaus të Berlinit. Është 50- vjetori i shembjes së nazizmit. Me një urtësi të jashtëzakonshme dhe kurajo, ai di t’i nderojë ata ushtarë gjermanë të Wermahtit që luftuan për atdheun e tyre , por nën flamurin e një kauze të gabuar:” Une nuk kam ardhur këtu për të kremtuar fitoren, për të cilën u gëzova në vendin tim më 1945. Nuk kam ardhur këtu për të vënë në dukje shpartallimin, sepse unë e kam ditur se diçka të fortë kishte nën popullin gjerman, çka ishin virtutet e tij, guximi, pavarësisht nga uniforma, bile dhe ideja që zoteronte në shpirtrat e tyre, që të panumurt shkonin drejt vdekjes. Ata ishin kurajozë dhe pranorin të linin dhe jetën e tyre, dhe kjo, për një kauzë të keqe, por gjesti i tyre s’kishte të bënte me këtë. Ne e nderojmë Evropën, ne e duam atdheun tonë.”

A ishte kjo barriera e fundit që kishte ngelur në pajtimin franko-gjerman?...

Gjashtë muaj më vonë, në ceremoninë funebre në katedralen e “Notre-Dame de Paris” , sytë e kancelarit gjerman do të rezetinin nga lotët që përmbahen të bien.

Nje lot i rrëshqiti. Kush vallë gjermanet i kish dashur më shumë?...

Spiritus ubi vult spirat...
Shpirti fryn aty ku do...

6 orë në Sarajevë

Ndërkohë që zhvillohej mbledhja e Nivelit të lartë të Dymbëdhjetëshes në Lisbonë , Sarajeva gjendej në agonine e vet. E rrethuar nga ushtria serbe, ajo qëllohej pareshtur nga artileria vdekjeprurëse e vendosur rreth kodrave të këtij qyteti, duke mbjellë ngado veç vdekje.

Pa u këshilluar më asnjë nga kryetarët e tjerë të shteteve, fill pas mbarimit të kësaj mbledhjeje, hipur në nje helikopter dhe bashkë me mikun e tij humanist, doktor Bernard Kuchner, ai fluturon drejt Sarajevës. Ishte një çast kritik, pasi një ditë më pas, në Mbledhjen e Këshillit të Sigurimit do të vendosej lidhur me përdorimin e forcës ushtarake kundër serbeve të Bosnjës, për zhbllokimin e aeroportit të Sarajeves. Edhe 48 orë mbaronte afati i ultimatimit të OKB-së dhënë Beogradit.

Me gjithë mjergullen e madhe nëpër male, ku ndiheshin ende breshërite, helikopteri presidencial, pas nje udhe të gjate prej 170 km, zbriti në aeroportin Butimir të Sarajevës. Ishte ora 10 e gjysmë dhe askush nuk e priste një vizitë të tillë, midis luftës. Për zbritjen e helikopterit nuk kishte nevojë as për forcat e OKB-së e as për

Forpronu. Hipur në një autobлиндë, Miterani shkon të bisedojë në selinë e presidencës me Alija Izetbegoviç. Ai do të dëgjojë nga ai për krimet mizore dhe pastaj do të shohë e do të dëshmojë për gjendjen e një populli të rrethuar. Ishte një drëkë që ndërpritej nga bombat dhe predhat e serbeve.

Më pas, me kaska te çelikta në kokë, të dy presidentët marrin udhët e qytetit martir. Topat filluan të gjëmonin sërish. Miterani takon njerëz të thjeshtë, burra, gra, nena e pleq, të cilët i shprehin gëzimin e tyre : “ Faleminderit për kurajon që treguat!”...”Miteran, ju jeni shpresa jonë e fundit. Faleminderit”. “Miteran- Bosnja!” - thërriste dikush tjetër.

Pranë pazarit ata ndalojnë para dyqanit të një bukëpjekësi. Pikërisht aty ku kishte ndodhur vrasja e gjashtëmbëdhjetë qytetarëve të pafajshëm nga predhat serbe, në maj të vitit 1992. Aty ai vuri një trëndafil të kuq. Pastaj ata vizituan spitalin e qytetit ku sillnin viktimat.Salla e urgjencave qëndronte ende në këmbë. Diku një grua e paralizuar, një tjetër me një faqe të shkukur nga predhat. Më tutje ushtarë të plagosur që klithin në agoni. Pamjet janë tronditëse.

“ Ne shohim këtu një popull të burgosur nga të shtënat vdekjeprurëse ,- u deklaroi ai gazetarëve në atë konferencë shtypi.- Ne jemi solidarë me popullin e Bosnjës!...Une besoj në forcën simbolike të akteve . Ne duhet t’i therrasim ndërgjegjes botërore për t’i ardhur në ndihmë një populli në rrezik.”

Korridori humanitar për të mbajtur gjallë Bosnjen, u hap.

Por tragjedi të tjera edhe më makabre, do të përjetonte ky qytet martir.

“Aut Cesar, aut nihil!”
 “Ose perandor, ose hiç!”

“Homo politicus”

“Gjithe personazhi i tij është ndërtuar mbi ambiguitetin,- shkruan një nga biografët e tij të njohur Franz-Olivier Giesbert.-Ky ambiguitet e lejonte atë që në mëngjes të besonte diçka si të vërtetë dhe në mbrëmje të bindej për të kundërtën e saj”. Cilesia e parë pa dyshim nuk e kundërshton të dytën, veçse shpreh atë evolucion të mendimit dhe të refleksionit të thelle të ky personazh.

Të kundërtën do të thotë për të ish- kryeministri francez Laurent Fabius. Ai nuk thotë ambiguitet , por ambivalencë :” Miterani ishte ambivalencë , vlerë e dyfishtë, një përcaktim ky plotesisht dialektik i realitetit njerëzor ku bashkekzistojne kontradiktat. Them ambivalencë dhe jo ambiguitet apo oportunizëm, që aq shumë e ndeshim në skenën politike”.

Nëse Klemanso (Clemanceau) dhe De Gol hynë në histori, ata hynë të tillë se bënë luftën. I pari, Luftën I Botërore apo “La Grande Guerre”, i dyti Luftën II Botërore. Ndersa Miterani nuk hyri ne histori përmes luftës , por përmes politikës. E vetmja gjë që e tërhiqte në jetë , ishte politika. Ajo ishte për të gjithçka, ishte art. Nga shumë të majtë ai

shihej si një “politikan borgjez”, nga komunistët si një reaksionar ultrakolonialist, nga golistët si një ish-vishist (i qeverisë kolaboracioniste të Vichy), nga ekstremistët e djathtë si një kriptokomunist. Bile të tjerë liberalë e quanin aventurier politik. Por në fakt ai ishte “homo politicus”.

“Politika, -thoshte Miterani,-në sensin e zakonshëm të fjalës nuk është profesion. Në vetvete ajo është luftë dhe një angazhim i njeriut. Rrethanat e deshën që ajo të pushtojë qenien time”.

Leon Blumit iu deshën pesëmbëdhjetë vjet luftë politike për të ardhur në pushtet (1921-1936), ndërsa atij dhjetë vjet (1971-1981), që kur erdhi në krye të Partisë Socialiste.”Homo politicus” e di ç’do të thotë zhgënjim,ç’do të thotë tërheqje dhe sulm, ç’do të thotë taktike dhe strategji apo përse jo bashkekzistencë. Ishte pikërisht ai që e rindërtoi Partinë socialiste franceze, që goditi gjer në shkatërrim Partinë komuniste të Francës. Ishte ai që goditi të djathtën apo që iu kundërvu socializmit dogmatik më 1983 gjatë krizës ekonomike .

Kundërshtarët e tij janë të shumtë: De Gulle, Pompidou, G.D’Estaing, Chirac, R.Barre, më pas ultranacionalisti Le Pen...Një herë De Gol do t’i pëshpëriste në vesh ish- kryeministrit, Mendes-France :” Mos i zini besë këtij Miteranit. Në thelb ai është komunist!”

D’Estaing e akuzonte atë se “ në vend që t’i sherbejë unitetit të Francës, ai i shërben socializmit.” Nga ana tjetër Pompidu porosiste ministrin e ri Shirak:” Mos u impresiononi asnjëherë nga ai, nga çdo gjë që t’ju thotë dhe për çfardo që mund t’ju tregojë”.

Mos vallë ai ishte në rolin apo një shembëlltyrë e “Princit” të Makiaveli? Në një intervistë ai i përgjigjet një gazetari:”Thuhet se që të arrish sukses në jetën politike, duhet të jesh makiavelist apo një fjorentin. Unë e kam njohur historinë e Florences dhe të fjorentinëve. Por në këtë botë nuk ka vetëm Florence dhe fjorentinë. Ka pasur dhe njerëz që kanë udhëhequr pa ndihmën e intrigave dhe të krimit”.

Miteranit iu desh të përballojë “trysni” të mëdha në jetën politike, sulme nga e djathta por edhe nga krahu i majtë, nga komuniste , trockistë e socialistë; skandale politike e të korruptuarrish apo “afere” të miqve të afert të tij, e gjer te skandali i përgjimeve telefonike që bënte celula speciale e ngritur ne Elize. Por megjithate figura e tij mbeti gjithnjë jashtë skandaleve.

Ky portret aristokratik, “tradhtar” i klases së vet, siç e quajtën shpesh, për të ardhur në pushtet kaloi nga e djathta në të majtën.

Dy miq të afërt të tij vranë veten në rrethana misterioze: kryeministri Pierre Beregovoy dhe së fundi ,më 7 prill 1994,në një nga dhomat e “Palais Elysée” miku i tij intim, François Grossouvre, ky koleksioner i famshëm armësh, që në atë dite shiu kishte zgjedhur si armë një “Magnum” 357, që të mos gabonte shenjë. Askush nuk e kishte dëgjuar krismën. Asnjë letër nuk kishte lënë pas tij për të shpjeguar këtë akt të dëshpëruar. Sekretin e kësaj vetvrasjeje ai e mori me vete në varr.

“Ai vrau veten në këmbët e “Princit”, - do të shkruante gazetari i “Le Monde”, Edwy Plenel, autor i dy librave mbi Miteranin. Ndërsa në radion “Europe 1”, Roland Dumas, mik gjithashtu i afërt i F.de Grossouvre jep versionin zyrtar se “që prej disa javësh, ai ishte i deprimuar dhe ndjente një përbuzje të pergjithshme për jetën”.

François de Grossouvre, nga Isere, dhe me profesion doktor, e kishte ndjekur Miteranin prej më se 40 vitesh dhe ishte një nga më të afërmit e rrethit të tij. Ishte Mendes-France që ia kishte prezantuar atë Miteranit. Kohët e fundit ai kishte mbetur thjesht si President i Komitetit të Gjuetisë Presidenciale.

Në varrimin e tij ishte i pranishëm dhe presidenti Miteran...

“Unë shpesh kam verifikuar se administrimi i mire i nje gabimi, vlen më shumë se disa suksese. Arti i lojës së shahut na mëson të bëjmë më pak gabime nga ç'bëjmë në realitet : këto gabime e çorientojne kundërshtarin me shumë sesa ju hutojnë vetë ju. Shkurt, unë besoj në virtutin e improvizimit. Por me kusht , duke e ditur se improvizimi është një ushtrim i gjatë”.

Megjithatë pasioni për politikën nuk do të venitej për asnjë çast të Miterani.”Historia do të gjykojë” , -thoshte së fundi ai.

Miterani , megjithëse i zhvilloi marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, diti të zhvillojë një diplomaci të rafinuar, duke i dhënë epërsi çështjeve evropiane dhe njëkohësisht kënaqësi partnerëve të përtej Atlantikut. “Miterani,- do të thote Xhorxh Bush , pas vdekjes së presidentit francez,- ishte një aleat gjithnjë i besueshëm, i hapur, vendimet e të cilit ishin koherente. Unë nuk mbaj mend të kemi pasur mosmarrëveshje të mëdha. Bota do ta kujtojë Fransua Miteranin si një udhëheqës të jashtezakonshëm, si një njeri që të

imponohej me njohjen e tij historike, një aleat besnik i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. unë do ta kujtoj atë gjithnjë si një mik të vërtetë”.

Por epërsi në diplomacinë e Miteranit përbënte gjithashtu superfuqia tjetër: Bashkimi Sovjetik, zhvillimet e të cilit ai i ndiqte me një vëmendje të jashtëzakonshme. Kur më 1984 kishte qenë për një vizitë zyrtare në Kremlin, në fjalimin e rastit ai nuk mungoi të mbeshteste drejtpërdrejt disidentin e famshem rus, Sakarov, duke nxitur e mbështetur kështu hapur disidencën ruse. Kur muri i Berlinit binte dhe ngjarjet zhvilloheshin me një shpejtësi të rrufeshme, ai menjëherë shkoi në Kiev të takohej me Gorbaçovin. Çështja kryesore ishte që procesi i bashkimit të Gjermanisë të integrohej dhe bashkërendohej me proceset evropiane.

“Miterani erdhi të flisnim për thelbin e gjërave , - kujton për këtë vizitë Mihail Gorbaçov,- pasi ne kishim një besim reciprok të njëri- tjetri. Ishte një shkëmbim mendimesh dhe pikëpamja jone e fillimit ishte që bashkimi i Gjermanisë të sinkronizohej me procesin e organizimit të KSBE-së, për sigurimin evropian. Ne mendonim se nuk duhej të kishte një “docalage”, pra një hendek midis këtyre dy gjërave. Miterani ishte një realist.”

Shtatë kryeministra punuan nën drejtimin e tij: Pierre Morroy, Laurent Fabius, Jacques Chirac, Michel Rocard, Edith Cresson, Pierre Beregovoy dhe së fundi Eduard Balladur. “Miterani i dha Francës një rol racional,- shkruan historiani dhe biografi i De Gol, Jean Lacoutoure,- Për më tepër ai i siguroi Francës alternancën, paqësimin politik, bashkekzistencën politike”. “Vitet-Miteran” për kohëzgjatjen në pushtet, krahasohen me ato të Louis Philippe apo Napoleonit II.

Ky ishte “Homo Politicus”, François Mitteran, të cilit vdekja i dha akoma dhe një rol më shumë, atë mitik. Në shkurt të vitit 1995, në një anketë të SOFRES, 67% e francezëve mendonin se dy mandatet presidenciale të Miteranit do të zinin një vend të rëndësishëm në Historinë e Francës. Ky ishte njeriu që më shumë se gjysmën e jetës e kaloi në skenën politike dhe kuliset e saj.

“Një njeri që ka kaluar një gjysmë shekulli në jetën politike, nëse ka një pasion, kjo është politika dhe asgjë tjetër .”- pohonte Miterani, i cili më 1994, u shpall nga “Nouvel Observateur” si “Njeriu politik i vitit”. Edhe revista “Nouvel Economique” e shpalli atë në

dhjetor të vitit 1994 si “Politikan i vitit”

Kur shkrimtari nobelist Elie Wiesel, në intervistat e gjata të tij për librin e përbashket “Kujtesë në dy zëra”, e pyeti së fundi se “nëse do donit të jetonit akoma gjer në vitin 2010, për të parë se ç’bëhet në këtë botë”, ai iu përgjegj:

“-Jo! Unë mendoj si Willy Brand , i cili si epitaf të vetin shkroi: “Bëra aq sa munda!”

“Çështja Bosquet”

“Çështja Bosquet” dukej si një çështje që i përkiste tashmë së kaluarës, por vrasja e tij, papritur, në apartamentin e tij në Paris, bëri që përsëri të flitej për Miteranin, aq më tepër që koïncidoi edhe me daljen e librit të Pierr Pean “Një rini franceze”. Por në fakt, këtë çështje e kishte shkaktuar edhe deklarata e ish- komisarit për çështjen e çifutëve në qeverinë e Vishise, D. de Pellepoix, i cili gjate kthimit nga mërgimi i tij, në një intervistë dhënë revistës “Express”, pohonte se përgjegjës për bastisjen dhe arrestimin e çifutëve në Vel’d’Hiv, ishte Rene Bosquet.

Në vitin 1942 Bosquet ishte sekretar i Pergjithshëm i Policisë së Vishisë. Më 2 korrik të atij viti, ai takohet me autoritete të larta gjermane, lidhur me dorëzimin në duart e gjermanëve të 10 mije çifutëve të “zonës së lirë”, dhe 20 mijë që gjendeshin në “zonën e okupuar”. Ai takohet pikërisht me shefin ë Sigurimit nazist Knochen, i cili ka urdhrin e Hitlerit për t’i dhënë fund njehërë e mirë çështjes çifute. Bosquet tregohet i gatshëm për arrestimin e tyre në gjithë Francën. Bile ai kërkon që të ndërhyjë edhe policia franceze në këtë operacion, për kapjen dhe arrestimin e tyre. Më 3 korrik, Laval, në

Këshillin e Ministrave jep miratimin e tij. Bastisjet zhvillohen në të gjithë Francën më 16 dhe 17 korrik. Kapen gjithsej 12.884 çifutë. Më 19 korrik, treni i parë nis për në Auchwitz. Bastisja më e njohur e Vel'd'Hiv sigurisht la gjurmë te Miterani , i cili ndërkohë punonte me rezistencën dhe shumë prej miqve të tij ishin çifutë. Atë kohë ai punonte në administratën e Vishise, njihte bashkëpunëtorët e Bosquet, por kurrë nuk e kishte takuar atë.

Fill pas botimit të librit “Një rini franceze” në Televizionin francez u zhvillua një debat i pazakontë rreth këtij fakti, midis presidentit Miterani dhe gazetarit shumë të njohur J.P.Elkabbach. Ishte momenti që duhej hedhur dritë mbi te vërtetën.

Në fakt, Miterani ishte njohur me Bosquet pas luftës. Ai e kishte takuar përmes miqve të tij të Vishisë, siç ishte J.P.Martin, atëherë kur Gjykata e Lartë franceze nuk e konsideroi fajtor Bosquet ndaj padisë që i ishte bërë për “krim kundër njerezimit”. Shumë prova tregonin në të kundërt, se ai kishte ndihmuar gjithashtu Rezistencën franceze. Këto fakte Miterani i dinte. Dinte gjithashtu dhe çka rëndonte mbi të. Megjithatë ai e çmonte për cilesitë intelektuale të tij, çka e tregoi me funksione të ndryshme që ai kreu në vitet 50. Kjo marrëdhënie miqësore dhe respekti midis dy vishisteve, do të përdorej shpesh nga kundërshtarët politikë të Miteranit. Megjithatë Miterani nuk i ndryshoi pikëpamjet e tij për të. Aq më tepër, në një ditë përkujtimore të mareshallit Peten, Miterani vendosi një tufë lulesh në homazh te mareshallit, duke e nderuar atë si hero të Luftës së Parë Botërore.

“*Plaudite, cives!*”
 “Qytetarë, duartrokisni!”

Shprehje e aktorëve romakë në fund të shfaqjes

Një personazh i medias

Që pa ardhur në pushtet, Miterani e dinte forcën e medias dhe se ç’do të thoshte të ishte i aftë të flisje, pra të dish të përcjellësh mesazhet në popull, në mënyrë që ta bindësh atë. Vajtja në Pantheon, disa ditë pas zgjedhjes së tij president i Francës, ishte diçka simbolike dhe shumë mediatike.

Miterani është nga udhëheqësit që ka folur më shumë se gjithë presidentët e tjerë francezë: 1753 fjalime dhe mesazhe politike vetëm gjatë një mandati presidencial, ndërkohë që De Goli për dhjetë vjet pati vetëm 620. Ai hyri në histori si presidenti i fjalimeve të mëdha. Një emision televiziv ku ai foli, kapi shifrën prej 20 milion teleshikuesish. Një shifër rekord. Për të arti i qeverisjes ishte i pandarë nga arti i komunikimit. Një nga këshilltarët e tij më të afërt të marketingut politik për median ishte Zhak Segela (Jacques Seguela) .

“Miterani ishte mjeshtër i fjalës dhe i imazhit , - tregon ky i fundit”.

Vizita në Pantheon, fjalimi ne Bundestag, në Knesset, në tribunën e OKB-së, ceremonia në Verdun, gjithshka ishte e menduar më parë . Deklaratat e mëdha bëhen në vende të rëndësishme. Pra , të

flasësh ku është e rëndësishme dhe kur është e rëndësishme. Kryesore është të luash rolin e parë.

Ai dinte të zgjidhte dhe gazetarët e televizionit apo të gazetave dhe revistave. Në takimin me Anne Sinclair, ai më shumë i fliste asaj sesa telespektatorit. Kështu ai krijoi diçka tepër intime dhe të çliruar nga hijet e rënda të pushtetit.

Në jëtën e tij presidenciale ai ishte njeriu më i fotografuar i Francës. Kur fliste në televizion, ai kurrë nuk nxitonte. Ai dinte ta vlerësonte heshtjen. Heshtja për të ishte refleksion, pushtet. E rëndësishme në televizion është të përçosh ide të fuqishme. Pra , është mesazhi që krijon emocionet.

Për zgjedhjet presidenciale të vitit 1981, parrulla e tij ishte “Forca e qetë” (“La Force Tranquille”), ndërsa në zgjedhjet presidenciale të vitit 1988 ishte sllogani “Franca e bashkuar” . Gjatë kësaj fushate ai nuk shkoi të pozonte në ndonjë studio, siç bënin presidentët e tjerë. Ai kërkoi në arkivën e vet fotografike një fotografi krejt të lirshme, që i shkonte slloganit të fushatës së tij elektorale.

Një operacion marketingu më vete ishte ideja e tij “Letër gjithë francezëve”(“Lettre á tous les français”), që njëherësh e botoi në shumë revista e gazeta. Ishte një refleksion personal i tij për ardhmërinë e Francës, të Evropës dhe mbi problemet e mëdha që kishte Franca.

Cuditërisht dhe vdekja e tij u kthye në një procesion mediatik, ku mori pjesë gjithë Franca, një Francë e bashkuar, ku për njëfarë kohe heshtën hasmëritë politike .

Mijëra dëshmi në kanalet televizive , stacionet radiofonike, gazetat e revistat...Një mit, edhe pas vdekjes së tij.

Shqipëria, thjesht një dëshirë...

Kisha gati pothuaj një vit në Francë, ku kisha ardhur si diplomat, dhe rasti m'u dha që ta shoh nga pranë presidentin francez Miteran. Ishte një ceremoni e zakonshme dhe e përvitshme, për urimet e Vitit të Ri, të cilat ai i bënte me gjithë trupin diplomatik, pra përfaqësuesit e akredituar në Francë, në ditët e para të vitit që hynte. Në sallën e madhe të Elize-së, ku ambasadorët e huaj vendoseshin në formë gjysmërrethi, me në krye Monsinjin, nuncin e Vatikanit, e pashë të hynte me një hap të ngadaltë, si pa u ndier, duke buzëqeshur lehtë nga te pranishmit. Kishte diçka hijerëndë në qenien e tij, diçka prej monarku, por të një monarku modern. Po kjo pamje, gati e ngrirë, ishte dhe në festat e 14 korrikut, në "Place de la Concorde" apo në "Elysée" në ceremonitë që organizoheshin në sallat e bukura të Pallatit të Elize-së, dhe në oborret e gjelbëruara te saj.

Shqipëria, "Le Pays des Aigles", për Miteranin ishte një vend i izoluar e misterioz, që diktatura e kishte fshehur totalisht nga Perëndimi dhe nga bota e qytetëruar. Edhe pse një vend i izoluar, Franca ishte në Shqipëri një nga vendet e privileguara: ajo kishte privilegjin e depërtimit kulturor te saj, edhe pse me një fryme klasike

dhe letërsi të shekujve të kaluar. Dhe kjo kishte arsyen e vet, sepse udhëheqësi shqiptar, Enver Hoxha, e kishte ruajtur gjithnjë nostalgjinë e viteve studenteske në Francë.

Por presidenti francez kishte arritur të njihte diçka nga Shqipëria përmes informacioneve diplomatike dhe romaneve të Ismail Kadaresë, të cilin e admironte si shkrimtar. Ishte pikërisht ai që e ftoi atë për festën e 200- vjetorit të Revolucionit francez, ku nga Ballkani ishin vetëm dy personalitete, turku J.Qemal dhe shqiptari I.Kadare. Në librin "Verbatim 1", Jacques Attali, ish-këshilltar i afërt i presidentit Miteran, duke qëmtuar rreth ditarit te punës së presidentit në atë kohë, ka shkruar: "Ismail Kadare, shkrimtari i madh shqiptar, e ka të vështirë të vijë në Francë. Duhet t'i dërgohet një ftesë nga ana e presidencës së Republikës."

Ngjarjet e ambasadave në korrik të vitit 1990, dyndja e qindra refugjatëve në Francë, dhe pritja e tyre nga vetë ministri i Jashtëm Roland Dumas, i acaroi marrëdhëniet shqiptaro - franceze. Qëndrimi i funksionareve shqiptarë dhe i drejtuesve të politikës shqiptare u bë armiqësor ndaj Francës, gazetarëve francezë dhe deklaratave zyrtare franceze. Vetë Miterani, rreth ngjarjeve te ambasadave përmes një deklaratë rreth zhvillimeve në Evropën e Lindjes, kishte dalë hapur ne mbrojtje të lirive të njeriut në Shqipëri dhe demokratizimit të jetës shqiptare. Kjo deklaratë ishte një shuplakë për zyrtarët shqiptarë.

Ky njeri hijerendë, me një vështrim të ftohtë por me sy të rrezatuar, bëhej shumë i singertë kur gjendeshe pranë tij, e qeshura e tij bëhej njerëzore, duke i dhënë kësaj figure mirësi. E tillë ishte kjo në takimin me presidentin shqiptar Ramiz Alia, në ditët e para të shtatorit 1991, kur ai sapo kthehej nga Helsinki, për të firmosur në Paris "Kartën e Helsinkit" për të drejtat e njeriut. Biseda e tyre ishte fare e lirshme, ndoshta sepse Alia u detyrua ta bëjë bisedën pa interpret, meqenëse perkthyesja ishte një vajzë me origjinë nga Veriu shqiptar por që nuk e kuptonte siç duhej shqipen letrare të Alisë. Në kraht të Miteranit, qëndronte si gjithnjë miku i tij intim dhe ministri i Jashtëm Roland Dumas.

Miterani i kërkoi Alisë t'i fliste për zhvillimet e fundit në jetën politike shqiptare, për gjendjen e të drejtave të njeriut, pluralizmin politik, të drejtat fetare etj, si dhe problemet ekonomike e sociale qe kalonte atë kohë Shqipëria. Pastaj erdhi çështja e Kosovës, të cilën

presidenti francez e njëhte mirë dhe shprehu mendimin e tij që kufijtë tani nuk duhet të preken. Ishte e çuditshme të dëgjoje Miteranin të fliste për Skënderbeun, të cilin ai e kishte lënë për në fund të bisedës. Alia largohej i kënaqur nga ky takim, sepse i kishte premtuar Miteranin se ndryshime të tjera do ta ndiqnin jetën shqiptare, por muajt e tij ishin të numuruara.

Në mars të vitit 1992, në zgjedhjet legjislativë në Shqipëri, kësaj radhe fiton Partia Demokratike. Doktor Sali Berisha zgjidhet president. Politikani i ri, nisur nga thirrjet e studentëve “Të bëhemi si Evropa”, kërkoi së pari të trokiste në dyert e Evropës, në Komunitetin Evropian në Bruksel dhe në Këshillin e Evropës në Strasburg, pa pasur mbështetjen e një prej të mëdhenjve të Evropës. Kërkesa e nxituar, për një takim të Berishës me Miteranin, gjatë rrugës së kthimit të Berishës nga Strasburgu në Itali, këshilltarëve të Miteranit, apo vëte Miteranit nuk i pëlqeu. Kuptohet që ata kërkonin që kjo të ishte një vizitë e përgatitur dhe jo e rastësishme. Kështu presidenca kishte kthyer përgjigje negative. Por fati e solli, që duke folur me ambasadorin e Francës në Strasburg, në drekën zyrtare në Këshillin e Evropës, lidhur me këtë përgjigje negative, ai mori iniciativën ta rregullonte këtë takim. Kështu, të nesërmen, një avion ushtarak e mori Berishën në Romë dhe e solli për disa orë në Pallatin e Elizesë, për t’u takuar privatisht me Miteranin. Dhe padyshim, shpresat e Miteranit për një Shqipëri demokratike tashmë ishin të mëdha.

Pas kësaj vizite, disa herë u fol për ardhjen e Miteranit në Shqipëri. Shqipëria ishte nga të rrallat vende në Evropë apo ndoshta i vetmi që presidenti francez nuk kishte shkelur. Ndoshta një kuriozitet e shtynte atë ta vizitonte këtë vend të çuditshëm dhe një histori aq tragjike. Por kjo do të mbetej veçse një dëshirë...

Në vitin 1994, kur në Shqipëri pritej që të vinte presidenti francez, Miterani kalonte një nga periudhat më të vështira të sëmundjes së tij. Sëmundja po e mposhtëte gjithnjë e më shumë.

Në fillim të vitit 1995, përsëri u fol në Shqipëri për ardhjen e tij, por të gjithë e dinin se kjo ishte thjesht një datë që shtyhej në infinit. Kjo vizitë nuk do të realizohej kurrë...

Njeriu i “letrave”

“Asnjë burrë shteti nuk është mbajtur njeri i letrave ai ai ,”- shkruan për Miteranin shkrimtari i sotëm francez François Nourissier, duke e vlerësuar letërsinë e presidentit si një letërsi “elegjiake”, “republikane “,”elokuente”, “sarkastike” dhe “solemne”...”Ai ka tonin e një fisniku”- nënvizon Nourisier. Sigurisht, nuk bëhet fjalë për komplimente që i bëhen një presidenti, por për një të vërtetë dhe një cilësi që binte në sy të presidenti Miteran.

Dhuntia për të shkruar dallohet tek ai që në rinine e vet, kur ëndërronte të bëhej shkrimtar. Që fëmijë kishte në duar librat e Balzakut, Stendalit dhe Floberit, më vonë zbulon Folknerin dhe Heminguein...Në fillim shkruan në revistat studentore, pastaj në ato të luftës e pasluftës, shkruan madje dhe poezi, pastaj artikuj dhe refleksione politike, gjersa vite më vonë do të fillojë botimin e librave të tij. Trembëdhjetë libra politikë e letrarë në jetën e një njeriu nuk janë pak. Një krijimtari e tërë që ndjek rrjedhën e traditës humaniste e moraliste franceze, ku kritikët do të flasin për një mënyrë të veçantë të shkruari që dikush do ta quaj”stili Miteran”. Megjithëse, në këtë krijimtari me shumë i pëlqejnë esetë dhe analizat politike, përsëri

natyra dhe poetika do ta joshin atë. Dhe ai di t'i bejë himn natyrës, asaj natyre që aq shumë e kishte ndier të afërt në fëmijërinë e vet.

“Ndjej krenari kur përshkruaj pemët, zogjtë, kur përdor emrat e tyre...Nuk do të më pëlqente të isha nje shkrimtar imagjinar. Më pëlqen të vëzhgoj, të shkruaj, dua gjuhësinë, filologjinë, gramatikën...”

Miteranin, bota e njohu si një njeri të kulturës, si një politikan me një erudicion të gjerë dhe që kishte një dobësi të veçantë për shkrimtarët, artistët dhe që dinte t'i nderonte ata. Ndër miqtë e tij të afërt ishin shkrimtarët Margarite Duras, Françoise Sagan, Françoise Giraud etj. Ai vlerësonte lart Saint-John Perse, James Joyse, Styron, Wiesel, Kadare etj. Adhuronte “Shkretëtira e Tartarëve” e D.Buzatit apo mahnitej pas librave të Pasternak, Arragon etj. Lista është shumë e gjatë. Për 200 vjetorin e Revolucionit Francez, ai thirri shkrimtarët që kishte më për zemër. Nga Ballkani ishin Jashar Qemal dhe Ismail Kadareja. Gjatë darkës zyrtare ,kur ai ishte me presidentin Bush dhe takoi Styron, ai menjëherë ia prezantoi Bushit, i cili as që e kishte dëgjuar emrin e këtij shkrimtari. Miqtë e tij ishin gjithashtu Norman Mailer, Susan Sontag etj, veprat e të cilëve i lexonte me ëndje.

Gjatë udhëtimeve me avion për në mbledhjet e Nivelit të Lartë në vende të ndryshme të botës, ai kurdoherë rrugës do të lexonte një ese apo një roman, do të shkruante diçka, ndonjëherë dhe poezi:

...”Kur muzika të pështjell dhe këndon për sytë e tu, kur lumturia për jetën është ulur në dorën tënde të hapur trimërisht, kur ditët më të gjata kërkojnë të jenë më të bukurat,

Ky është muaji qershor...”

Udhëtimet më të bukura te tij ishin në Venecie, në këtë qytet të vjetër dhe të magjishëm, në këtë qytet të artit dhe të letërsisë. Asnjë qytet në botë ndoshta nuk është aq “letrar e i artit” sa Venecia. Hipur në motos kaf ai shetiste kanalet e Venecies, shkonte nga Riva degli Schiavoni apo nga Zattere. Ai shkonte shpesh nga Campiello San Vio pranë urës “Ponte del Academia”, në një pallat të shekullit XVII, që shihte nga kanali i madh. Po kështu i pëlqente pallati Balbi-Valier, arkitektura e të cilit e frymëzonte. Kënaqej kur shihte tablotë e Karpacion dhe e ndjente veten të rrethuar nga Kazanova, T. Man, Byron apo Viskonti, që kishte xhiruar aty filmin “Vdekje në Venecie”. E kështu me patetizëm ai diskutonte me miqtë e tij për Venecien, këtë republikë të dikurshme aristokratike, për demokracinë elitiste të

mbushur plot me kontradikta.

Çdo udhëtim i tij kishte gjithnjë dhe një gjurmë apo interes kulturor. I pëlqente të ndalonte në atelienë e një piktori, në një muze apo shtëpinë e një shkrimtari. Kur ikën në Combourg nuk harron të “pikëtakohet” me Shatobrian (Chateaubrian), në Macon “kthehet” nga Lamartini, në Nohant tek shtëpia dhe varri i Georges Sand (Zhorzh Sand), në Landes te Diderot, në Alisë te heroi i lashtë Vercingetorix. Me iniciativen e tij dhe bashkë me Jack Lang, atëherë ministër i Kulturës dhe mik i afërt i tij, ai organizoi shumë takime ndërkombëtare të intelektualëve si takimi i Sorbonës më 1983 apo mbledhja e 75 nobelistëve të të gjithë botës në “Palais Elysée” më 1988. Më 1993 në Louvre, në prani të tij, shkrimtari nobelist Elie Wiesel përuron “Akademinë Universale të Kulturës”, një propozim i Miteranit e që në fakt ishte propozuar edhe më 1937 nga një shkrimtar austriak i panjohur tashmë, i quajtur Wefler. Midis anëtarëve të kësaj akademie janë Jorge Semprun, Umberto Eco, William Styron, Wiesel, Vargas Llosa Kundera, e midis tyre dhe Kadare. Një nga miqtë e tij, shkrimtari njeqindvjeçar gjerman Ernst Junger, me të cilin Miterani u takua disa herë kujton:

“Ai erdhi disa herë në shtëpine time. E admironte bibliotekën e shtëpisë. Njëherë kisha botuar një liber mbi Saint-Simon, për të cilin ai më tha:”Këtë figurë nuk e pëlqej dhe aq”. Sigurisht ishte ana e tij demokrate që e pengonte ta adhuronte atë. Por në përgjithësi ai ishte një lexues i tmerrshëm. Pas takimit ne shtëpinë time ai vashdoi udhëtimin bashkë me Helmut Kohl për një takim politik në Constance. Por edhe atje, siç më tha më pas Kohl, ai mbante të hapur nën tavolinë librin që i kisha dhuruar:”Ditar i viteve 1939-1944”.

Presidenti Miteran e çmonte lart krijimtarinë.”Dhuntia e krijimtarisë ka diçka nga magjia”.

“*Omnia vincit amor!*”
 “Dashuria triumfon mbi gjithçka”

Virgjili

“*Ses amours*”...dashuritë

Aventura e tij e parë kishte nisur më 1938, para se të fillonte shërbimin ushtarak në Fort d'Ivry, pranë Parisit. Marie-Louise Terrasse (Mari-Luiz Teras) ishte një vajzë mjaft simpatike, pas së cilës djaloshi François u dha i tëri. Dy mijë letra dashurie me fjalë të zjarra e pasionante. Por një ditë, ajo nuk do t'i përgjigjej më. Më pas ajo do të bëhej një spikere e njohur e televizionit francez.

Miterani e njohu atë vajzë bjonde e simpatike nën emrin Marie-Louise atëherë kur ajo studjonte për letërsi, çka i afronte shumë me njëri- tjetrin. Ishin njohur pikërisht më 28 janar 1938, në një ballo të shkollës “Ecole Normale Superieur”.

“Pashë papritur një bjonde që më ktheu shpinën dhe unë ngela i shtangur, - kujton vite më vonë Miterani, ”Unë e ftova atë të vallzonim. Po çmendesha pas saj...”

Një foks, një tango, një çarleston. Atë natë ata nuk po shqiteshin nga njëri- tjetri.

-Si ju quajnë?- e kishte pyetur ai.

-Nëna më ka ndaluar ta them emrin.

- -Atëherë ju do të jeni Beatricja ime,- i ishte përgjigjur ai ,

duke iu referuar Beatrices, heroinës së famshme të Dante Aligerit.

-Sa vjeç jeni?

- Gjashtëmbëdhjetë!

-Me se merreni?

-Po përgatitem për provimet e matures”.

“ I fejuari im është i jashtëzakonshëm”- do t’u thoshte ajo shoqeve të saj,- ai nuk është fetar, por është mistik...ai e ndjen se ka një Zot”.

Më pas lufta do t’i largonte prej njëri- tjetrit. Më 3 mars 1940, ai vjen me leje, që të fejohej me Beatricen e tij. I lumtur kthehet përsëri në front. Por shpejt bie rob dhe ditët e dhimbshme në kamp ia shtojnë dhe më shumë trishtimin. Ai e adhuronte aq shumë atë , sa kur mundi të arratisesh dhe të vinte në Francë Miterani tha:”Unë u arratisa për të takuar në Paris Marie-Louise-n. Por ajo kishte ikur me një tjetër, një tip të quajtur Plat...”

Para se të shkonte në Vishi, ai kthehet në Paris për të takuar për herë të fundit Beatricen e tij, e cila tashmë ishte dhënë pas nje konti me origjinë polake. Ai e ndjente veten të poshtëruar.

Ata u prishën një mbrëmje të ftohtë mbi urën “Pont des Arts” në Paris. Një legjendë thotë se ajo i ktheu unazën, të cilin ai e mori dhe e hodhi në ujërat e zeza të Senës. Të ngjante si në një roman të shekullit të kaluar.

Në shkurt të vitit 1944, rasti do e sjellë që ai të takohet me Danielle Guze (Daniel Guz), gruan e tij të ardhshme që do ta shoqërojë gjithë jetën. Po afrohej çlirimi i Francës kur ai e takoi në shtëpine e disa miqve. Atë mbrëmje, duke parë rastësisht fotografinë e një vajze të bukur mbi një piano, ai pyeti miken e tij Christine Guze, që atëherë punonte për kinematografinë:

- Cila është kjo vajzë?

- Motra ime! - i ishte përgjigjur ajo.

-Sa vjeç është?

-Në fotografi tetëmbëdhjetë, ndërsa tani nëntëmbëdhjetë.

-Me çfarë merret?

-Përgatit provimet e maturës për filozofi, në Bourgognë.

-Qenka vërtet e bukur. Do të isha gati të martohesha me të!- kishte pohuar ai, duke vështruar nga fotografia.

Kjo pa dyshim ishte nga deklaratat më të çuditshme në jetën e

Miteranit. Ndoshta syte e asaj vajze që nuk e njihje, i kishin thënë shumë. Kur motra i tregon Danielës, ajo habitet, megjithatë i pëlqen që dikush interesohet për të. Një ditë prilli të vitit 1944, ajo mbërrin në Paris. Christine kishte rregulluar të takoheshin bashkarisht një mbrëmje në një berrari të Saint-Germain. Kapiteni Morland, pseudonim i Miteranit në atë kohë, arriti me vonesë, pasi ndiqej nga Gestapo.

Kur motra e pyeti më pas Danielen nëse i pëlqeu, ajo kishte ngritur supet.

-E si mund ta dua, ai është burrë! Ata që dua unë , janë djemtë!

“Atë ditë ai kishte veshur një mushama, kishte mustaqe dhe një kapele të madhe që i varej gjer te hundët,- kujton Daniela.- dukej një tip që s’para ke qejf ta takosh vetëm nëse ndodhesh në një cep pylli”.

Pas këtij takimi një ngjarje e papritur i ndodh kapitenit Morland. Gjatë një bastisjeje, në një nga bazat e fshehta të tij, fotografia e Danies kishte rënë në duart e Gestapos. Ai dërgon menjëherë një shok të tij që të njoftonte për këtë Danielen. Kur ajo doli në portën e liceut “Lycée de Lyon”, shoku i Miteranit e mori me vete dhe e çoi menjëherë në një shtëpi të fshehtë në bulevardin “Saint-Germain” ku ai e priste.

Një ditë të tërë që të dy të dashurit e kaluan së bashku. Më 6 qershor, që të dy i hipin trenit për të shkuar në Bourgogne. Vagoni është plot me ushtarë gjermanë. Bile njëri nga ta i ofron disa qershi Danies, pastaj dhe kapitenit Morland. Kur në një stacion, kontrollohen dokumentet, për Danielen s’ka ndonjë problem. Ndërkohë agjentët kërkonin në lista emrat me gjermën M...Por ushtari gjerman, që ishte në krah të tyre çuditërisht ndërhyri:

“-Këta janë me mua”!

Kështu, me të arritur në Cluny, Daniela u bashkua me Rezistencën Franceze, ndërsa ai u kthye me shpejtësi në Paris.

Ata u martuan më 28 tetor 1944 në kishën Saint-Severin, në Paris. Ai sapo kishte mbushur 28 vjeç.”Gruaja ime është republikane dhe laike”,- i pëlqente Miteranit ta prezantonte atë në shoqërinë e vet. Një muaj më vonë do të ishte Sekretar i Pergjithshëm i të Burgosurve të Luftës në qeverinë provizore të gjeneralit De Gol.

Por Miterani ishte njeri që kishte dobësi për gratë.

“Ai i donte shumë femrat,- kujton mikja e tij shkrimtarja Françoise Giraud,- dhe kjo nuk ishte ndonjë sekret. I donte për një muaj apo për një vit...Nuk dihet sesa janë ato që ranë nën huret e pasionit të tij, por siç thoshin ato, ai i prishte me delikatesë këto marrëdhënie. I prishte për të njohur dikë tjetër. Ndoshta kjo i duhej për të hequr ankthin apo për t’u siguruar në vetvete se të tjerat e donin. Ndoshta sepse dashurinë e parë e kishte nisur me një dështim , me Catherine Langeais, e cila ju largua...Ashtu si Kazanova, ai kishte një gjuhë të”artë”...”

Në karrierën e tij politike, pranë tij do të jenë shumë femra që do ta simpatizojnë si politikan. Një sërë shkrimtaresh dhe artistesh... Një nga to ishte dhe këngëtarja Dalida, e cila jepte koncerte duke shpalosur miqësinë e saj për Miteranin. Spektatorët duartrokisnin duke thirrur:”Dalida-Miteran!” Në revistën “Paris Match” ajo kishte shkruar dhe një artikull: “Përse votoj për Miteranin?” Shpesh Miterani e ftonte në vizitat që bënte jashtë Parisit apo ne restorantet pariziane. Një ditë nëpër gazeta botohet një fotografi ku dora e Miteranit është zgjatur mbi supet e Dalidas. Disa njerëz arrijnë gjer atje sa të thonë “ Ja, e fejuara e Miteranit”.

Megjithatë Daniela e adhuronte burrin e saj.

“-Unë kam bërë gjithçka që atij t’ia bëj jetën të lehtë”- i deklaronte një ditë ajo “International Herald Tribune”.

Fëmija i tyre i parë iu vdiq nga një lindje e parakohshme. Pastaj do të lindin dy djemtë e tyre: Gilbert dhe Jean-Christophe. Ajo do ta shoqërojë atë gjatë gjithë karrierës së tij politike, në momentet më të zymta , te trishta, të gëzuara, në humbje dhe në fitore. Më 1965 kur ai zhvillonte fushatën politike, në drekat dhe darkat që shtroheshin në “Rue Guynemer”, Miterani u thoshte miqve të tij: “Gruaja ime është më majtiste se unë”.

Ata ishin një çift modern që e respektonin gjithnjë pavarësinë e njëri -tjetrit. Kështu do ta kapërcenin dhe incidentin me shfaqjen në këtë botë të vajzës së tij, Mazarine.

Në vitet 60 ajo trajtonte gjithë korrespondencën e tij dhe njëkohësisht punonte për një revistë majtiste. Daniela kishte vënë re se ai nuk përqendrohej vetëm në një parti politike , por anonte dhe nga ndonjë tjetër. Një ditë, kur e pyeti për këtë ai iu pergjigj:

“Franca nuk përbëhet vetëm nga një bllok. Ajo nuk është as vetëm nga e majta, as vetëm nga e djathta. Asgjë nuk mund të bëjmë nëse nuk sigurojmë dhe një pjesë të së djathtës”.

Vite më pas, Daniela do t’i përkushtohet të drejtave të njeriut dhe do të punojë energjikisht me fondacionin francez “France-Libertés”. Disa nga kujtimet më interesante të jetës së saj bashkëshortore me Miteranin ajo do t’i publikonte në librin “En toute liberté”, botuar nga shtëpia botuese “Ramsay”, pas vdekjes së Miteranit.

“Si ce que vous avez Ó dire n’est pas plus beau que le silence, alors taisez-vous!”

“ Në rast se ajo që doni të thoni , nuk është më e bukur se heshtja, atëherë heshtni!

Proverb arab

Mazarine...

Me Anne Pingeot Miterani ishte njohur që në vitet 60, në Hossengor. Ai ishte në atë kohë mik i babait të saj, Pierre Pingeot, një industrialist i pasur i Clermont-Ferrand dhe bashkë luanin golf. Ndërkohë Anne Pingeot ndjek shkollën e njohur të Luvrit “Ecole du Louvre”. Takimet e tyre janë të fshehta , pasi Miterani ishte i martuar me Danielen. Ai ka dy djem, Gilbert dhe Jean-Christophe. Kjo e skandalizon familjen konservatore të Pingeot.

Pas studimeve Anne Pingeot hyn si specialiste në “Muse d’Orsay” dhe merret me historinë e skulpturave dhe të monumenteve pariziane. Bisedat rreth kulturës dhe artit e lidhin akoma më shumë me Fransuan.

Më 1974 u lind vajza e tyre Mazarine, por gjithçka është e fshehtë për Danielen. Në fillimin e viteve 80 e veçanërisht pas zgjedhjes së Miteranit president, raportet e tyre ndryshojnë. Ato bëhen akoma më të fshehta , por dhe më të ngushta. Atij tashmë i duhet të jetojë në dy familje: me atë zyrtare dhe atë që jeton në “hije”. François Grossouvre, një nga ndihmësat dhe miqtë e tij intimë, bëhet kujdestar i afërt i kësaj familjeje, e cila u vendos pikërisht një kat më sipër banesës së tij, në një aneks të Pallatit Elize, në 11, “quai Branly”. Ai si

të thuash vigjëlonte mbi to.

Annë është një tip i heshtur dhe asnjëherë nuk pranoi të shfaqej apo për më tepër të martohej me dikë tjetër. Një ditë drejtori i Liceut e thirri atë dhe i tha:

“-Vajza juaj është një nxënëse e shkëlqyer , por ajo është mitomane. Një shoku i saj, kur e pyeti se ç’punë i bën i jati mori përgjigjen: President i Republikës”.

Drejtori i liceut u habit kur të njëjtën gjë ia pohoi edhe ajo.

Mazarine kishte një adhurim të veçantë për të atin . Që 14 vjeç ajo shkonte në mitingjet pro Miteranit, ku veshur me një “tee-shirt” ku shkruhej “gjenerata Miteran”, ndante traktet: “Votoni Miteran!”

Në fakt, që më 1992, gazetari C.Serillon e kishte pyetur Miteranin rreth ekzistencës së një vajze klandestine e të paligjshme. Miterani i ishte përgjigjur: “Po, kam një vajzë natyrale. E pastaj..?”

Kur Mazarine hyn në “Lyce Henry IV”, të njohur ne Paris, u desh të ndërhynte me takt Pallati i Elizesë. Herë- herë, fshehurazi, Miterani e fton nëpër restorantet pariziane apo ne zotërimet e miqve të tij jashte Parisit, në jug të Francës apo akoma më larg, në udhëtimet në Spanjë, Egjipt, Venecie...Ajo zgjodhi rrugën letrare dhe fitoi konkursin për “Ecole Normale Superieure”, nje nga shkollat më me emër të Parisit. Ai ndihet krenar për të. Që më 1988, për çdo Krishtlindje ai shkonte në Egjipt, ku i kalonte festat me Mazarine dhe të jëmën e saj..

Në Francë zakonisht ruhen sekretet private të njerëzve politike. Por erdhi një ditë që edhe ky rit ndryshoi, si në anën tjetër të Atlantikut. Gazetari Philippe Alexandre ishte i pari qe e bëri të njohur atë publikisht, duke e thyer tabunë. Nëntor 1994. Një moment i vështirë për shëndetin e Miteranit. Misteri për Mazarine nuk ekzistonte më.

Në fakt Daniela e dinte me kohë qenien e kësaj familjeje të dytë , por asnjëherë nuk ishte takuar me Anne Pingeot.

Që më parë Miterani ishte informuar nga revista “Paris Match” se shkrimi do te botohej. Por ai nuk bëri asgjë që të mund ta ndalonte. Kur e lexoi shkrimin ai kishte thënë: “C’est tout de m’Ūme une belle historie” (“Megjithate është një histori e bukur”).

Fotografët e kishin pikasur Mazarine me të dashurin e saj Ali, djalin e ambasadorit të Marokut në Suedi, i cili ishte me studime në

Paris. Tashmë ajo ishte 21 vjeç, në vitin e dytë të “Ecole Normale Superieure” dhe e apasionuar pas filozofise. Francezët në fillim u çuditën me lajmin sensacional. Disa të tjerëve kjo iu duk skandaloze, por Miterani ishte mjaft i qetë. Ai ndjeu kënaqësi që më së fundi dhe Mazarine mund të thoshte me krenari:

“Jam vajza e Miteranit!”

Ai ishte mjaft krenar për të. Aq më shumë që ajo vajzë brune, i ngjante si dy pika uji. Që nga ajo ditë, Mazarine dhe Miteran nuk i ndaheshin njëri- tjetrit. Megjithëse mjaft i lodhur, presidenti donte të përjetonte sa më shumë gëzimin që i jepte ajo. Dilnin shetitje, shkonin së bashku në kinema, kalonin drekat apo darkat ne restorantet që atij i pëlqenin. Më 14 tetor 1995 ata shkojnë të shohin pjesën e teatrit të shkruar nga miku i tij Robert Badinter. Një dramë mbi jetën e Oscar Wilde në burg, të titulluar “C.3.3”, çka përfaqësonte matrikullën e këtij shkrimtari dhe poeti të madh të burgosur për homoseksualitet.

Takimet e tyre u bënë gjithnjë e më shumë të domosdoshme. “Ajo është drita e ditëve të mia,”- i kishte thënë një ditë Miterani, një miku të afërt,- jam krenar se ajo jo vetëm është inteligjente , por dhe e bukur”.

*“Je te loue, ô mon Dieu! de ce que tu m'as fait
créature si admirable!*

“Lëvduar qofsh o Zot, që më bëre një
krijesë të admirueshme”

Psallme 139

Ngjyrat e qiellit

17 maj 1995, ora njëmbëdhjetë. Ishte hera e fundit që ai kapërcente portën e Elizesë. Presidenti i sapozgjedhur, Zhak Shirak, e përcolli në shkallët e pallatit, të mbuluar me një qilim të kuq. Të dy ishin të gëzuar. Ai kishte veshur një kostum blu dhe kishte vënë një kollare të kuqe. Po largohej i gëzuar.

Atë ditë, qytetari Miteran i mblodhi miqtë e tij në një restorant te thjeshtë “Cous- Cous”, pranë shtëpisë së tij në “Rue de Bievre”. Tashmë ishte i lirë...

Disa ditë më pas, me mikun e tij të vjetër, Michel Charasse, ai erdhi në pazarin e rue Clair dhe u gëzohej qershive që shiteshin atë ditë. Një tjetër ditë, në “Rue de Grenelle”, ai shtyn portën e një kantine vere italiane. Jeta i ishte hapur përpara me të gjitha dimensionet e saj, por fatkeqësisht fare pak kohë i kishte mbetur për ta shijuar atë.

“Po zbuloj shëtitjet e Parisit,- u thotë ai gazetarëve që e takojnë,-tani marr frymë i gëzuar, vështroj ngjyrat e qiellit. Pothuaj gjithçka më intereson. Jam i lirë...”

Ai kishte kohë t’u gëzohej tashmë pamjeve madhështore të Parisit, për të cilat ishte krenar, sepse kishte diçka dhe nga vetja e tij. E

kur mendonte kështu, ai kujtonte “Le Grand Louvre”, “Cité de la Science” (“Qyteti i Shkencës”), “Cité de la Musique”, “Institut i Botës Arabe”, “Parc de la Villette”, “Qendra e Konferencave Ndërkombëtare”, “Ministria e Financave” “Opera e Bastijes” apo së fundi “Bibliothèque National de France”.

“Një popull pa kujtesë, nuk është një popull i lirë!”- kish thënë diku ai.

“Le Grand Louvre” dhe “Bibliothèque National de France” ishin një krenari e ligjshme.

“Është e vërtetë që jam krenar për to”,- shprehej ndër miqtë e tij. Ngjyrat e qiellit...

Tashmë ai e kundronte shpesh e më shpesh atë qiell që fshihte aq shumë mistere. Shpesh ditët i kalonte duke lexuar. Librat e fundit të tij ishin “Procesi i Neronit” i P.Grimal, “Perandoria romake” e P.Petit apo “Historia e Romanëve” e V.Duruy. Gazetarët ngado i kërkonin takime, intervista. Një ditë “Telorama” e pyeste: “Mos vallë vetmia është tashmë pasioni juaj?”

–“Secili ka drogën e vet”, -i ishte përgjigjur Miterani. “Droga ime është heshtja. Unë e dua heshtjen, por dhe kam frikë nga ajo. Megjithatë, pa atë, unë do ta humbja atë ndjesi të hollë që të lejon të komunikosh me shpirtrat e gjërave”.

Njëzet kilometra larg Château-Chinon, një zonë në malin e Beuvray, më 1985 Miterani e kishte shpallur “qytezë historike kombëtare. Dy mijë vjet më parë, në këtë zonë të Burgonjes (Bourgogne), ajo qytezë ishte kryeqyteti me emrin Bibracte. Që këtej, në kohë të kthjellët, mund të shihje dhe “Malin e Bardhë” (“Mont Blanc”).

Në vitin 58 p.e.s, helvetët, të shtyrë nga gjermanët kërcënojnë ta pushtojnë vendin. Por vendasit i kërkuan ndihmë Cezarit të Romës, i cili me legjionet e tij i shpartalloi ata. Ky ishte fillimi i pushtimit romak. Por vite më pas vendasit do të nisnin revoltën nën kushttrimin e një heroi popullor të quajtur Vercingetorix, i cili u bë udhëheqës i galuazeve. Ai arrin t’i shpartallojë legjionet romake. Kështu, pas fitores, ai shpallet prijës i galuazeve.

Miteranin në fakt e tërhiqte pa masë ky vend. Në Château-Chinon ai kishte qenë për vite me radhë kryetar bashkie. Njerëzit, fshatrat, peizazhet e këtij vendi ishin bërë shumë familjare për të. Vitet e fundit, duke e vizituar disa herë radhazi këtë vend, ai

kishte menduar se këtu mund të vendosej dhe varri i tij. Dhe një çast e vendosi. Bleu një copë toke 10 mç, ku do të ngrihej varri, në majë të një kodre të gjelbëruar. Por ky varr do të mbetet hipotetik. Në çastet e fundit, Miterani do të vendoste ta ndryshonte drejtimin e udhëtimit drejt botës së të vdekurve.

Që para disa muajsh, në një mënyrë misterioze, një dorëshkrim ishte dërguar nga Venecia për shtëpinë botuese "Editions du Rocher", në Monako, nënshkruar nga Martilio M....

Një dorëshkrim i quajtur "Testamenti im", mjaft impresionues dhe që përshkruan me imtësi e besnikëri jetën e Miteranit. Cili vallë fshihej nën këtë emër, për të shkruar testamentin e tij?

Ngjyrat e qiellit...

Ai ndoshta çuditej me vetveten pse gjithnjë e më shumë vështrimi i tij drejtohej nga qielli. Përse vallë? Një mister?

Pasditeve priste Mazarinën dhe bashkë shkonin të shihnin galeritë e piktorëve apo të uleshin në një restorant në bulevardin Montparnasse apo në aveny Lowendal. Sikur çmallej me Parisin, me atë Paris që ishte aq intim dhe i lidhur me jetën e tij. Herë-herë, paraditeve vinte gazetari Georges Marc Benamou me të cilin punonin për përfundimin e librit "Bisedime", një intervistë e gjatë rreth jetës së tij.

"Unë nuk jam ashtu siç më kanë përshkruar gjer më sot gazetarët,- i thoshte atij Miterani.-"Unë kam vuajtur shumë nga urrejtja e golistëve. E djathta nuk i fal borgjezët që lenë kampin e tyre".Kur ishte i çlodhur, ulej për të shtuar diçka në atë dorëshkrim kujtimesh, prej 700 faqesh që shtëpia botuese "Odil Jacob" e priste. Por ai s'do ta mbaronte kurrë atë.

Gjithnjë e më shumë i kujtohej rinia kur kërkonte librat e vjetër nëpër bukinistët buzë Senës në "Rive Gauche" ("Bregu i Majtë"), "Quai Malaquais"? në "Quai des Grands Augustins" dhe pastaj në "Quai Conti"... Kujtonte libraritë e "Saint-Germain-des Pres" apo librarinë e tij të preferuar në "Pont Traversé". Si në mjergull pastaj i shfaqej "Gare Austerlitz" ku kishte zbarkuar një ditë të vitit 1934, ndërtesa në 104, Rue Vaugirard, konvikti i studentëve, dhoma D13, "Place Odeon", kur punonte si gazetar apo berraria "Lipp", ku "zbarkonte" gjithnjë në vitet 50.

Më 4 qershor, 1995, tradicionalisht ai do të bënte

pelegrinazhin e tij, drejt majës së Solutre. Shkonte gjithnjë me miqtë e tij të afërt. Por ai nuk mund të shkojë gjer në majë, si zakonisht. Është i lodhur.

Në vjeshtë shkon në Auvergne dhe për herë të fundit, kthehet në ishullin “Belle Ile”. E admironte shumë detin me dallgë dhe horizontin që puqej njësh me qiellin.”

Një ditë ai pyet mikun e tij, shkrimtarin Jean Daniel se si e përballojnë pleqërinë shkrimtarët Ernesto Sabato dhe Coloan, këta dy pleq të madhërisëm, të cilët Daniel, i kishte takuar gjatë udhëtimit që kishte bërë këto kohë në Amerikën Latine, në Buenos Aires dhe Kili. Daniel i ishte përgjigjur:

-Sabato më tha se “jeton sikur të jetë një i pavdekshëm” , ndërsa Coloan m’u përgjigj se “tashmë është i vdekur”.

Një tjetër ditë, duke bashkëbiseduar me Elie Wiesel, ky i fundit e pyet:

-A do të kishit mundur të bënit një jetë tjetër nga ajo që keni jetuar?

-Sigurisht. Jetën time unë do t’ja kushtoja refleksioneve, pemëve, kafshëve dhe njerëzve që dua. Kjo ndoshta është një ëndërr bukolike. Aventura e shpirtit është më e fortë se aventura e aksionit...”

Fillim tetori 1995. Xhorxh Bush e fton atë në Colorado Springs, ku do të takohen me ish- kryetarët e shteteve që kishin drejtuar në kohën e pas Luftës së Ftohtë. Një takim i veçantë internacional, ku Miterani do të shpalojë përsëri refleksionet e tij filozofike, ndoshta për herë të fundit, refleksione rreth shembjes së komunizmit, bashkimit të Gjermanisë dhe çështjes së minoriteteve. Përkrah tij, Gorbaçov, Margarit Theçer, e shumë të tjerë.

Ai nuk mundi dot të vizitojë qytezën e rrallë shkëmbore 300 milion- vjeçare të Teksasit të quajtur “Kopshti i Hyjnive”. Por ai mundi të flasë për ardhmërinë e botës: “Çështja e madhe e shekullit XXI do të jetë gjetja e sintezës së dy nevojave të shoqërisë njerëzore: nevojës së aglomerateve të mëdha , si dhe të nevojës së çdo kolektiviteti për t’u afirmuar i tillë në mëvetësi.”

Krishtilindjet e fundit do t’i kalonte në Egjipt. Një dëshirë e madhe dhe e vjetër për t’i festuar Krishtlindjet gjithnjë me familjen e tij. Festa kalonte së bashku me Mazarine dhe Anne Pingeot.

Mjeku e kuptoi dëshirën e madhe të tij dhe pranoi që ai të

shkonte në atë vend ku kishte vajtur radhazi që nga vitit 1988.

Tempulli i Philae, ishulli Naser...

Ky vend kishte qenë dikur vend i preferuar i Curçillit, i Car Nikollës II, i mbretit Fuad të Egjiptit. Bile aty dikur vinte shpesh dhe Agata Kristi. Dhomat ishin të mobiluara në stilin e “La Belle Epoque” dhe nga dritarja dukej Nili, ishulli dhe tempujt e lashtë...

Ata e njihnin tashmë pasionin e madh të Miteranit për arkeologjinë, për piramidat dhe historinë e tempujve të vjetër. Ai ishte një udhërrëfyes dhe “guide” për Mazarine apo të tjerë kur u tregonte tempujt në Louxor, tempujt e Assouan, në Haute-Egypte, piramidat, manastirin e Sainte-Catherine, Sinain etj. Një pasion i tillë e kishte çuar pa dyshim të vendoste për ndërtimin e një piramide në oborrin klasik të Luvrit.

“Të vdesësh buzë Nilit, do të ishte një vdekje e bukur, apo jo?- i thotë një ditë një të afërmi të tij.

Mbrëmjet i kalon gjithnjë pranë Mazarines, me duart mbështetur tek njëri tjetri.

Më 29 dhjetor, duke u ndarë me personelin e hotel “Old Cataract” buzë Nilit, si dhe me turistët që gjendeshin aty, ai merr rrugën për në Francë.

Kthehej në Latche, ku gjithnjë festonte Vitin e Ri me familjen e tij, Danielën, djemtë, mbesat dhe miqtë e tij të afërm. Në thellësinë e shpirtit ai ndihet i lehtësuar, i kënaqur, edhe pse ndjen dhimbje. Një festë e trishtë, por dhe e ngrohtë njëkohësisht.

Pa shkuar ora njëmbëdhjetë e natës, ai merr leje të largohet. Ikën duke tundur dorën lehtë, si të përshëndeste për herë të fundit. Duke festuar Krishtlindjet dhe Vitin e Ri me të dy familjet e tij, veç e veç, ai e konsideroi se kështu u përshëndet me gjithë të afërmit e tij në këtë botë. Për këtë nuk trishtohej, se siç thoshte ai “ unë kam pasur një jetë të bukur dhe kam qenë aktor i kësaj historie”.

“Ne po e shohim për herë të fundit ,”- i kishte pëshpëritur miku i tij Lang, gruas së vet.

Dy ditë para se të vdiste ai nuk pranon të marrë ilaçet, që mjeku i jepte çdo ditë.

“Tashmë e kam rregulluar problemin e vdekjes,”- mundohet të bëjë shaka ai.-Tani nuk i trembem më asaj! Por shumë pyetje kam se ç’do të ndodhë pastaj?...

Ai e porosit mjekun Tarot që askush të mos hyjë më në dhomë.

“Ata që më duan , do më kuptojnë”!

Ai e konsideronte shkatërrimin fizik si një poshtërim të personalitetit.”Kishte frikë se mos humbte aftësitë mendore,”- tregon djali i tij Gilbert. Pra , donte të vdiste me mendje të kthjellët.

“Mors ultima ratio”
“ Vdekja është arsyeja e fundme “

Forcat e shpirtit

Një ditë të vitit 1982, disi “incognito”, ai kishte zbarkuar papritur me helikopter në Creuze, në shtëpine e një filozofi “chretien”, Jean Guilton, një nxënës i dikurshëm i filozofëve Henry Bergson, i Chevalier dhe Maurice Blondel. Filozofi i vjetër që e njihnte prej kohësh Miteranin, u çudit kur ai iu shfaq në derë. Diçka e rëndësishme e kishte shtyrë presidentin të shkonte gjer atje.

“ Meqenëse ju jeni specialist i kohës dhe i përjetësisë, dhe meqë ajo që ne e quajmë vdekje, është kalimi i kohës drejt përjetësisë, dua t’ju pyes, ç’është vdekja dhe bota e përtejme?”

Filozofi, që e njihnte Miteranin si një materialist dialektik dhe socialist të flaktë , nuk e priste një pyetje të tillë. Duke kujtuar atë moment, Jean Guilton , autori i librit të njohur “Koha dhe përjetësia”, kujton:

“Atë ditë ai më tha se feja është një grumbull absurditetesh.-Jo, iu përgjigja, është një gjithësi misteresh. Absurditeti është hiçi, i cili ka veçse një zgjidhje: t’ia heqësh vetes me një plumb. Ndërsa misteri është një shkallare ku ne ngjitemi!

Ai më pyeti se cila ishte shkalla e fundit.

-E thjeshtë , - iu përgjigja,- është vetë vdekja.

-Po pas vdekjes?

-Pas vdekjes është bota e përtejme!

-Po ç'është atëherë bota e përtejme?

-Nuk e di... por unë di vetëm se ajo quhet botë e përtejme!"

Pas dy orësh kuvendimi vetëm për vetëm, presidenti u përshëndet me filozofin e mençur, i hipi helikopterit dhe u largua duke mbartur me vete një enigmë të madhe. Ai e dinte se ishte prekur nga kanceri dhe se ishte i dënuar me vdekje. Që nga ajo kohë, Miterani i rikthehet gjithnjë asaj pyetjeje, megjithëse beson tek shkenca dhe realiteti objektiv dhe i ndjen të huaja dogmat fetare.

Ai fillon të tregojë interes ndaj fesë, fillon të lexojë mistikët e mëdhenj. Adhuronte figurën e Therese d'Avila, të shenjtit François d'Assise, të Saint-Jean de la Croix apo të Therese Lisieux, një besimtare e pashkollë, por e habitshme. Kjo e fundit i pëlqente se megjithëse e përkushtuar ndaj Krishtit, dyshonte në ekzistencën e vërtetë të Zotit. Lexon me etje Biblën duke u shprehur më pas se "Bibla nuk është dhe aq mistike, ajo është një libër i arsyes i destinuar për shtëpitë e popullit. Megjithëse një libër i mbushur me masakra dhe akte të pamëshirshme, prapë historitë e asaj kohe i shërbejnë diçkaje...Ç'forcë dhe ç'poezi që kanë!"

Vitet kalojnë. Një ditë, një gazetaresje, që e pyet nëse beson te feja ai i përgjigjet: "Unë kam lexuar sa ç'mund të lexohet për këtë gjë, por historikisht besoj në ekzistencën e Krishtit".

Miterani e shpall veten agnostik, si njeri që beson në atë që njih konkretisht dhe në realitet. Besimi ndaj shkencës e ka bërë të tillë, megjithatë pikëpyetjet e tij janë të mëdha."Shpirti njerëzor nuk ka gjer më sot një përgjigje të pyetjes "Përse?".

Disa herë takohet me abatin Pierre në Francë. Herën e fundit që ishin takuar në abacinë e Saint Wandrille, abati Pierre ishte habitur me të:

"Pyetja e tij kryesore nuk ishte e lidhur me vdekjen, por për misterin e saj, çka ishte një refleksion i apasionuar për të".

Dy herë radhazi ai shkon në manastirin Saint-Catherine në gadishullin e shkretë të Sinait, ku pas eksodit të hebrenjve, ata jetuan dyzet vjet pasi ikën nga Egjipti. Një vend mistik ku Moisiu dhe profeti Elie lanë gjurmët e tyre.

Në takimin me nobelistin Elie Wiesel për librin e tyre të përbashkët “Kujtesë në dy zëra”, ai i thotë Wiesel-it:

“Unë dyshoj te Zoti . Më ngjan sikur jam në një shkretëtirë ku ai mungon... megjithatë unë vazhdoj t’i besoj!...

Dalëngadalë, ai anon drejt mistikut.

“Dyshimi e shoqëron në mënyrë fatale besimin,”- i thotë Wiesel-it,- Përse ekziston kjo tërheqje e njerëzve ndaj mistikes? Vallë pse kështu ata i japin gjithçkaje poezi?”

Çdo vit, që prej 14 vjetësh, ai shkante në Taize, në jug të Francës, në komunitetin ekumenik të “Frere Roger” . Në urimet e fundit të tij, të Vitit të Ri 1994, më 31 dhjetor, përmes televizionit , dëgjova t’u thote , ndër të tjera, francezëve:

“Unë besoj në forcat e shpirtit”.

Disa ditë më pas ai do të pohojë: “Më shumë se çdo gjë tjetër, unë jam agnostik, por unë besoj në forcat e shpirtit. Pyes veten se si do të veproja apo si do të vepronit ju, nëse në vetveten tuaj nuk do të kishit intuitë, vullnet e dëshirë për të qenë më të mirët, për të bërë progres, për t’i dhënë diçka më shumë shoqërisë, për të kërkuar diçka më të bukur, për të kërkuar drejtësi, për të ëndërruar më shumë për lumturinë. Si mund ta bënim këtë po të mos interesoheshim në vlerat shpirtërore dhe estetike?...”

Ai e ndjente se shpejt do të vdiste. Por donte të vdiste me mendje të kthjellët, si Makiaveli, i cili, kur e pyetën se kë do të zgjidhte midis ferrit dhe parajsës, zgjodhi ferrin, se , siç thoshte ai, “atje do të mund të bisedoj me njerëzit e mëdhenj, dhe unë dua të kuvendoj gjatë me ta”.

Në fund të një emisioni televiziv te Bernard Pivot, “Buillon de culture”, kritiku francez e pyeti Miteranin:

-Nëse Zoti do t’ju takonte një ditë, ç’do të donit t’ju thoshte?

Miterani e pa i habitur dhe, pas një refleksioni të shkurtër, me një buzëqeshje të lehtë u përgjigj:

-Më së fundi ti e di që ekzistoj..Je i mirëseardhur!

Më 8 janar 1996, një lutje e primatit të “Frere Roger” nga Taizé për presidentin, mbërriti në avenynë “Frederic-Le Play” në Paris.

Por Miterani atë mëngjes sapo kishte mbyllur sytë përgjithnjë për gjumin e përjetshëm.

“Ira furor brevis est”
“Zemërata është një çmenduri e vogël”

“Sekret shtetëror”

Që nga vitit 1981 e gjer më 1992, kur Miterani u operua për herë të parë, ai kërkoi që sëmundja e tij të mbahej “sekret shtetëror”.

Gjithçka kishte ndodhur në kohën e vizitës së tij në Cancun . Papritmas ai kishte ndier dhimbje të mëdha në shpinë dhe në këmbë. Më 16 nëntor 1981, ai kërkoi të diagnostikohet dhe për këtë u konsultua me profesorin Adolphe Steg, i cili pas vizitës konstatoi se pacienti i tij ishte prekur nga një kancer prostati, metastazat e të cilit kishin filluar. Pra , kanceri ishte i paoperueshëm. Doktorit të tij personal Claude Gubler, i duhet të bëjë raportin mjekësor, por që nga ajo ditë, për 11 vjet radhazi atij i duhet ta fshehtë këtë diagnozë nga mbarë opinioni publik , si dhe nga familja e presidentit.

Pas disa analizave të tjera dhe vërtetimit përfundimtar se kishte të bënte me një kancer të paoperueshëm, Miterani, i tronditur i thotë profesorit Steg:

-”Domethëne jam i mbaruar?!”

-”Kurrë s’mund të themi se jemi të mbaruar...Ne do të fillojmë një trajtim mjekësor...”- i kishte thënë Steg.

Miterani, me një fytyrë gri, nuk di të thotë më asnjë fjalë.

Megjithatë ai refuzon të shtrohet në spital. Pas këtij takimi, në korridoret e “Palais de l’Elysée” doktori Gubler e pyet profesorin se sa mund të zgjasë kjo lloj sëmundjeje.” Afati i mbijetesës është gjer në tri vjet. Në raste të veçanta diçka dhe më shumë...”

Për 11 vjet rresht Miteranit i bëheshin inxheksione të përditshme në shtëpi, në Pallatin e Elizesë, në avion, në hotele të ndryshme të kryeqyteteve të botës. Çdo gjashtë muaj, doktor Gubler firmoste buletinin mjekësor të shëndetit të presidentit , i cili ishte publik. Më 1990, një çast ai mendon të japë dorëheqjen “për arsye shëndetësore” dhe me këtë rast, siç tregon mjeku i tij, do të bëjë të njohur dhe sëmundjen e tij. Por këshilltarët e tij e ndalojnë botimin e atij buletini, duke e bindur atë që mos ta bënte një hap të tillë. Në atë kohë sapo kishte filluar lufta në Gjirin Persik. Nga redaktimet e bëra, buletini që botohet kalon pa u ndier në shtyp. Analizat e presidentit bëheshin në spital, nën emrin e rremë të një pacienti të quajtur Xavier Carpentier.

Në fakt, gjer në vitin 1991 nuk ka asnjë zhvillim të kancerit. Trajtimi i doktor Steg i kishte stabilizuar qelizat kanceroze, të cilat nuk po zhvilloheshin. Kjo e bëri presidentit ta “harronte” se vuante nga një sëmundje vdekjeprurëse, siç ishte kanceri. Siç kujton dhe këshilltari i afërt i presidentit, shkrimtari dhe eseisti Jacques Attali në librin e tij “Verbatim 1”, “presidenti më tha se mjekët janë budallenj. Ata kanë gabuar rreth diagnozës sime, pasi unë nuk kam kancer”.

Më 1992, më së fundi, Miterani vendos ta bëjë të njohur publikisht sëmundjen e tij, në një kohë që thashethemet dhe gazetaret flisnin për një gjë të tillë.

Operacioni i parë bëhet më 16 shtator 1992 në spitalin Cochin të Parisit. Pas operacionit, Miterani nuk e besonte se kishte pasur vërtet kancer, por tashmë progresi i sëmundjes ishte vërtetuar.

Kjo sëmundje ishte familjare, gjenetike, në gjirin e familjes Miteran. I jati, Joseph, kishte vdekur nga kjo sëmundje në vitin 1946, duke vuajtur shumë, pasi atëherë nuk kishte ilaçe lehtësuese për dhimbjet. Më pas po nga kjo, i kishte vdekur një nga vëllezërit. I prekur nga ky lloj kanceri në prostat ishte prej vitesh edhe vëllai tjetër, Roberti, i cili dukej se e kishte frenuar përparimin e sëmundjes. Duke parë keqësimin e presidentit, vëllai i tij thirri një urolog amerikan, profesorin Pontes. Pa e ekzaminuar personalisht, ai vendosi fillimin e

një kimioterapie të fortë, në kundërshtim me mendimin e profesor Steg dhe të doktor Gubler.

Operacioni i dytë bëhet më 16 korrik 1994. Një operacion i gjatë, rezultatet e të cilit nuk premtojnë. Të shqetësuar, të afërmit e Miteranit, thërresin në ndihmë një mjek të mjekësisë natyrore, Philip de Knyper, kurat e të cilit ishin të dyshimta për kancerologët francezë. Por shpresat janë gjithnjë e më të vogla. Më 1994 - 1995 ai ndjen dhimbje gjithnjë e më të mëdha. Doktor Gubler është i pafuqishëm përballë sëmundjes.

Në librin “Sekreti i Madh”, që u botua disa ditë pasi Miterani përcillej për në banesën e fundit, doktor Gubler, ky personazh me favorite, që ngjan sikur ka dalë nga librat e Balzakut apo të romancierëve të tjerë të shekullit të 19, flet për gjendjen tepër të rëndë dhe kritike të presidentit, duke e zmadhuar ndoshta më shumë se ç’duhet gjendjen e tij. Në fakt, doktor Gubler ishte larguar nga Pallati i Elizesë dhe një doktor tjetër e mbikëqyrte presidentin. I fyer nga kjo, Gubleri, pa pritur ende javën e mbarimit të ceremonisë funebre, nxori librin e tij të përgatitur më parë me kujdes, bashkë me një gazetar të revistes “Paris Match”. Sigurisht, gjithë opinioni publik u trondit. Aq me tepër bënte përshtypje pabesia e një doktori, që arrin gjersa të thotë se :”Në nëntor 1994, Fransua Miteran “nuk ishte më në gjendje të përballonte funksionet e tij dhe mandatin për të cilin e kishte zgjedhur populli francez. Në këtë kohë programi i punës zhvillohej në shtrat. Ai nuk punonte më, pasi e vetmja gjë që e interesonte, ishte sëmundja e tij.”

Në fakt gjithë klasa politike franceze e hodhi poshtë tezën e doktorit Gubler. Kolegët e tij e dënuan mllëfin e Gublerit dhe nxjerrjen e sekretit profesional, pasi gjithçka mes pacientit dhe mjekut duhet të jetë konfidenciale. Pas padisë së ngritur nga familja Miteran, gjykata e dënoi botimin e librit dhe ndaloi qarkullimin e tij, një rast i rrallë ky në historinë e shtypit francez.

Po t’u rikthehesh takimeve presidenciale të kësaj periudhe gjer në fund të mandatit të tij, intervistat në televizion, takimet politike etj, e kupton se gjithçka nga këto të thëna, është e rreme. Miterani shpaloset në këtë periudhë me një mençuri e thellësi të jashtëzakonshme, siç u pohua me rastin e këtij incidenti, nga gjithë klasa politike franceze. Fjalimi i tij në Berlin më 1995 mahniti gjithë

botën.

“Presidenti Miteran,- deklaroi profesor Steg,- i përmbushi detyrat e tij gjer në fund, me efikasitet dhe devotshmëri”.

Siç duket Gubler mendonte se ky incident mund të kalohej thjeshtë, duke llogaritur kështu shuma të mëdha me shitjen e këtij libri, i cili siç dihet u rrëmbye nga mijëra e mijëra lexues sapo u shfaq në vitrinat e librarive.

Familja e Miteranit e hodhi në gjyq doktorin Gubler , sepse ky shkeli betimin e Hipokratit për të cilin betohen të gjithë mjekët. Libri, edhe pse pati një sukses të jashtëzakonshëm komercial (brenda dy ditëve u shitën 40 mijë kopje) u ndalua për “cenim të jetës private e familjare të presidentit Miteran dhe nxjerrjen e sekretit profesional”. Megjithatë, kushdo sot mund ta lexojë atë përmes ordinatorëve, të cilët janë të lidhur me Internet, ku libri është kopjuar faqe më faqe. Gjithashtu familja e Miteranit hodhi në gjyq dhe revistën e njohur “Paris Match” e cila, kundër dëshirës së shpallur të Miteranit dhe të familjes, kishte botuar dy fotografi të Miteranit, të shtrirë në shtratin e vdekjes...

*“Nombreuses sont les merveilles,
mais rien n’est plus merveilleux
quel’homme!”*

“Të shumta janë mrekullitë, por asnjë nuk
është më e mrekullueshme se njeriu!

Sofokliu

Shën Fransua...

Ishin dyzet e tetë orët e fundit të jetës së tij. Si në labirintet e një piramide të lashtë ai do të hapte portën e gurtë për të zbritur poshtë, drejt atij misteri. Ishte porta e fundit.

Në dhomën e tij, pothuaj krejt të zhveshur ku kishte veçse libra dhe një portret të vetëm varur në mur : François d’Assise. Më shumë se kurrë në këto momente, ai e ndjente atë figurë shenjti mjaft të afërt, sikur të ishte një sozi e tij...

Ai e njihte mirë jetën e këtij shenjti që kishte jetuar në fundin e shekullit të 12 dhe që gjithë jetën ia kishte kushtuar shërbimit ndaj njeriut dhe dashurisë njerëzore. Ishte pikërisht ai që kishte krijuar urdhrin e franceskanëve, që është edhe sot, një urdhër fetar ku pas vdekjes së tij u mbloodhën qindra e mijëra e pastaj miliona besimtarë, doktrina e të cilëve ishte pajtimi. Atë portret ai kishte mundësi tashmë ta vështronte me orë të tëra. Si të thuash, dialogu i vetëm tashmë zhvillohej mes tij dhe shenjtit.

Përse vallë nëna e tij e kishte quajtur Fransua dhe i kishte dhënë emrin e këtij shenjti. Pse ajo ishte një katolike e devotshme?...Edhe shenjti Fransua vitet e fundit të jetës së tij kishte

vuajtur nga dhimbje të tmerrshme fizike, të cilat ai i përballonte me një stoicizëm të jashtëzakonshëm. A nuk kishte treguar një stoicizëm të tillë dhe ai?

Shenjtji Franuas ishte prift, por ai shkruante bukur, ishte si të thuash një prift poet... Vargjet e tij të fundit kishin qenë vërtet një himn i pavdekshëm.

*“Lëvduar qofsh o Zot, që ke hënë motër,
Dhe yjet aq të bukur që ke krijuar në qiellin e kaltër;
“Lëvduar qofsh o Zot, që erën ke vëlla,
Lëvduar qofsh për ajrin, mjergullën dhe qiellin e kthjellët,
Dhe për gjithë kohërat ku ti mban në jetë krijesat e tua,
Lëvduar që motër ke ujin dhe vëlla zjarrin...”*

Mbrëmje e datës 7 janar. Vallë sa ishte ora? ...

Doktor Tarot nuk i shqitej nga dhoma. Ai e ndjente se dora e Presidentit ishte ende e ngrohtë në duart e tij. Duke vështruar nga tabloja e shenjtit atij iu kujtua se para ca kohësh, Julien Green, kishte botuar një libër për François d’Assise, të titulluar “Frere François”.

Po, në fund të jetës së tij, shenjtji Fransua vuante tmerrësisht. Mjekë të shumtë i ishin mbledhur te koka ditët e fundit, por ai u kishte thënë: “Asgjë tashmë nuk vlen, veç Zotit!”

Më pas, duke hapur me stërmundim krahët ai kishte thirrur “Motër vdekje, mirësejjen!”

Tashmë Presidenti e ndjente se po shuhej, po binte në një gjumë të madh. Portreti i shenjtit Fransua iu mjergullua ngadalë. Tashti po ikte, po zbriste, ndoshta po ngjitej, kushedi? Ai tashmë nuk po kuptonte se ç’po ndodhte me të. Tashmë ishte ballë për ballë me misterin e madh...atë mister që aq shumë e kishte munduar.

Ishte mëngjes, në aveny “Frederic-Le Play”...dhe binte një shi i imët.

“*Deo gratias!...*”
“Le t`i nderojmë Zotat!...”

Dhe Zotat gjithashtu vdesin ...

Nën kubenë gotike të katedrales së Notre-Dame, në Paris, , nga sytë e kancelarit gjerman Helmut Kohl, rrëshqet një lot.

Dhe zotat gjithashtu vdesin...

Homazhi që Franca dhe bota i bëri këtij njeriu, ishte i jashtëzakonshëm, unanimit, duke i kapërcyer kufijtë e një vendi. Një popull anonim e përcolli atë me dhimbje.

Vështrimi i tyre e ndoqi gjer në banesën e fundit, në varrezat e qytezës Jarnac, në “Le cimetiére des Grands Maisons”.

“Kjo ishte vdekja e një prej titanëve të fundit të Politikës,- shkroi filozofi francez Edgar Morin,- i cili përjetoi në një kohë epike. Kjo vdekje heroie ka ngjallur një himn funebër gjigantesk, nga njerëzit e mëdhenj dhe njerëzit e thjeshtë të këtij rruzulli. De Goli ishte një hero kornelian, ndërsa Miterani, duke pushuar së qeni një hero romanesh, u bë një hero tragjedi dhe më së fundi gjeti sovranitetin e vetvetes.”

Po, një nga titanët e fundit të mëdhenj...Filozofi Morin e kishte njohur Miteranin gjatë kohës së Rezistencës dhe bashkë kishin kryer disa aksione.

Pothuaj të gjitha gazetat e botës folën për vdekjen e tij dhe i

bënë homazh: “New York Times”, “Washington Post”, “Frankfurter Allgemeine”, “Guardian” dhe “Financial Times”, “El Pais” apo “La Republica”, emisione radiofonike e televizive nga e gjithë bota. Pothuaj të gjitha gazetat shqiptare shkruan për vdekjen e tij.

“Evropa humbi një burrë të madh shteti”,- do të thotë Kohl.

“Unë humba një mik të madh ,- deklaroi Boris Jelcin, - dhe nuk mund të mos vija ta nderoja këtë politikan të kalibrit botëror”.

“Një njeri i fjalës, një mik që do më mungojë gjithnjë”- thotë Bush...

Post-mortem

Rrallëherë në historinë franceze, vdekja e një presidenti kishte lënë kaq shumë mbresa. Rrallëherë një vdekje e tillë kishte qenë diçka e përkryer dhe solemne. Thua se ai i kishte menduar dhe paraprirë me kohë. Një ngjarje me një jehonë të madhe kombëtare e ndërkombëtare, një vdekje mediatike, që linte pas një mori pikëpyetjesh. Vdekja e Pompidusë kishte qenë tepër private, ajo e Gjeneralit mjaft e thjeshtë, jehona e vdekjeve të presidentëve të tjerë të Republikës IV ishte shuar shumë shpejt, bile edhe ajo e Felix Faure. Jehonën më të madhe e kishte lënë vdekja e Luigjit.

Tashmë, varri i tij i thjeshtë mbante vetëm një mbishkrim “François Mitterrand, 1916-1996.”

Por shpejt, varrezat e “Cimetière des Grands Maisons” do të ktheheshin në një vend pelegrinazhi. Tufat e para të luleve mbanin emrat e Helmut Kohl dhe të Nelson Mandelës....Mijëra e mijëra trëndafilë të kuq, duke “thyer” kështu dëshirën e presidentit, vetëm për një tufë trëndafilash ngjyrë çaji.

Thua se presidenti e kishte parashkuar hyrjen e tij në Histori. Kjo dukej gjer në portretin e tij, që kishte lënë pas, një figurë e ulur mbi karrike, vizatuar nga piktori Jean Huoleux në studion e tij në Vaux-sur-Seine. Një portret hijerëndë, imperial, roman dhe me një

buzëqeshje të hollë, që gjatë katër muajve piktori e vizatoi në plumb.

Në një nga intervistat e fundit me kritikun francez Bernard Pivot, ai i ishte përgjigjur:

-”Po, unë e dua historinë, dua të shkruhem në të...Sot, ne mezi kujtohemi për Tautakhamon. Po pas disa milionë vitesh ç’do të thonë për gjeneralin De Gol, Pompidu, D’Esten, për mua apo për tjetrin që vjen më pas? Pra të jemi relativë... Është e vërtetë që ka diçka tek unë që më josh...dhe kjo është një dëshirë e thellë!”




Miterani në moshën 13-vjeçare



1 shkurt 1935. Në një manifestim të studentëve parisianë.



**15 tetor 1942.
Me Marshallin Peten.**



Shkurt 1943. Në vitet e Rezistencës, kur Miterani vepronte në ilegalitet me pseudonimin Morland.

Me Fransua Moriak, 1949.



Në Festivalin
e Kanës.
Me Danielën
dhe Brixhidë
Bardonë.

Më 1965, De Goli
vihet në vështirësi
nga kandidatura e
Miteranit për
president.



Shkurt 1968. Gjatë një mitingu të partive të majta: Zhorzh Marshe, Valdek Roshe, Fransua Miteran dhe Gi Mole.



**Me sekretarin e përgjithshëm të PK Franceze Zh.Marshe,
në vitin 1973.**



22 shtator 1984.
Fransua Miteran dhe Helmut
Kol, nderojnë në Verdun
viktimat e dy luftimeve botërore.



10 maj 1981.

**Prill 1987.
Duke vizituar
kantierin e
Piramidës së
Luvrit, që u
përrua më
4 mars 1988.**




**15 prill 1988:
Lionel Jospin
shoqëron
Miteranin në
Marsejë, gjatë
fushatës së
zgjedhjeve,
presidenciale.**





Maj 1988. Fransua Miteran fiton për herë të dytë mandatin presidencial. Margarite Duras ka ardhur në Elize për ta përgëzuar.



Të ngrira në hidhërimin e tyre: Anne Pingot dhe Mazarine.

A-Dieu!...

***Respekt për burrin e shtetit dhe
admirim për të si Njeri***

Fransua Miteran është një vepër më vete. Për këtë lexues të madh dhe të dashuruar pas librave të bukur, të shkruarit ishte si një frymëmarrje natyrale. Gjuha e tij klasike ishte gjithnjë një perkthyes besnike dhe e ndjeshme e mendimeve të tij.

Fransua Miteran ishte një dëshirë. Dëshirë për t'u shërbyer disa ideve: solidaritetit dhe drejtësisë sociale, këtij mesazhi humanist që mbart atdheut yne dhe që i ka rrënjët thellë në traditat tona; idesë për t'i shërbyer Evropës, nje Evrope në të cilën Franca, e bashkuar me Gjermaninë dhe në bashkëpunim me të do të zinte një vend të dorës së parë. Por gjithashtu, ai ishte një mënyrë të jetuari e demokracisë sonë, një demokraci moderne, e qetë, pikërisht në saje të një alternative të përmbajtur, që ka treguar se ndryshimi i shumicës absolute nuk do të thotë krizë politike. Institucionet tona janë përforcuar.

Në politikë, Fransua Miteran ishte së pari një njeri që respektonte thellësisht njeriun dhe është kjo arsyeja që ai e hoqi ligjin e dënimit me vdekje. Ai respektonte gjithashtu të drejtat e njeriut. Ai nuk reshti së ndërhyri kudo kur ato shkeleshin. Parimet e tij ishin të qarta dhe ai gjithnjë veprroi në emër të një ideje që ishte njëkohësisht

dhe një ide e Francës.

Por Fransua Miteran, para së gjithash, përfaqëson një jetë. Disa njerëz kanë një jetë të qetë dhe kalojnë ditë të ngjashme, ku herë-herë spikasin ngjarje private.

Presidenti Miteran, në të kundërt, të jep përshtypjen se e ka përjetuar dhe mbushur krejt jetën e vet. Jeta e tij ka përshkuar një shekull histori. Më shumë se pesëdhjetë vjet kanë kaluar në arenën politike, në zemër të ngjarjeve dhe drejt progresit të tyre. Lufta, Rezistenca, mandatet elektorale, ministritë ku shumë i ri ai përligj postin e vet. Pastaj periudha e gjatë kur ai do të jetë një nga figurat madhore të opozitës e që spikat nga vendosmëria, këmbëngulja e forca luftarake e tij. Së fundi, dy shtatëvjeçarë ku ai do të marrë gjithë dimensionin e vet, duke lënë gjurmën dhe stilin e vet në Francën e viteve 80.

Por kjo udhë nuk është udha e vetme e Fransua Miteranit. Nëse ai donte të tejkalonte kufijtë e jetës reale, kjo ndodhte sepse ai kishte pasion për jetën, një pasion që e ushqente dhe që lejonte njëkohësisht dialogun e tij me vdekjen. Ishte jeta në të gjitha format, jeta në orët e tij të shqetësuara dhe të errëta, apo në orët e tij të lavdishme. Jeta e terrenit, jeta e fshatrave tona, të asaj France fshatare që aq shumë ai e donte, pothuaj tmerrësisht. Ai e njëjtte atdheun tonë gjer në jetën e fshatrave dhe kudo ai kishte një marrëdhënie, një mik, sepse ai e kishte pasion miqësinë. Besnikëria që u detyrohemi miqve, ishte për të një dogmë, që ai e çmonte mbi të gjitha gjerat. Përgjatë viteve dhe sprovave të tjerët ju përgjigjen atij me besnikëri të thellë.

Situata ime është e veçantë, sepse unë isha kundërshtari i presidentit Fransua Miteran. Por unë isha gjithashtu kryeministër i tij dhe sot jam ai që e kam zëvendësuar atë në postin e presidentit. E gjithë kjo krijoi një marrëdhënie të veçantë, ku përzihen respekti për burrin e shtetit dhe admirimi për njeriun që luftoi kundër sëmundjes me një kurajo të veçantë, duke e vlerësuar dhe duke fituar vazhdimisht kundër saj.

Nga marrëdhënia ime me të, një marrëdhënie e vjetër, por në pozicione të kundërta, unë ruaj nga ai forcën e tij të kurajos, të një kurajoje të mbështetur mbi vullnetin; ruaj nevojën për të vendosur njeriun në qendër të çdo projekti; ruaj forcën dhe peshën e eksperiencës së tij. Por përfundimisht, ajo që ka rëndësi është sesa

besnike jemi ndaj parimeve të vetvetes dhe sesa arrijmë të bëjmë për Francën.

Në këtë mbrëmje zije për vendin tonë, i adresoj zonjës Miteran dhe familjes së saj, shprehjen e respektit dhe të simpatisë sime.

Ne çastin që Fransua Miteran hyn në Histori, unë dëshiroj që ne të meditojmë për mesazhin e tij.

Zhak Shirak

Vdekja e një miku të vërtetë

Me vdekjen e Fransua Miteran, Evropa humbi një burrë të madh shteti. Gjermania merr pjesë në zinë e Francës. Unë ndiej shumë dhimbje nga ikja e këtij miku të vërtetë. Gjatë shumë viteve, dhe në një frymë besimi reciprok, ne bashkëpunuam ngushtë për thellimin e miqësisë franko-gjermane dhe formimin e Evropes.

Më 1 tetor 1982, kur u bëra kancelar, unë nuk e njihja aspak Fransua Miteranin. Fill pas votëbesimit të qeverisë sime, më 4 tetor unë mora avionin për në Paris, që t'i bëja vizitë presidentit të Republikës Franceze. Si kançelar i ri, për herë të parë unë nuk mund të shkoja jashtë Gjermanisë veçse në Francë.

Që atëherë Fransua Miteran dhe unë kemi pasur bashkëbisedime të panumërta. Ne përshkuam rajone të ndryshme të Francës dhe Gjermanisë. Me këtë rast, ne nuk flisnim vetëm për politikën. Diskutimet tona zhvilloheshin rreth historisë, kulturës, letërsisë. Nuk do ta harroj kurrë vizitën tonë te shkrimtari njëqindvjeçar Ernst Junger.

Gjatë konsultimeve franko-gjermane në Bon, në fundin e vitit 1982, Fransua Miteran më kishte treguar muajt që kishte kaluar në kampin e të burgosurve në Thuringe, në këtë rajon me plot qytete që

mbartin histori: Erfurt dhe Eisenach, Weimar dhe Gotha. Më vonë ne i kemi kujtuar shpesh luftrat franko-gjermane, por edhe rezistencën gjermane gjatë diktaturës naziste.

Vizita jonë në Verdun më 22 shtator 1984 është pa dyshim një nga vizitat tona më të jashtëzakonshme. Së bashku në i bëmë homazh kujtimit të të rënëve të Luftës I Botërore, pikërisht në vendin ku qindra mijëra të rinj, gjermanë e francezë kishin humbur jetën e tyre. Ne zgjodhem Verdunin për arsyet tona personale. Më 1940 Fransua Miteran atje ishte plagosur. Më 1916, po aty kishte luftuar dhe im atë.

Kur kujtoj atë ditë me shi kur ne ecnim të dy përgjatë radhëve të varreve, që zgjateshin pafund, shoh se çdo pamje më ka mbetur e skalitur në kujtesë. Nuk kam harruar asgjë nga pelegrinazhi ynë në varrezat e Douaumont, ku ne shkuam të përkulemi përpara bijve të Francës dhe Gjermanisë, të rënë në fushën e nderit. Në Verdun ne dëshmuam në sytë e të gjithë botës ndjenjat që rrihnin në zemrat tona. Ne kryem atë që Konrad Adenauer dhe Charles de Gaulle kishin ndermarrë duke nderuar njëri-tjetrin nën kubene e katedrales së Reims më 1962: pajtimin dhe bashkëpunimin franko-gjerman.

Fransua Miteran dhe unë e kishim kuptuar menjëherë se bashkëpunimi i ngushtë midis dy vendeve tona ishte forca lëvizese, e domosdoshme dhe e pazëvendësueshme, që të lejonte të ecje përpara në rrugën e një Evrope të bashkuar. Në dymbëdhjetë vjet e gjysmë të mandateve tona, ne përshkuam një distancë dhe arritëm atë që shumë njerëz në fillim të viteve 80 as që e mendonin.

Në fjalimin e tij prekës në Berlin, më 8 maj 1995, Fransua Miteran tha se ai donte të linte si mesazh dhe t'i bënte thirrje Evropës për t'u ndërgjegjësuar për identitetin e vet. Ajo që ai na la trashëgim, është apeli për të përfunduar ndërtimin e Evropës së bashkuar. Vetëm kështu paqja dhe liria mund të ruhen në shekullin XXI.

Fransua Miteran ishte një patriot i madh dhe një evropian i apasionuar. Vizioni i tij politik i një Evrope të bashkuar duhet të vazhdojë të na udhëheqë në mendimet dhe aktet tona.

Helmut Kohl

Ai kishte të drejtë, ndërsa unë jo...

E kam njohur Miteranin që kur isha sekretar Shteti, por takimi ynë i parë dhe ku ndenjëm gjatë, ishte më 1981, kur ai më fitoi ne shtëpinë e tij në Latche. Ishte muaji qershor dhe gjithë pasditen e kaluam së bashku. Ne folëm për shumë probleme të botës. Pastaj e kam takuar dy herë në vit gjatë kohës së mandatit të tij presidencial,. Në atë kohë unë nuk kisha ndonjë preferencë për të. Zhiskar d'Esteni ishte dhe është miku im ,dhe siç e kam thënë disa herë, po të isha francez, Miterani do të ishte zgjidhja ime e dytë.

Gjatë përrurimit të Piramidës së Luvrit, Miterani më pyeti se ç'mendoja për arkitekturën e saj dhe unë iu përgjigja se gjykimi im për Piramidën kishte evoluar: në fillim nuk e pëlqeja atë ide , por kur ajo u ekzekutua, më tërhoqi pa masë.

Sot unë kam një respekt të madh për të. Ai më është imponuar me konceptet e tij filozofike dhe vizionin e tij për politikën e jashtme. Veçanërisht për sa i përket vendosjes së misileve, ku ai ka luajtur një rol krijues të jashtëzakonshëm. Gjithashtu sepse ai diti t'i trajtoje siç duhet sensibilitetet gjermane.

Ai e kuptoi vërtet nevojën e pajtimit dhe të bashkëpunimit franko-gjerman. Mendoj se ai nuk duhej ta preferonte këtë gjë, megjithatë ai punoi që Gjermania të zerë një vend të zgjedhur në

formimin e komunitetit evropian.

Në fushën politike unë isha në kundërshtim total me të. Por ai kishte të drejtë dhe unë e kisha gabim. Mendoja se kjo “uverture” drejt së majtes do t’i shkatërronte socialistët. Më kujtohet dita kur ai më ktheu vizitën, ndërkohë që unë isha sekretar Shteti për politikën e jashtme (1973-1978). Ai më shpjegoi se qëllimi i tij ishte të shkatërronte komunistet, por për t’i larguar nga skena, duhej që ata të merrnin pjesë në skenën politike, të paktën për njëfarë kohe. Kundër dëshirës sime, strategjia e tij në fakt ishte e saktë.

Më kujtohet gjithashtu nje darke me fituesit e Çmimit Nobel, të organizuar nga Eli Wiesel, ku ne u gjendëm në krah të njëri-tjetrit. Gjatë gjithë darkës, ne kundërshtonim pikëpamjet e njëri-tjetrit për eliminimin apo jo të armeve bërthamore.

Ai nuk e donte Reganin, por ai arriti të ketë me të një marrëdhënie interesante. Pra, marrëdhëniet franko-amerikane ishin të mira gjatë kësaj periudhe. Por, çka është më e rëndësishme, Miterani kishte kuptuar se një politikë e jashtme franceze thjesht nacionale nuk ishte e mundur, ja pse ai e krijoi këtë lidhje të privilegjuar me Gjermaninë, për të mënjanuar zhdukjen e ndikimit francez dhe për të mënjanuar prishjen plotësisht të specifikasitetit të saj, përmes entitetit evropian mbinacional.

Dua të shpreh se unë e admiroj thellësisht mënyrën se si ai e përfundoi mandatin e tij dhe se si e përballoi sëmundjen e tij. Sot nuk ka me njerëz shumë të mëdhenj dhe as personalitete politike të vërteta. Sot pjesa më e madhe e kryetarëve të shteteve nuk janë interesantë veçse në kuadrin e funksioneve të tyre. Ndërsa Miterani, perkundrazi, ishte tërheqës dhe në jetën e tij private.

Kam shkruar në një nga librat e mi se bota është e ndarë midis ambiciozeve që duan të duken të tillë dhe atyre që bëjnë diçka. Miterani pa dyshim i përket kategorisë së dytë.

Henry Kissinger

Takime të paharruara

Dy nga ditët më të paharrueshme dhe të gëzuara që kam kaluar më Miteranin, nuk ishin në rezidencën e tij zyrtare, por në shtëpinë e tij në Latche, në Pirrenej. Herën e parë dreka kaloi në një verandë, ku bashkë me të ishin dhe Daniela me të motrën dhe të shoqin e saj, aktorin e njohur Roger Hanin, i cili kishte punuar dikur në një “kibboutz” në Izrael. Edhe një nga djemtë e tij, Jean-Christophe, kishte kaluar gjithashtu nga “kibboutz”, në veri të Izraelit, për të vjelë fruta bashkë me vullnetarë të tjerë.

Shtëpia ku Miterani punonte e flinte, më kujtonte kasollen e Ben Gourion ne Sde Boker; e njëjta thjeshtësi spontane, e njëjta vetmi. Por ndërkohë që izraeliti ishte vendosur në mes të rërës e shkretëtirës, të paprekur nga dora e njeriut, Miterani kishte zgjedhur pyllin dhe pemet që aq shumë i donte. Kulla e vetmisë së tij ishte një dhomë e madhe, pothuaj 100mç, me mure të mbushura plot libra. Edhe shtrati në cep, ishte i rrethuar nga to. Më tej, byroja e thjeshtë, e mbushur dhe ajo me libra, disa prej të cilave ishin hapur. U hodha nje sy shkarazi: silvikulturë, histori dhe biografi. Dallova një album me shkrime të Fernand Braudel, një historian i madh, te cilin e admiroj veçanërisht. Në atë kënd ishin plot libra të frymëzuar nga natyra; punime mbi zogjtë, mbi lulet dhe pemët. Një seksion tjetër u ishte kushtuar

klasikëve francezë dhe rusë. Ajo nuk ishte biblioteka e një koleksionuesi, por e një lexuesi: pjesa më e madhe e librave ishin me lidhje të thjeshtë. Në komodinen pranë shtratit një Bibël ishte hapur. Ishte thjesht Bibla e një lexuesi të Biblës. Përgjatë murit, përballë, gjashtë apo shtatë palë këpucë të trasha për të shëtitur. Edhe Miterani vishej thjesht si Moshe Dajan.: këmishë, pantallona dhe xhakëtë, që vështirë t'i gjesh në dyqanet "shik" të Parisit. Ashtu si Dajan, edhe ai mendonte se rrobat duhej t'i përshtateshin atij dhe jo ai rrobave.

Ne dolëm për të bërë një shëtitje bashkë me një qen të madh. Miterani ndalej para çdo peme dhe më shpjegonte në detaje karakteristikat e tyre. Ai më thoshte me një krenari të dukshme se disa nga ato i kishte mbjellë vetë. Dukej se i donte pothuaj si fëmijët.

Ai më tha gjithashtu se ishte rritur duke lexuar Biblën dhe se kurrë nuk kishte reshtur së studjuari. I mahnitur nga populli çifut, ai kurrë nuk kishte bërë asnjë kritikë, dhe kur një ditë unë i thashë se përse udhëtonte aq shumë, ai m'u përgjigj duke qeshur: " Edhe unë duhet të kem në venat e mia gjak çifuti".

Vizita ime e dytë në Latche ishte në ditet ekzaltuese të verës së vitit 1993, fill pas shpalljes së akordit historik me OLP në Oslo. Pasi kishim përfunduar bisedimet në Bruksel për rolin e ardhshëm të Komunitetit Evropian në ndihmën për procesin e paqes, unë vendosa të ndaloja në Paris për ta vënë në dijeni personalisht qeverinë franceze për atë që kishim përfunduar dhe ardhmërinë e saj. Sipas meje aksioni i Francës do të ishte më i rëndësishëm se kurrë për të rregulluar marrëdhëniet mes Evropës dhe Lindjes së Mesme, të kësaj zone që po dilte, shpresoj, nga konflikti themelor mes Izraelit dhe arabëve dhe po shkonte drejt një zgjidhjeje paqesore. Ta them hapur, ky takim me Miteranin me shqetësonte. Mendoja se do ta gjeja të dëshpëruar për humbjen e përkrahësve të vet në zgjedhje, si dhe për sëmundjen që e kishte prekur. Por çuditërisht u habita. Ai ishte në një humor të këndshëm edhe pse lëkura e tij ishte më e zbehtë se zakonisht. Lexonte pa syza dhe ndjehej mirë. Përsëri familja e tij ishte me të, bile dhe një i ftuar tjetër, Laurent Fabius, që dikur kishte qenë kryeministri i tij, e që Miterani e mbante pranë prej vitesh, ndoshta me qëllimin që një ditë ai të bëhej zëvendësuesi i tij....

Pritja e Miteranit ishte jo vetëm e ngrohtë e miqësore, por edhe plot gëzim. Ai donte të dinte gjithçka për bisedimet në Oslo, se si

ishin zhvilluar ato dhe kur ishin marrë vendimet kapitale. Kështu, nisa nje tregim që ai e dëgjoi me vëmendje të madhe. Kur i thashë se një mëngjes u zgjova nga një telefonatë e një mikut tim, Amos Oz, i cili ishte frikësuar se OLP ishte drejt shpërbërjes, duke më thënë që të bëja ç'është e mundur, unë pashë në sytë e presidentit të shkëlqente diçka, që do te thoshte me të qeshur dhe qetësisht se e kishte kuptuar çështjen.

Sipas mendimit të tij, kjo marrëveshje renditej ndër tri-katër ngjarjet më të rëndësishme të shekullit.

Ai ishte aq i lumtur sa që i la mënjanë rregullat e intimitetit të jetës private dhe të izolimit te nevojshëm, duke ftuar kështu grupin e gazetarëve që prisnin me padurim jashtë shtëpisë së tij të pushimit, e që zakonisht ishte e ndaluar për takime të tilla. Ai i njihte ata me emrat e tyre dhe kur ne u ulëm në stolat e vjetër, ai mbajti nje konferencë të gjallë, të thjeshtë dhe të hapët. Kur një nga gazetarët e pyeti enkas nëse Franca ishte pjesëmarrëse në bashkëbisedimet e Oslos, ai iu përgjigj: "As Amerika!"

Shimon Perez

Një njeri i virtytshëm

“Takimi ynë i parë ishte në Louveciennes, një të diel të Lazareff, Helene dhe Pierre, sovranë të shtypit të asaj kohe dhe sovranë në miqësi gjithashtu. Kujtime të vagëta, që u fiksuan me pas nga një “duel” në “Paris-Match”, midis meje dhe Margarite Duras, në momentin e zgjedhjeve presidenciale. Ajo mbronte Miteranin , ndërsa unë De Gol...Shkurt ne e nisëm jo dhe aq mirë njohjen tonë për t’u bërë më pas miq. Një ditë, kur e takova në një aeroport provincial me 1979-1980, ne ishim pothuaj të vetmit pasagjerë që iu ngjitëm “venerable coucou”, atij avioni të vjetër por me emër. Ndjeva më shumë bezdi sesa gëzim për atë udhëtim që do të bëja me të. Atë kohë, për të ngjarjet nuk shkonin mirë (bile dhe për mua që atëherë kisha fituar disa nocione politike, të cilat më çonin drejt së majtës). Socialistët ishin në një kaos total. Nuk mund të imagjinoje situatë më të mjerë se ajo. Por megjithate, unë bëra një udhëtim mjaft të bukur pranë një njeriu të kultivuar, simpatik dhe tërheqës, të cilin e admirova për forcën e shpirtit.

Një pasdite unë e ftova të pinim një çaj në shtëpinë time në “Rue d’Alesia”. Ai erdhi dhe ne folëm për vdekjen së cilës dikur i kishte shpëtuar për fije, folëm për letërsinë, poezinë etj. Kur iku unë i

thashë me sinqeritet “Mirupafshim se shpejti”. Me vete mendoja se sapo të lodhet nga politika, nëse donte, ai do gjente tek unë një mike interesante, erudite dhe që do t’i pëlqente. Por një vit më vonë ai u bë president dhe unë e dehur nga gezimi kërceva në rrugë, mes mijëra parizianëve, nën një rrebesh shiu... Disa dite më pas, në saje të disa miqve gazetarë, unë e pashë atë në Pantheon, jo larg hyrjes, me vështrimin drejt dhe fytyrë të menduar. Mendova se ajo ditë pa dyshim ishte dita më e bukur e jetës së tij.

Është e habitshme se si ky njeri u shpëtoi rreziqeve të tmerrshme të një presidenti: mosbesimit, vetmisë, paranojës. Gjatë katërmbëdhjetë vjetëve, ashtu si gjithë bota, une pashë se si ai u mbeti mik besnik miqve të tij si dhe vetvetes. Unë kurrë nuk jam penduar për takimin me atë njeri. As pse e kam ndjekur atë. François Mitterand ishte një njeri të cilit “e keqja” nuk i interesonte, një njeri, që njihte veçse virtytin në sensin e paster të fjalës. Ai kishtë bërë latinisht dhe e dinte se fjala kurajo përkthehet në “virtus”, dhe pikërisht në këtë sens, miku im ishte një njeri i virtytshëm.”

Françoise Sagan, shkrimtare

Unë e desha shumë atë...

Telefoni ra. Fransua Miteran kishte vdekur...

Zemra shtrëngohet. Nuk kam asnjë dëshirë të shkruaj.

Presionet janë të forta. Miterani dhe gratë... Ju lutem, tri faqe për Miteranin dhe gratë!

Miterani dhe miqësia... Ky, po, është një subjekt për të shkruar.

Miterani dhe televizioni...Sigurisht, pasi ai e emancipoi atë. Nuk ju thotë kjo diçka?

Miterani djalosh!...Ju e keni njohur mire atë, pra le të flasim për Miteranin në kohë të rinisë.

Lermëni të qetë ju thashë, ndjej dhimbje.

Në fakt, unë e kam njohur mirë, kur ai ishte ende si një zog feniks, i bukur, i ndrojtur, i zjarrtë, që turfullonte nga krenaria dhe ambicja dhe pretendonte për punëra të mëdha. Ajo që ai donte?... Pushteti.

Më vonë e pashë të kalonte sprova te tmerrshme, skandale, "historia e Observatorit", etj, por ai kurrë nuk e humbi gjakftohtësinë.

Po, unë e kam parë atë kur sytë iu përlotën, atëherë kur ai e kuptoi se kishte humbur. Kur unë i thashë për këtë, ai e mohoi. Të nxjerrë lot ai? Kurrë...

Më 1958 e pashë kur vuri të gjitha forcat kundër kthimit në pushtet të De Golit, të një pushteti ushtarak, çka do të nënkuptonte për të një pushtet afatgjatë, jo vetëm për nesër, por edhe për më pas...

I mundur ai? Jo, kurrë! Ai ishte i vendosur. Duhej pritur dhe punuar nga e para. Durimi ishte natyra e tij e dytë, krahas inteligjencës së tij strategjike.

E kam parë në metro, duke mbajtur libra si gurë të çmuar, qe sapo i kishte blërë.

E kam parë duke përgatitur me kujdes “Progamin e Përbashkët”, dhe të dalë i qeshur nga takimi i fshehtë me Zhorzh Marshenë, me ndjenjën se ia kishte hedhur. Nuk e dija se përse bëhej fjalë.

Në dyzet vjet ne kemi bërë përkrah njëri- tjetrit një udhë të gjatë, ku ai ishte miku im më besnik, i pabesë në dashuri si gjithë të tjerët, delikat me ato, të cilat i ishin të shtrenjta, ekonomat i sentimenteve, përgjithësisht i padepërtueshëm. Vështirë ta bindje për të kundertën. Njeri i sekretit. Gjithnjë sovran i vetvetes. Gjer në dhimbjen e viteve të tij te fundit.

Ç’ mund të thuash tjetër? Miterani i legjendës, ngjyrë rozë apo i errët, për të cilin, do të më dukej e huaj ta qortoja per diçka.

Miterani im i denjë për dashuri. Unë e doja atë...

Françoise Giroud, shkrimtare

Të jetosh...

Asnjëherë në ndonjë qenie njerëzore, nuk kam parë atë ndjenjë të rrënjosur aq thellë, atë ndjenjë të tërbuar, të etur, të gëzuar dhe të mrekullueshme si pasioni i tij për jetën. Jeta, gjithnjë jeta, në të gjitha gjendjet e saj. Të hash me shumicë guacka deti apo të lexosh Lamartinin. Te brëdhësh nëpër pyll i shoqëruar nga qentë, të shkosh sa te një mik te tjetri, të gugasesh në sallën e festave të një pallati. Të përkëdhelësh kapakun e lidhur të një libri apo të “çjerrësh” me thonj Gisacard d’Estaing. Të mallëngjehesh në Velezay apo te magjepsesh pas Tapi-së, të dëgjosh mistikët, të frekuentosh batakçinjtë, bile akoma më keq Bosquet.

Të zbulosh horizonte apo të rigjesh ndër vite Latche, Jarnac, Assouan, Venise: gjeografia i rezervon këto thesare të vërteta atyre që dijnë të shijojnë e rivijne atje. Të shijosh të tanishmen pafundësisht, joshjen pas një kalimtareje, lojën e një drite mbi ujë, aromën e një mbrëmjeje dhe papritmas, gjethe të zverdhura dhe bukë të thekur... Por gjithashtu te shijosh ngadalë e me durim, të përgatitësh imtësisht revanshe të pambarimta: ai që e do kohën, kohën për vetveten, le t’i mungojë gjithashtu asaj diçka që është thelbësore. Të luftosh me finesë dhe fshehurazi. Të presësh njerëz dhe të ndërtosh. Çdo ditë, ai e

mbush gjer në majë thesin e tij. Të tjerëve u le dembelinë. lodhjen dhe trishtimin para këtyre dhuratave që të ofron vetë jeta.

Të jetosh, gjithnjë të jetosh...

Ai është i rrethuar gjithnjë nga miq, sepse miqësia është gjëja më e bukur për të jetuar më mirë. Miqtë tanë jetojnë jetë që ne nuk kemi fatin t'i perjetojmë. Ata na shtyjnë në këtë jetë, na mësojnë diçka, na rrisin. Dhe mbi të gjitha, ata janë miqtë tanë. Ç'udhërrëfyes i mirë për gjithë të preferuarit tanë. Ndërkohe që jeta është e bukur, përse kemi luftuar për ta ndryshuar atë?

Ky njeri i madh së pari donte të hiqte dënimin me vdekje. Dhe ashtu u be. Nderuar qoftë! Sigurisht, të tjera gjëra ndodhën gjatë luftës së tij politike, gjatë kësaj lufte të palodhshme pesëdhjetëvjeçare. Nisur nga etja dhe kënaqësia për të dominuar, kjo dashuri për pushtetin shfaqet si një nga pasionet e tij më të papërmbajtshme: ndjenjat lartësohen, zemra rreh fort, ajri vibron. Shkurt, ndjejmë kënaqësi. Por pushteti është një mjet për t'i realizuar ato. Dhe Ai nuk është i privuar nga keto. Ç' do të mbetet nga jeta e tij? Historia do ta tregojë. Ajo do të kujtohet se ky njeri punoi për Evropën, d.m.th. për Paqen.

Miteran dhe Kohl kapur dorë për dorë në Verdun: a nuk është ky afirmimi i plotë se ndër vlerat më të para të njeriut është jeta?

Të jetosh, gjithnjë dhe akoma...

Ai shumë shpejt e kishte kuptuar se femrat nga instikti i tyre dinë ta dallojnë esencialen. Shumë më lehtë se burrat ato i evitojnë kurthet e fjalimeve dhe shfaqjen e rremë. Ai i kishte bërë ato mike të afërta. U dha poste të vërteta në jetën publike si dhe në ekzistencën e tij. Asgjë nuk është më e çmuar për një njeri si ai sesa një grua që kohë më kohë bën një shaka.

Të jetosh gjer në orën e fundit...

Udhëtimi në Egjipt mbeti një imazh i tij: një kurajo e pamposhtur, një kuriozitet i pashterur. Vallë perëndive mijëvjeçare aty, a nuk u kishte mbetur diçka për t'i zbuluar atij, lidhur me udhëtimin e fundit, "Kalimin e Madh"?

Erik Orsenna, shkrimtar

Syri i Presidentit

Në përmbledhjen e tij me ese, “Kashta dhe fara e grurit” (“La Paille et la grain”), Fransua Miteran, këmbëngul ne dëshirën e tij, që më tepër të shfaqet si një njeri politik sesa si një shkrimtar, duke pohuar kështu se preferon më shumë aksionin sesa fjalët. Megjithatë, edhe përmes këtij pohimi ai na zbulon një konflikt të dyfishtë, që ekziston tek ai dhe, nga ana tjetër, na thotë se letërsia është një nga pasionet e tij dominante. Është e panevojshme të themi se të jesh intelektual apo i apasionuar pas librave nuk është garanci se do të shkëlqesh si lider politik dhe si kompetent i kësaj fushe. Por do të ishte hipokrite të thoshim që intelektualët nuk duan te shohin pjesëtarë të sërës së tyre që të luajnë në një moment të dhënë një rol domethënës në qeverimin e një vendi.

Gjatë presidencës së Ronald Regan dhe Xhorxh Bush, që të dy këta lexues jo të apasionuar, ishte stimuluese për ne shkrimtarët amerikanë, të shihnim Francën të drejtohej nga një njeri, për të cilin të shkruarit ishte shumë e rëndësishme dhe letërsia diçka e devotshme.

Edhe pse esetë e tij janë shkruar me shije, me një lirshmëri të admirueshme dhe me talentin e një poeti të vërtetë, Miterani mbetet

modest në këtë fushe, në krahasim me aftësitë që zotëronte. “Unë nuk kam qenë kurrë një shkrimtar imagjativ,”- thoshte ai, duke shtuar: “Unë vëzhgoj dhe shkruaj. E dua letërsinë, gjuhën, filologjinë dhe gramatikën. Besoj që letërsia e vërtetë lind nga korrespondimi i saktë i fjalës me objektet”.

Miterani nuk mundi të ishte një “shkrimtar imagjativ”, por një nga tiparet e stilit të tij ishte menyra se si të gjitha ato që ai vëzhgonte, filtroheshin përmes sensibilitetit të tij prej romancierit të vërtetë; ai shkruan për qenin e tij të vogël Titus, apo për takimet e tij me Mao Ce Dunin, Golda Mejerin apo Pablo Nerudën, me penën e një shkrimtari të mirë, që vështron përtej asaj që duket, për të mbërritur kështu në esencialen e gjërave, të veçantën, në detajin rievues, ashtu siç përshkruan duart e vogla të lyera me manikyr të Maos, apo detaje të tjera që i bëjnë përshtypje nga një peizazh.

Gjatë një udhëtimi në New York, pranë majës së kullës së Qendrës Rokfeler, ai dalloi fluturimin e rosave në formë V, që ngjiteshin drejt East River. Në mesin e kësaj “gjeometrie poetike” të qytetit të madh që e impresiononte, këta zogj të egër riafirmonin në sytë e tij rendin natyror të gjërave. Pra, një mënyrë e tillë e të parit të botës, e tërhiqte domosdo drejt shkrimtarëve, mes të cilëve bëj pjesë dhe unë e që kemi kënaqësinë e dëlirë për t’u zhytur në botën e letrave.

Një vit pasi ishte zgjedhur president, pas kolokiumit kulturor që u mbajt në Sorbone, unë isha një nga shkrimtarët e ftuar nga ai në një darkë. Por këtë radhë nuk ishte një nga sallonet madhështore të pallatit të Elizesë, por një vend mjaft i ngrohtë e intim, restoranti “Treni Blu” te stacioni i trenave që shkojnë për në Lion, “Gare de Lyon”. Më kujtohet atmosfera e çlirët, jo protokollare dhe mungesa pothuajse totale e shërbimit të ruajtjes së Presidentit, gjë që Miterani e kishte kërkuar vetë që në fillim. Në këtë takim politika nuk ishte një subjekt absolutisht i ndaluar, por Presidenti dëshironte më shumë të fliste për letërsinë në përgjithësi dhe më në veçanti për veprat e autorëve bashkëkohorë.

Unë isha i lumtur kur mësova se gjatë fushatës presidenciale të vitit 1981, kishte lexuar librin tim “Perzgjedhja e Sofisë”. Kam dëgjuar t’i thoshte Suzan Sontag sesa e kishte çmuar studimin e saj për mitologjinë e sëmundjes, në librin “Sëmundja si metaforë”. Pastaj ai kishte folur gjatë me Norman Mailer lidhur me çështjen e dënimit me

vdekje, që ai e kishte trajtuar ne librin “Kënga e xhelatit”, një tregim të cilin ai e admironte jashtëzakonisht. Më vonë mësova nga Robert Badinter se ky libër i fuqishëm i Mailerit kishte luajtur një rol esencial në vendimin e Miteranit për heqjen e dënimit me vdekje, një nga vendimet e para që ai mori në krye të presidencës. Një provë tjetër e vlerësimit që kishte ai për letërsinë , ishte dhe vendimi i tij për t’u dhënë shtetësinë franceze shkrimtarëve ekzilantë politikë, argjentinasit Julio Kortazar dhe çekut Milan Kundera, që prej kohësh e kishin kërkuar këtë nga qeveritë e mëparshme.

Në fund të darkës në “Treni blu”, nuk ishte e vështirë ta ndjeje mik një njeri si ai, i cili kishte qenë i lumtur që për disa orë kishte lënë shoqërinë e politikanëve për të biseduar me njerëz që ai i konsideronte pa dyshim te familjes së vet shpirtërore, të kësaj familjeje të vërtetë.

Momentet e mrekullueshme të Miteranit shkrimtar shfaqen kur mendimet e njeriut politik dhe ato të artistit bashkohen. Unë nuk kujtoj vetëm vlerësimin e lartë që kishte ai për dy poetë që ishin në atë kohë dhe miqtë e tij, Mikis Teodorakis dhe Saint-John Perse, por në veçanti dobësinë që kishte për Pablo Neruden, atëherë i moshuar, agonia e të cilit gjente jehonë ne vrasjen e Salvador Alendes dhe në tradhtinë që iu bë Kilit.

“Ishte Neruda,- shkruan Miterani,- që më nxiti te lexoja librin “Njeqind vjet vetmi” të G.Markezit, këtë kryevepër që të lejon të kuptosh si duhet Amerikën Latine dhe destinacionin e vet përrallor”.

Miterani ishte i mahnitur nga ky liber dhe gjithë vepra e Marquezit, çka tregon interesin e tij për Amerikën Latine , ku obsesioni i krimit vazhdon. Përmes Garcia Marquezit, Miterani kishte zbuluar çelësin e sekreteve të një bote të shqetësuar, që kalonte tej kufirit të kërkesave të “realpolitik”.

Ishte vërtet e çuditshme të vështroje një njeri politik që qëmtonte idera dhe perspektiva të reja, nisur nga vizionet e tij poetike. Eshtë pa dyshim reale të mendosh se bota mund të shpëtohet nga njerëz që i përgjigjen asaj me pasionin e vizioneve të tilla. Por ky ishte stili i Fransua Miteranit, thelbësorja e figurës së tij, dhe unë isha tmerrësisht i prekur nga kjo , që gjatë karrierës së tij të shkëlqyer, ndërgegjeja e një mirësie të tillë gërshetohej me kërkesat e vetë pushtetit.

...Lufta e tij kundër sëmundjes më kishin impresionuar. Ky

njeri gjer në fund të jetës së vet të detyronte respekt. Vdekja e tij më shkaktoi dhimbje. Midis nesh kishte një lloj lidhjeje të çuditshme, një lidhje që mund të ekzistojë midis një shkrimtari dhe dikujt që e ka lexuar atë e që pastaj ka dëshirë ta njohë...Një njeri nga të rrallët politikanë të sotëm, që e vuri kulturën në qendër të jetës së vet. François Mitterrand ishte një humanist si humanistet e kohës së vjetër, një “njeri i ndershem” siç thonë francezët. Në një lloj mënyre ai ishte një njeri i shekullit 19 , pasi një pjesë e shijeve të tij letrare e artistike kishin të bënin me atë epokë. Megjithatë ai i takon historisë së shekullit 20. Ai është shkruar në të, ashtu siç ka lënë dhe gjurmë në peizazhin arkitekturor parizian.

William Stryon

KRONOLOGJI

1916 - Lindja e François Mitterrand (Fransua Miteran), më 26 tetor, në Jarnac (Zharnak) në Charente.

1934 - Pas studimeve të shkollës së mesme në kolegjin Saint-Paul d'Angouleme, Miteran shkon në Paris për të ndjekur studimet e larta për drejtësi, si dhe në fakultetin e shkencave politike "Science-Po". Aderon në "Vullnetarët Kombëtarë", një lëvizje studentore e djathtë e "Croix-de Feu", e kolonelit De La Rocque.

1940- Mobilizohet më 1939, plagoset në Verdun, më 1940 ku dhe kapet rob. Internohet në kampet gjermane pranë Weimar-it. Pas dy tentativave, më së fundi arratiset nga burgu, në dhjetor 1941.

1942 - Punon në administratën e qeverisë së Vichy-së të mareshallit Peten (Petain), në "Legjionin e Vullnetarëve të Revolucionit Nacional" dhe pastaj në "Komisariatit e Klasifikimit të të Burgosurve të Luftës.

1943-1944 - Merr pjesë në krijimin e një rrjeti të Rezistencës Franceze me ish- te burgosur të luftës dhe më 1944 bashkohet me formacione të tjera të Rezistencës, duke formuar "Lëvizjen Kombëtare të të Burgosurve dhe të Internuarve". Të nësermen e çlirimit të Parisit ai është sekretar i Përgjithshëm i të Burgosurve të Luftës.

1946-1958 - Zgjidhet deputet i Nievre më 1946. Është ministër i ish-luftëtarëve në qeverinë e Ramadier dhe të Schuman, pastaj sekretar në

presidencën e Këshillit të Ministrave; ministër i Francës për kolonitë, ministër Shteti në kabinetin e Edgar Faure; ministër i deleguar i Këshillit për Evropën në kabinetin e Lanier; ministër i Brëndshëm në qeverinë e Mendes-France, ministër i Drejtësisë në qeverinë e Guy Mollet. Eshtë kundërshtar i vendosur për kthimin në pushtet të gjeneralit De Gaulle dhe kandidat në zgjedhjet legjislativë të 1958, por nuk fiton.

1959 - Zgjidhet kryetar i Bashkisë së Chateau-Chinon, si dhe senator i Nievre.

1962 - Rizgjidhet deputet i Nievre.

1965 - Eshtë kandidat për zgjedhjet presidenciale, duke e vënë gjeneralin De Gaulle në vështirësi për t'u zgjedhur president i Francës.

1971 - Zgjidhet sekretar i Parë i Partisë së re Socialiste të krijuar në Epinay. Një vit më pas kjo parti nënshkruan bashkë me P. K. franceze një program të përbashkët për qeverimin e nesërm të Francës.

1974 - Kandidat për zgjedhjet presidenciale të parakohshme nga vdekja e George Pompidou. Fiton 49,19% të votave, por president zgjidhet Giscard d'Estaing.

1981 - 10 maj. Zgjidhet president i Francës më 51,75% të votave. Pas ardhjes në pushtet heq nga kodi penal dënimin me vdekje.

1982 - Ndërmerr një sërë ligjesh lidhur me politikën ekonomike e sociale, nacionalizimet etj.

1983 - -Në Bon, para Bundestag-ut, konfirmon solidaritetin e Francës me qeverinë e Helmut Kohl lidhur me problemin e euro-misileve dhe ekuilibrin e forcave bërthamore në Evropë..

1984 - Ndërmerr planin për modernizimin dhe ristrukturimin industrial, veçanërisht siderurgjik. L.Fabius zgjidhet kryeministër.

1985 - Çështja "Rainbow Warrior" e "Greenpeace".

1986 - E djathta fiton në zgjedhjet legjislativë. Jacques Chirac (Zhak Shirak) caktohet kryeministër.

1988 - 8 maj, ai rizgjidhet president i Francës. M.Rocard caktohet kryeministër. Arrihet statusi provizor lidhur me Kaledoninë e Re. 31 dhjetor, Miterani lançon idenë e një "Konfederatë evropiane" ku Dymbëdhjetëshja të përfshijë dhe shtetet e Evropës Lindore, tashmë demokratike.

1991 - Miraton hyrjen e Francës në luftë për çlirimin e Kuvajtit. E.Cresson është e para grua franceze që zgjidhet kryeministre. Miteran

dhe Kohl njoftojne për krijimin e një trupe ushtarake franko-gjermane, si një pikënisje e një force evropiane.

1992 - Dymbëdhjetëshja firmos traktatin e Mastrishtit, duke krijuar kështu Bashkimin Evropian.

P.Beregovoy caktohet kryeministër. Miterani shkon ne Sarajevë. Traktati i Mastrishtit miratohet në Francë përmes një referendumi.

Miterani bën të njohur publikisht se është i prekur nga një kancer në prostat.

1993 - E djathta fiton shumicën absolute në parlament. E. Balladur caktohet kryeministër. P. Beregovoy vret veten në mënyrë misterioze.

1994 - Miterani dhe mbretëresha Elezabeth II përurojnë tunelin nën detin e La Manche. Trupat franceze mbërrijnë në Ruanda. Miterani viziton Afriken e Jugut. 18 korrik: ndërhyrja e dytë kirurgjikale.

1995, 6 janar. Me rastin e përshëndetjeve për Vitin e Ri ai shprehet se do të përmbushë gjer në fund te mandatit detyrat e tij si president. Në kuadrin e zgjedhjeve presidenciale ai deklaroi se do të votojë për liderin socialist L.Jospin, "per të kristalizuar shpresën tek e majta".

Më 30 mars përurojnë Bibliotekën e re Kombëtare të Francës. Boton bisedën e përbashkët me nobelistin Elie Wiesel "Kujtesë në dy zëra", ku flet për fëmijërinë, rininë dhe çështjen Bosquet. Kryeson ceremoninë e përcjelljes së hirit të eshtrave të Marie dhe Pierre Curie në Pantheon. Më 17 maj zhvillohet ceremonia e kalimit te postit presidencial, presidentit të sapozgjedhur Shirak.

1996 - 8 janar, Miterani vdes në Paris. Varroset më 11 janar, në vendlindjen e tij në Jarnac, në varrezat e familjes Miteran.

BIBLIOGRAPHIE - BIBLIOGRAFI

Libra të shkruar nga François Mitterrand:

- "Les prisonniers de guerre devant la politique" ("Të burgosurit e Luftës përpara politikës"), Edition du "Rond-Point", 1945
- "Aux Frontieres de l'Union française" ("Në kufijtë e bashkimit francez"), Ed. "Gallimard", 1953
- "Presence française et abandon" ("Prezenca franceze dhe braktisja"), Ed. "Plon", 1957
- "La Chine au defi" ("Kina dhe sfida e saj") Ed. "Julliard", 1961
- "Le coup d'Etat permanent" ("Grusht shteti permanent"), Ed. "Plon", 1964
- "Ma part de verit" ("Pjesa ime e së vërtetës"), Ed. "Fayard", 1969
- "Un socialisme du possible", Ed. du "Seuil", 1970
- "La rose au poing" ("Trëndafili në dorë"), Ed "Flammarion", 1973
- "La paille et le grain" ("Kashta dhe fara e grurit"), Ed. "Flammarion" 1975
- "L'abeille et l'architecte" ("Bleta dhe arkitekti"), Ed. "Flammarion" 1978
- "Ici et maintenant" ("Këtu dhe tani"), Ed. "Fayard", 1980


- "Politique" I,II, Ed. "Fayard", 1981
- "Reflexion sur la politique exterieure de la France" ("Refleksion për politikën e jashtme të Francës"), Ed."Fayard", 1986
- "Memoire Ó deux voix" ("Kujtesë në dy zëra"), Ed. "Odile Jacob", 1995

Libra të shkruar për François Mitterrand

- "Mitterrand ou la tentation de l'histoire" ("Miterani apo tentacioni i historisë"), F-O. Giesbert, Ed. - du "Seuil",1977
- "François Mitterrand", D.Lande, Ed."Edipa", 1974
- "Le rouge et le noir" ("E kuqja dhe e zeza"), C.Nay, Edition "Grasset" 1984
- "Portrait du Président: le monarque imaginaire" ("Portreti i Presidentit: monarku imagjinar") J.M.Colombiani, Ed. 1985
- "Les années Mitterrand" ("Vitet Miteran"), S.July, Ed."Grasset", 1986
- "F.Mitterrand, chronique d'une victoire annoncée" (F.Miteran, kronike e një fitoreje të paralajmëruar"), K.Evin, Ed."Fayard",1988
- "Les sept Mitterrand" (" Shtate Miteranët"), C.Nay, Edition "Grasset" 1988
- "De Gaulle-Mitterrand", A.Duhamel,Ed. Flammarion",1991
- "La France sans Mitterrand" ("Franca pa Miteranin", J.M.Colombani Edition "Flammarion", 1992
- "La decennie Mitterrand"("Dhjetëvjeçari Miteran"), P.Favier, M.Martin-Roland,Ed."Seuil",1991
- "La part d'ombre" ("Pjesa e hijes"), E.Plenel, Ed. "Stock",1993
- "La haine tranquille" ("Urrejtja e qetë") R.Schneider, Edition "Seuil", 1993
- "Lettre d'un chien Ó F.Mitterrand, au nom de la liberté d'aboyer" ("Letra e një qeni adresuar Fransua Miteranit ne emër të lirisë për të lehur"), J. Montaldo, Editon "Albin Michel",1993
- "La fin d'une époque" (" Fundi i nje epoke") F.O.Giesbert, Edition "Fayard", 1993
- "La vie édifiante et mouvementée de F.Mitterrand" ("Jeta konstruktive dhe e shqetësuar e F. Miteran") , R.Mitrac, Edition


- “Presses de la Cité” 1993.
- ”Le président qui aimait les femmes”(“Presidenti që donte femrat”), M.T.Guichard,Ed.”R.Lafont”,1993
 - ”Le grand Amour”(“Një dashuri e madhe”), E.Orsena, Edition du “Seuil”,1993
 - ”Les dernières années” (“Vitet e fundit”), R.Schneider, Edition Seule, 1994
 - ”The Death of Politics: France under Mitterrand” (“Vdekja e Politikave: Franca nën Mitterrand”) J.Laughland, M.Joseph, Londres 1994
 - ”Plaidoyer l’impossible pour un vieux président abandonné par les siens”, Ph. Alexandre, Edition “Albine Michel” 1994
 - ”Mitterrand et les communistes” (“Miterani dhe komunistet”) J.M.Cadiot, Edition “Ramsay”,1994
 - ”Le roman familial de F.Mitterrand” (“Romani familjar i F. Miteranit”), M.Balvet, Edition “Plon”,1994
 - ”Mitterrand et les 40 voleurs” (“Miterani dhe 40 hajdutët”), J.Montaldo, Edition “Albin Michel”,1994
 - ”Mitterrand, l’autre histoire” (“Miterani, historia tjetër”, P.Webster, Edition du “Felin”,1994
 - ”Une jeunesse française”, (“Një rini franceze”) P.Pean Ed.”Fayard”, 1994
 - Mitterrand et les françaises, un rendez-vous manqué” (“Miteran dhe francezët, një takim në mungesë”) J.Jenson, M.Sineau,”Presses de la Fondation Nationale des Sciences Politiques, 1995
 - ”Mai, 1981, Mr. le Président” (“Maj 1981, Zoti President”), H.Hel, Edition “La Documentation Française”, 1995
 - ”Le cercle des intimes” (“Rrethi i intimeve”), C.Lang, Edition”La Sirene”,1995
 - ”La parole de Dieu” (“Fjala e Zotit”), J.Segela, Edition. “A.Michel” 1995
 - ”Mon testament”(“Testamenti im”) anonim, Edition du “Rocher”, 1995
 - ”Histoire d’un portrait”(“Historia e nje portreti”), A.Cohen, Edition.”Actes sud”, 1992
 - ”Les péchés du Prince”(“Mëkatet e Princit”), A.Genestar, Edition”Grasset”, 1992

- "L'année des adieux" ("Viti i lamtumires"), L.Adler, Edition "Flammarion", 1995
- "Verbatim" (I, II, III), J.Attali, Edition "Fayard" 1994-1995
- "L'honneur perdu de F.Mitterrand", ("Nderi i humbur i F.Miteran"), J.E.Hallier, Edition "du Rocher" 1996
- "Le bruit de la main gauche" ("Zhurma e dorës së majtë"), Ch. Salzman, Ed. "Robert Laffont", 1996
- "Les oreilles du Président" ("Veshët e Presidentit"), J.P.Pontaut, J.Dupuis, 1996
- "En toute liberté" ("Në liri të plotë"), D.Mitterrand, Edition "Ramsay", 1996



PERMBAJTJA

- Si të vdesësh...?	5
- "Messe de requiem"	8
- Nën qiellin e lagët të Aquitaine-s	10
- "Një rini franceze"...	13
- Përtej linjës "Maginot"	16
- Londër-Paris	21
- Në Vishi	27
- Paslufta	30
- Antigolisti	33
- Maj 68	35
- Socialisti	38
- "Monsieur le Président!"	40
- Pallati i Elizesë	45
- "Farewell" , "Rainbow Warrior" dhe aferet e tjera	48
- "Testamenti i tij, Evropa"	51
- Gjermania, kjo bijë e Gëtes	54
- 6 orë në Sarajevë	57
- "Homo politicus"	59
- Çështja Bosquet	64
- Një personazh i medias	66
- Shqipëria, thjesht një dëshirë...	68
- Njeriu i "letrave"	71
- "Ses amours"...dashuritë...	74
- Mazarine	79
- Ngjyrat e qiellit	82
- Forcat e shpirtit	88
- "Sekret shtetëror"	91
- Shën Fransua...	95
- Dhe zotat gjithashtu vdesin	97
- Post-mortem	99
- A-Dieu!...	111
- Kronologji	133
- Bibliografi	136



Luan RAMA, kineast dhe gazetar,
lindur më 5 janar 1952, në Tiranë.
Diplomuar për gazetari më 1975 në
Universitetin Shtetëror të Tiranës, si
dhe për audiovizuel dhe kinematografi
në Universitetin Paris -VII, "Denis Diderot"
më 1994 në Paris.

Autor i katër skenarëve
për filma me metrazh të gjatë, si dhe i
shumë skenarëve dokumentarë e filmash
vizatimorë.

Më 1995 botohet në Tiranë,
libri ese "Gjurmë..".

1994-1996, korrespondent i
gazetës "Koha Jonë" në Paris.

Fransua Miteran

- romantizmi i pushtetit -

200 lekë